Përroi i Bejnit përfaqëson një receptor mjedisor të ndjeshëm brenda zonës së projektit të Urës së Klosit, për shkak të pranisë së habitateve ripariane dhe lidhjes së tij ekologjike brenda

pellgut të lumit Mat. Vegjetacioni riparian përgjatë përroit karakterizohet nga formacione lineare të dominuara nga lloje të gjinisë *Salix spp.* dhe *Populus spp.*, të cilat kontribuojnë në stabilizimin e brigjeve, hijëzimin e rrjedhës ujore, ciklin e lëndëve ushqyese dhe ruajtjen e korridoreve ekologjike.

Megjithëse nuk ka zona të mbrojtura ose habitate kritike të përcaktuara brenda gjurmës së menjëhershme të projektit, korridori i përroit mbështet vlera lokale të biodiversitetit, duke përfshirë specie ujore dhe gjysmë-ujore tipike për degët e vogla malore. Amfibët, peshqit dhe organizmat benthikë janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në turbullirë, ngarkesën sedimentare dhe cilësinë e ujit.

Aktivitetet ndërtimore, përfshirë prishjen e urës ekzistuese, gërmimet pranë brigjeve të lumit, punimet e themeleve dhe ndërhyrjet e përkohshme brenda rrjedhës ujore, mund të shqetësojnë tokën dhe sedimentet, duke shkaktuar rritje të përkohshme të turbullirës dhe materialeve pezull në ujë. Çlirimi i sedimenteve mund të ndodhë përmes:

- shqetësimit të drejtpërdrejtë të shtratit ose brigjeve të lumit,
- rrjedhjeve nga tokat e ekspozuara dhe grumbujt e materialeve,
- shkarkimit të pakontrolluar të ujërave atmosferike nga zonat e ndërtimit,
- derdhjeve aksidentale të materialeve të imëta gjatë trajtimit dhe transportit.

Rritja e turbullirës mund të reduktojë depërtimin e dritës, të ndikojë në vegjetacionin ujor dhe të shqetësojë përkohësisht habitatet benthike. Ngarkesa e shtuar e sedimenteve mund të ndikojë gjithashtu në kushtet e shumimit dhe ushqyerjes së faunës ujore. Megjithëse këto efekte pritet të jenë lokale dhe afatshkurtra, ato mund të ndryshojnë përkohësisht funksionet ekologjike brenda segmentit të afërt të lumit nëse nuk kontrollohen siç duhet.

Përveç ndikimeve të lidhura me sedimentet, ekziston rreziku i ndotjes aksidentale nga karburantet, lubrifikantët, lëngjet hidraulike, ujërat e larjes së betonit dhe substanca të tjera të lidhura me ndërtimin. Derdhjet e hidrokarbureve mund të përhapen në sipërfaqen e ujit dhe të ndikojnë organizmat ujorë, ndërsa ujërat alkaline nga larja e betonit mund të ndryshojnë përbërjen kimike të ujit. Duke pasur parasysh lidhjen hidrologjike të Përroit të Bejnit me lumin Mat, ngjarjet lokale të ndotjes mund të kenë pasoja edhe në rrjedhën poshtë lumit nëse nuk izolohen në kohë.

Në përgjithësi, ndikimet mbi cilësinë e ujit dhe transportin e sedimenteve vlerësohen me rëndësi mesatare, duke reflektuar ndjeshmërinë e korridorit riparian dhe receptorëve ujorë. Këto ndikime pritet të jenë të përkohshme dhe të rikthyeshme, me kusht që të zbatohen masat e duhura të kontrollit.

Masat Zbutëse

Një Plan i Veçantë për Kontrollin e Erozionit dhe Sedimenteve, si dhe një Plan për Menaxhimin e Burimeve Ujore, duhet të zbatohen si pjesë e PMMS -së së Kontraktorit. Masat duhet të përfshijnë:

- instalimin e masave për kontrollin e erozionit dhe sedimenteve përpara fillimit të punimeve të gërmimit, duke përfshirë gardhe sedimentesh, barriera sedimentare, kanale devijuese dhe struktura të përkohshme drenazhimi,

- minimizimin e punimeve brenda rrjedhës ujore për sa i përket sipërfaqes dhe kohëzgjatjes, duke kufizuar ndërhyrjet në zonën më të vogël të mundshme,
- shmangien e dëmtimit të panevojshëm të vegjetacionit riparian jashtë gjurmës së miratuar të ndërtimit,
- ruajtjen e rrjedhës ekologjike në çdo kohë për të garantuar lidhjen poshtë rrjedhës dhe kushtet e habitatit ujor,
- ndalimin e depozitimit të materialeve të gërmuara brenda zonës së përmytjes ose pranë brigjeve të lumit pa masa të përshtatshme izolimi dhe mbrojtjeje nga rrjedhjet,
- stabilizimin progresiv të brigjeve të ekspozuara përmes riformësimit dhe rigjelbërimit me specie vendase ripariane si *Salix alba* dhe *Platanus orientalis*,
- planifikimin e punimeve, aty ku është e mundur, për të shmangur periudhat biologjike të ndjeshme, si sezoni i shumimit të amfibëve,
- projektimin dhe vendosjen e tombinove në mënyrë që të mos ndikojnë në shpejtësinë ose cilësinë e ujit pritës.

Masat për parandalimin e ndotjes duhet të përfshijnë:

- Ndalimi strikt i shkarkimit të ujërave të patrajuara në Përroin e Bejnit.
- Përcaktimi i zonave për larjen e pajisjeve larg rrjedhës ujore, me grumbullimin dhe depozitimin e duhur të ujërave të larjes.
- Depozitimi i karburanteve dhe materialeve të rrezikshme në zona të izoluara me barriera mbrojtëse dhe sipërfaqe të papërshkueshme, të vendosura në një distancë të sigurt nga përroi.
- Disponueshmëria e pajisjeve kundër derdhjeve (spill kits) dhe personelit të trajnuar në frontet aktive të punës.
- Izolimi dhe rehabilitimi i menjëhershëm i çdo derdhjeje aksidentale.
- Nëse instalohet një impiant i përkohshëm asfalti, Kontraktori duhet të zgjedhë vendndodhjen e impiantit në një distancë të përshtatshme nga zonat rezidenciale, trupat ujore dhe receptorët e ndjeshëm; të sigurojë depozitimin dhe trajtimin e duhur të karburanteve, bitumit dhe materialeve të rrezikshme, duke përfshirë sistemet sekondare të mbajtjes dhe procedurat për reagim ndaj derdhjeve; si dhe të rehabilitojë plotësisht zonën pas çmontimit të impiantit, duke e rikthyer atë në gjendjen fillestare ose në gjendjen e dakordësuar.

Nëpërmjet zbatimit të këtyre masave, ndikimet mbi cilësinë e ujit, transportin e sedimenteve dhe biodiversitetin riparian do të mbeten lokale, të përkohshme dhe të menaxhueshme, duke siguruar mbrojtjen e habitateve ujore dhe ruajtjen e funksioneve ekologjike brenda korridorit lumor.

4.2.4 Ndikimi në Tokë

Karakterizimi i Ndikimit

Aktivitetet ndërtimore të lidhura me nënprojektin e Urës së Klosit do të shkaktojnë shqetësime lokale të tokës brenda gjurmës së përcaktuar të ndërtimit, veçanërisht në hyrjet e urës, zonat e përkohshme të aksesit dhe zonat e përcaktuara për depozitimin e materialeve dhe lëvizjen e pajisjeve. Tokat e prekura janë tipike për mjediset e luginave lumore dhe zonave peri-urbane, të përbëra nga shtresa humusi mbi depozitime kolviale dhe aluviale, me ndjeshmëri mesatare ndaj shqetësimeve.

Heqja e vegetacionit dhe shtresës sipërfaqësore të tokës brenda korridorit të punimeve mund të rrisë ndjeshmërinë e tokave të ekspozuara ndaj erozionit, veçanërisht gjatë reshjeve. Në zonat pranë Përroit të Bejnit, rrjedhjet e pakontrolluara mund të transportojnë grimca të imëta drejt rrjedhës ujore, duke ndikuar potencialisht në stabilitetin e tokës përgjatë brigjeve dhe duke kontribuar në shtimin e sedimenteve.

Ndryshimi i përkohshëm i modeleve të drenazhimit sipërfaqësor gjatë punimeve të gërmimit mund të ndikojë gjithashtu në kushtet hidrologjike lokale, duke çuar potencialisht në grumbullim lokal të ujit ose ndryshime në drejtimin e rrjedhjeve, nëse nuk menaxhohet siç duhet. Duke pasur parasysh natyrën relativisht të kufizuar të kantierit, këto efekte pritet të kufizohen në zonën e menjëhershme të projektit.

Përdorimi i makinerive të rënda dhe lëvizja e përsëritur e automjeteve mund të shkaktojnë ngjeshje të tokës, veçanërisht përgjatë rrugëve të aksesit dhe zonave të punës. Kjo mund të reduktojë përkohësisht përshkueshmërinë dhe kapacitetin infiltrues të tokës. Ndjeshmëria e këtyre tokave konsiderohet mesatare, duke reflektuar përdorimin aktual dhe natyrën tashmë të modifikuar të zonës.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm lidhet me cilësinë e tokës, e cila mund të ndikohet nga rrjedhjet ose derdhjet aksidentale të karburanteve, lubrifikantëve, lëngjeve hidraulike ose substancave të tjera të lidhura me ndërtimin. Megjithëse ngjarje të tilla nuk priten në kushte normale operimi, afërsia e zonës së ndërtimit me korridorin lumor rrit rëndësinë e masave parandaluese. Menaxhimi i papërshtatshëm i materialeve ose ujërat e pakontrolluara nga larja e betonit mund të çojnë gjithashtu në ndryshime lokale të vetive të tokës, përfshirë alkalinitetin dhe strukturën e saj.

Në përgjithësi, ndikimet mbi tokën pritet të jenë lokale, të përkohshme dhe të rikthyeshme, duke pasur parasysh gjurmën e kufizuar të projektit dhe mungesën e tokave shumë të ndjeshme ose të kontaminuara. Megjithatë, pa menaxhimin e duhur, mund të ndodhin efekte dytësore si erozioni, ngjeshja ose kontaminimi lokal i tokës.

Masat Zbutëse

Për mbrojtjen e burimeve të tokës gjatë fazës së ndërtimit, masat e mëposhtme duhet të zbatohen si pjesë e PMMS -së së Kontraktorit:

- Kufizimi i pastrimit të vegetacionit dhe heqjes së shtresës së tokës vetëm brenda gjurmës së miratuar të ndërtimit.
- Ruajtja dhe depozitimi i veçuar i shtresës sipërfaqësore të tokës (humusit) për ripërdorim gjatë rehabilitimit të zonës, duke siguruar që grumbujt e depozituar të mbrohen nga erozioni dhe rrjedhjet sipërfaqësore.
- Instalimi i sistemeve të përkohshme të drenazhimit dhe masave për kontrollin e erozionit për menaxhimin e rrjedhjeve sipërfaqësore dhe parandalimin e transportit të sedimenteve.
- Kufizimi i lëvizjes së makinerive të rënda vetëm në rrugët e përcaktuara të aksesit për të minimizuar ngjeshjen e tokës.
- Zbatimi progresiv i rehabilitimit të zonave të dëmtuara, duke përfshirë riformësimin e terrenit, rikthimin e shtresës së tokës dhe rigjelbërimit me specie vendase të përshtatshme.

Në lidhje me parandalimin e ndotjes:

- Shmangia e mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve dhe pajisjeve brenda zonës aktive të ndërtimit ose pranë Përroit të Bejnit.
- Kryerja e operacioneve të furnizimit me karburant në zona të përcaktuara me sipërfaqe të papërshkueshme dhe masa për kontrollin e derdhjeve, të vendosura larg rrjedhës ujore.
- Depozitimi i materialeve të rrezikshme në zona të izoluar me barriera mbrojtëse dhe të sigurta, në një distancë të përshtatshme nga receptorët e ndjeshëm.
- Shmangia e depozitimit të zgjatur të materialeve direkt mbi tokë të zhveshur dhe sigurimi i largimit të tyre në kohë drejt impianteve të licencuara.
- Në rast derdhjesh aksidentale, izolimi dhe largimi i menjëhershëm i tokës së kontaminuar dhe depozitimi i saj në impiante të miratuara.

Nëpërmjet zbatimit të këtyre masave, ndikimet mbi tokën do të mbeten lokale dhe të menaxhueshme, duke siguruar ruajtjen e stabilitetit të tokës, parandalimin e kontaminimit dhe rehabilitimin efektiv të zonave të dëmtuara pas përfundimit të punimeve ndërtimore.

4.2.5 Shëndeti i Komunitetit, Siguria dhe Trafiku

Karakterizimi i Ndikimit

Ura e Klosit funksionon si një nyje e rëndësishme lokale kalimi që lidh qytetin e Klosit me vendbanimet rurale përreth, zonat bujqësore dhe rrjetin më të gjerë rajonal, përfshirë lidhjen drejt Rrugës së Arbrit. Ajo përdoret çdo ditë nga banorët, fermerët, bizneset e vogla, këmbësorët dhe ofruesit e shërbimeve, përfshirë edhe shërbimet emergjente. Për këtë arsye, ura dhe hyrjet e saj përfaqësojnë një element kritik të lëvizshmërisë dhe aksesit lokal.

Aktivitetet ndërtimore, përfshirë lëvizjen e makinerive të rënda, transportin e materialeve, punimet e prishjes dhe ndryshimet e përkohshme në rrjedhën e trafikut, mund të ndërveprojnë me këtë kontekst bazë dhe të rrisin rrezikun e:

- aksidenteve rrugore që përfshijnë automjetet e ndërtimit dhe përdoruesit e rrugës publike,
- rreziqeve për sigurinë e këmbësorëve, veçanërisht në zonat pa infrastrukturë të dedikuar për ecje,
- kufizimeve të përkohshme në aksesin e pronave rezidenciale, tokave bujqësore dhe shërbimeve lokale,
- bllokimeve ose vonesave lokale në hyrjet e urës,
- efekteve shqetësuese si pluhuri, zhurma dhe vibrimet që ndikojnë banorët pranë.

Ndjeshmëria e këtyre ndikimeve ndikohet nga afërsia e receptorëve me zonën e ndërtimit. Banesat, këmbësorët dhe përdoruesit lokalë ndodhen relativisht pranë hyrjeve të urës, duke krijuar një nivel mesatar deri të lartë ekspozimi krahasuar me zona më të largëta. Konteksti peri-urban, i karakterizuar nga trafik i përzier dhe mungesa e ndarjes së qartë mes automjeteve dhe këmbësorëve, rrit më tej ndjeshmërinë ndaj ndryshimeve në kushtet e trafikut dhe rreziqeve të sigurisë.

Ura gjithashtu luan rol në garantimin e aksesit për shërbimet emergjente dhe funksionet thelbësore. Çdo ndërprerje ose reduktim i funksionalitetit të kalimit mund të ndikojë në kohën e reagimit dhe aksesin, veçanërisht duke marrë parasysh mungesën e alternativave të afërta rrugore.

Në përgjithësi, ndikimet e lidhura me ndërtimin mbi shëndetin, sigurinë dhe trafikun e komunitetit vlerësohen si të përkohshme, por me ndjeshmëri të lartë sociale, për shkak të rëndësisë së urës për lëvizjen e përditshme dhe varësisë së komuniteteve lokale nga akses i pandërprerë dhe i sigurt.

Masat Zbutëse

Në përputhje me Standardin 4 të Mjedisit dhe Social të Bankës Botërore, Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social, si dhe Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë, rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit duhet të menaxhohen përmes zbatimit të një Plani të Detajuar për Menaxhimin e Trafikut dhe Aksesit si pjesë e PMMS -së së Kontraktorit.

Masat kryesore duhet të përfshijnë:

- Mbatjen e urës ekzistuese funksionale gjatë ndërtimit, përveç rasteve kur mbylljet afatshkurtra janë rreptësisht të nevojshme dhe të miratuara paraprakisht.
- Përgatitjen dhe zbatimin e një Plani të Menaxhimit të Trafikut të përshtatur për vendin, duke përfshirë devijime të qarta të trafikut, sinjalistikë të përkohshme dhe shenja rrugore në përputhje me standardet kombëtare.
- Instalimi i barrierave fizike që ndajnë zonat e ndërtimit nga korsitë aktive të trafikut dhe zonat e këmbësorëve.
- Vendosja e personelit të trajnuar për menaxhimin e trafikut gjatë periudhave me intensitet të lartë punimesh dhe kur pajisjet e rënda hyjnë ose dalin nga kantieri.
- Zbatimi i masave për kontrollin e shpejtësisë brenda dhe përreth zonës së ndërtimit.
- Sigurimi i kalimeve të sigurta për këmbësorët aty ku është e mundur, me shtigje të qarta të shënuara dhe sinjalistikë paralajmëruese.
- Sigurimi i aksesit të pandërprerë në banesa, toka bujqësore dhe shërbime thelbësore, përfshirë aksesin për automjetet emergjente në çdo kohë.
- Nëse instalohet një impiant i përkohshëm asfalti, Kontraktori duhet të zgjedhë vendndodhjen e impiantit në një distancë të përshtatshme nga zonat rezidenciale dhe receptorët e ndjeshëm; si dhe të zhvillojë dhe zbatojë një plan menaxhimi të trafikut për të adresuar rritjen e lëvizjes së automjeteve.

Për adresimin e ndikimeve shqetësuese:

- Zbatimi i masave për uljen e pluhurit për të minimizuar grimcat e ajrit që ndikojnë banesat përreth.
- Kufizimi i aktiviteteve me zhurmë të lartë vetëm në orët e ditës dhe njoftimi paraprak i komunitetit.
- Pozicionimi i ndriçimit të përkohshëm, kur është i nevojshëm, në mënyrë që të shmanget verbimi (shkëlqimi) drejt pronave përreth.

Angazhimi dhe komunikimi me komunitetin do të jenë pjesë integrale e menaxhimit të rrezikut. Banorët dhe palët e interesuara lokale do të informohen paraprakisht për oraret e punimeve, organizimin e përkohshëm të trafikut dhe çdo ndërprerje afatshkurtër. Gjatë gjithë periudhës së ndërtimit do të mbahet një mekanizëm funksional për trajtimin e ankesave, në mënyrë që komuniteti të mund të raportojë shqetësime dhe të marrë përgjigje në kohë.

Nëpërmjet zbatimit të këtyre masave, ndikimet e mbetura mbi shëndetin, sigurinë dhe trafikun e komunitetit pritet të jenë të përkohshme, lokale dhe të menaxhueshme, duke siguruar që ura të vazhdojë të përmbushë funksionin e saj thelbësor të lidhjes, duke ruajtur njëkohësisht sigurinë publike gjatë ndërtimit.

4.2.6 Shëndeti dhe Siguria në Punë (OHS)

Karakterizimi i Ndikimit

Aktivitetet ndërtimore të lidhura me nënprojektin e Urës së Klosit do të ekspozojnë punëtorët ndaj një sërë rreziqesh të shëndetit dhe sigurisë në punë (OHS), tipike për punimet e ndërtimit të urave dhe rrugëve. Këto përfshijnë prishjen e strukturës ekzistuese, gërmimet dhe punimet e tokës, përdorimin e makinerive të rënda, punën në lartësi, trajtimin e materialeve, ndërveprimin me trafikun dhe aktivitetet pranë Përroit të Bejnit. Këto rreziqe janë të natyrshme për ndërtimin, por janë specifike për vendin, të përkohshme dhe të kontrollueshme përmes masave të duhura menaxhuese.

Rreziqet kryesore profesionale mund të përfshijnë:

- rënie nga lartësia gjatë punimeve të prishjes dhe strukturave,
- incidente “goditur nga” ose “kapur nga” pajisjet e rënda dhe mjetet në lëvizje,
- paqëndrueshmëri ose shembje e gërmimeve,
- ekspozim ndaj niveleve të larta të zhurmës dhe vibrimeve,
- thithje e pluhurit dhe emetimeve nga gazrat e shkarkimit,
- kontakt me substanca të rrezikshme si karburantet, lubrifikantët dhe betoni i freskët (i lagësht),
- rrëshqitje, pengesa dhe rënie në sipërfaqe të pabarabarta ose të lagështa,
- rreziqe elektrike të lidhura me pajisjet dhe instalimet e përkohshme.

Punimet e kryera pranë Përroit të Bejnit krijojnë rreziqe shtesë, përfshirë rënien aksidentale në ujë, punën në terren të paqëndrueshëm ose të ngopur me ujë, si dhe sfida të lidhura me hapësirat e kufizuara të punës përgjatë brigjeve të lumit. Prania e një korridorit aktiv rrugor rrit më tej rrezikun për shkak të ndërveprimit midis aktiviteteve ndërtimore dhe trafikut që kalon, veçanërisht aty ku hapësira është e kufizuar dhe kërkohen masa ndarëse.

Ndjeshmëria e rreziqeve OHS ndikohet nga natyra e punimeve, kushtet e kantierit dhe ekspozimi i fuqisë punëtore, përfshirë përdorimin e makinerive të rënda në një mjedis relativisht të kufizuar peri-urban. Pa masa të duhura kontrolli, këto rreziqe mund të çojnë në lëndime që variojnë nga incidente të lehta deri në aksidente të rënda ose fatale.

Në përgjithësi, shëndeti dhe siguria në punë vlerësohen si një kategori rreziku me përparësi të lartë gjatë fazës së ndërtimit, duke kërkuar menaxhim të strukturuar dhe zbatim të rreptë të

procedurave të sigurisë në përputhje me Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë dhe Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë.

Masat Zbutëse

Shëndeti dhe siguria në punë duhet të menaxhohen përmes zbatimit të një Plani të Dedikuar për Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë (HSMP), si pjesë e PMMS -së së Kontraktorit. HSMP do të jetë specifik për kantierin dhe i harmonizuar me legjislacionin shqiptar të punës, Standardin 2 të Bankës Botërore për Mjedisin dhe Socialin (ESS2), Procedurat e Menaxhimit të Punës në nivel programi dhe Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë.

Ai do të përfshijë masa si trajnimi i detyrueshëm i punëtorëve, sigurimi dhe zbatimi i përdorimit të pajisjeve personale mbrojtëse (PPE), procedura të sigurta pune për aktivitetet me rrezik të lartë, gatishmëria për emergjenca dhe raportimi i incidenteve. Për më tepër, do të krijohet dhe zbatohet një mekanizëm për ankesat e punëtorëve dhe një Kod Sjelljeje për të siguruar kushte pune të sigurta, të drejta dhe jo-diskriminuese.

Masat e mëposhtme duhet të zbatohen:

Menaxhimi i përgjithshëm i sigurisë

- Emërimi i një Zyrtari të kualifikuar për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë, përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin në terren të masave OHS (në përputhje me planin e miratuar të monitorimit ARA PIT).
- Kryerja e vlerësimeve të rrezikut specifike për çdo detyrë dhe përgatitja e deklaratave metodologjike (method statements) përpara fillimit të punimeve.
- Trajnim i detyrueshëm hyrës për të gjithë punëtorët, përfshirë nënkontraktorët, mbi rreziqet e kantierit, procedurat emergjente dhe praktikatat e sigurta të punës.
- Zbatimi i rregullt i “toolbox talks” dhe seancave të përsëritura të trajnimit.
- Pajisje dhe veshje mbrojtëse në çdo kohë.

Pajisjet Mbrojtëse Personale (PPE)

- Sigurimi dhe përdorimi i detyrueshëm i pajisjeve personale mbrojtëse të përshtatshme, përfshirë helmetat, jelekët me dukshmëri të lartë, çizmet e sigurisë, dorezat, mbrojtjen e syve dhe mbrojtjen e dëgjimit aty ku kërkohet.
- Përdorimi i sistemeve të mbrojtjes nga rënia, si rripat e sigurisë (harnaiset) dhe barrierat mbrojtëse, për punimet në lartësi.

Kontrolli i kantierit dhe siguria e pajisjeve

- Ndarja e qartë e zonave të punës dhe segregimi i rrugëve të këmbësorëve nga ato të mjeteve brenda kantierit.
- Inspektimi dhe mirëmbajtja e rregullt e makinerive dhe pajisjeve ngritëse.
- Procedura të sigurta operimi për vinçat, pajisjet ngritëse dhe makineritë e rënda.
- Zbatimi i procedurave “lock-out dhe tag-out” për sistemet elektrike dhe mekanike aty ku është e aplikueshme.

Siguria në gërmime dhe strukturë

- Stabilizimi i anëve të gërmimeve dhe sigurimi i aksesit të sigurt për hyrje-dalje.
- Inspektimi i mbështetësve të përkohshëm dhe skelave nga personel i kualifikuar.
- Kontroll i rreptë i punimeve të prishjes, duke përfshirë zonat e kufizuara dhe largimin e kontrolluar të mbetjeve.
- Rigjellbërim i detyrueshëm pas përfundimit të punimeve për të parandaluar erozionin.

Mbrojtja e shëndetit

- Zbatimi i masave për kontrollin e pluhurit për të reduktuar ekspozimin respirator.
- Monitorimi dhe menaxhimi i ekspozimit ndaj zhurmës në përputhje me standardet përkatëse.
- Sigurimi i ambienteve të përshtatshme sanitare, ujit të pijshëm dhe zonave të pushimit për punëtorët.

Disponueshmëria e kutive të ndihmës së parë dhe personelit të trajnuar për ndihmën e parë në kantier.

Gatishmëria për emergjenca

- Përgatitja e një Plani të Reagimit Emergjent, duke përfshirë procedurat për zjarr, lëndime, derdhje dhe emergjenca ujore. Trajnimet përkatëse janë realizuar.
- Disponueshmëria e pajisjeve për fikjen e zjarrit dhe materialeve për reagim ndaj derdhjeve.
- Kanalet e qarta të komunikimit dhe informacioni i kontaktit emergjent i afishuar në kantier.

Inspektime të rregullta, raportim i incidenteve dhe procedura korrigjuese duhet të zbatohen për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të performancës së sigurisë. Të gjitha aksidentet, situatat pothuaj-aksident (near-miss) dhe situatat e rrezikshme duhet të dokumentohen dhe hetohen për të parandaluar përsëritjen e tyre.

Me zbatimin e këtyre masave, rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në punë do të menaxhohen në mënyrë efektive, duke siguruar mbrojtjen e punëtorëve dhe përputhshmërinë me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare.

standardet gjatë gjithë fazës së ndërtimit, dhe rreziqet e mbetura për shëndetin dhe sigurinë në punë konsiderohen të ulëta dhe të pranueshme.

4.2.7 Shqetësimi për Biodiversitetin dhe Restaurimi i Habitatit

Nënprojekti i Urës së Klosit ndodhet brenda një korridorit lumor të karakterizuar nga habitate breglumore përgjatë Përroit të Bejnit, të dominuara nga specie si *Salix spp.* dhe *Populus spp.*. Këto habitate luajnë një rol të rëndësishëm në stabilizimin e brigjeve, hijëzimin e rrjedhës ujore, ciklin e lëndëve ushqyese dhe ruajtjen e lidhjes ekologjike përgjatë korridorit të përroit.

Megjithëse nuk ka habitate kritike, zona Natura 2000 apo zona të mbrojtura të përcaktuara ligjërisht brenda Zonës së Ndikimit, korridorit i Përroit të Bejnit funksionon si një lidhje

ekologjike lokale brenda pellgut të lumit Mat. Ai mbështet specie të zakonshme ujore dhe gjysmë-ujore, si dhe faunë tokësore që përdor zonën ripariane për lëvizje, ushqim dhe strehim.

Ndikimet e mundshme në biodiversitet gjatë ndërtimit mund të vijnë nga:

- heqja e përkohshme e vegjetacionit riparian brenda gjurmës së miratuar të punimeve,
- shqetësimi i brigjeve të lumit dhe habitateve ujore gjatë punimeve brenda shtratit të ujit,
- rritja e turbullirës dhe sedimentimit që ndikon organizmat ujorë,
- zhurma, vibrimet dhe ndriçimi artificial që shqetësojnë faunën,
- ngjarjet aksidentale të ndotjes,
- sjellja e papërshtatshme e punëtorëve, si shqetësimi i faunës ose dëmtimi i vegjetacionit.

Habitatet ripariane dhe fauna e lidhur me to mund të përjetojnë shqetësime të përkohshme gjatë prishjes, gërmimeve dhe punimeve strukturore pranë brigjeve të lumit. Madhësia e ndikimit vlerësohet e ulët deri mesatare, lokale dhe e rikthyeshme, duke marrë parasysh gjurmën e kufizuar dhe mungesën e habitateve kritike, me kusht që të zbatohen masat e duhura të shmangies dhe restaurimit.

Siç është vërejtur në projekte të ngjashme infrastrukturore, heqja e panevojshme e vegjetacionit mund të ulë vlerën ekologjike pa kontribuar në kërkesat inxhinierike ose të sigurisë. Prandaj, menaxhimi i vegjetacionit në këtë projekt duhet të kufizohet rreptësisht në minimumin e nevojshëm.

Masat Zbutëse

Masat zbutëse janë të dizajnuara për të minimizuar shqetësimin, për të mbrojtur habitatet ujore dhe ripariane dhe për të siguruar restaurim efektiv të zonave të prekura. Këto masa janë në përputhje me ESS6, Kornizën Programore ESMF, legjislacionin mjedisor shqiptar dhe Praktikrat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë.

Zonat “No-Go” (të ndaluara për ndërhyrje)

- Vegjetacioni riparian jashtë gjurmës së miratuar të ndërtimit duhet të përcaktohet si zonë “no-go”.
- Në këto zona nuk lejohet depozitimi i materialeve, lëvizja e automjeteve, hedhja e mbetjeve apo pastrimi i vegjetacionit.
- Zonat “no-go” duhet të shënohen qartë përpara fillimit të punimeve.

Menaxhimi i vegjetacionit

- Pastrimi i vegjetacionit duhet të minimizohet dhe të kufizohet rreptësisht vetëm në zonat e nevojshme për ndërtim dhe siguri.
- Heqja e pemëve, kur është e nevojshme, duhet të miratohet nga autoritetet përkatëse.
- Para pastrimit duhet të kryhen inspektime nga specialisti mjedisor për të identifikuar praninë e faunës që folezon ose elementëve të ndjeshëm.

- Pastrimi duhet të kryhet në mënyrë graduale për t’i mundësuar faunës të largohet natyrshëm.

Punimet brenda shtratit të lumit dhe në zonën ripariane

- Punimet brenda shtratit të lumit duhet të minimizohen në shtrirje dhe kohëzgjatje.
- Duhet të ruhet rrjedha ekologjike në çdo kohë për të garantuar lidhjen poshtë rrjedhës dhe kushtet e habitatit ujor.
- Kur është e mundur, këto punime duhet të planifikohen jashtë periudhave të ndjeshme biologjike (p.sh. sezoni i shumimit të amfibëve, peshqve dhe shpendëve).
- Duhet të shmangen punimet gjatë natës dhe ndriçimi artificial i pakontrolluar pranë lumit.
- Duhet të zbatohen masa për kontrollin e sedimenteve dhe erozionit për mbrojtjen e habitateve ujore.

Mbrojtja e faunës

- Zona e punimeve duhet të inspektohet për praninë e faunës (p.sh. strehime, fole), dhe duhet të zbatohen masa të përshtatshme nëse identifikohen.
- Gropat e hapura duhet të inspektohen rregullisht dhe çdo faunë e bllokuar duhet të zhvendoset në mënyrë të sigurt jashtë zonës së punimeve.
- Gjuetia, peshkimi, mbledhja e florës dhe shqetësimi i faunës nga punëtorët ndalohen rreptësisht.
- Aktivitetet si ndezja e zjarreve apo përdorimi i vegjetacionit për përdorim personal nuk lejohen.

Lidhjet me cilësinë e ujit

- Masat për kontrollin e sedimenteve dhe parandalimin e ndotjes të përshkruara në Seksionin 4.2.3 duhet të zbatohen për mbrojtjen e habitateve ujore.
- Shkarkimi i ujërave të patrajtuara në Përroin e Bejnit ndalohet rreptësisht.

Periudhat e ndjeshme për faunën dhe kufizimet e punimeve

Bazuar në bazën ekologjike të zonës së Urës së Klosit, periudhat e ndjeshme për speciet faunistike lidhen kryesisht me periudhat e shumimit, vezëzimit, folezimit dhe aktivitetit sezonal. Aktivitetet ndërtimore që përfshijnë pastrimin e vegjetacionit, punimet brenda shtratit të lumit, gërmimet, zhurmën e lartë, vibrimet dhe rritjen e pranisë njerëzore duhet, kur është e mundur, të shmangin këto periudha ose të realizohen nën mbikëqyrje ekologjike.

- Amfibët: Speciet e amfibëve si *Bombina variegata*, *Hyla arborea*, *Bufo viridis*, *Rana graeca* dhe *Rana dalmatina* janë më të ndjeshme gjatë periudhave të shumimit dhe zhvillimit larvor, zakonisht midis marsit dhe qershorit. Specie me rëndësi më të lartë konservimi përfshijnë *Bombina variegata* dhe *Triturus macedonicus* (IUCN: Vulnerable), e cila mund të jetë e pranishme. Punimet brenda shtratit të lumit dhe shqetësimi i habitateve ujore të cekëta duhet të minimizohen gjatë kësaj periudhe.
- Speciet ujore: Popullatat e peshqve janë veçanërisht të ndjeshme gjatë periudhave të shumimit, zakonisht midis prillit dhe qershorit. Specie me rëndësi konservimi përfshijnë *Barbus prespensis* dhe *Chondrostoma ohridanum* (të dyja IUCN:

Vulnerable), ndërsa *Anguilla anguilla* (IUCN: Critically Endangered) dhe *Gobio skadarensis* (IUCN: Endangered) mund të gjenden në pellgun më të gjerë. Aktivitetet që shkaktojnë turbullirë, çlirim sedimenti ose shqetësim të shtratit të lumit duhet të kontrollohen me kujdes gjatë kësaj periudhe.

- Fauna tokësore dhe reptilët: Zvarranikët dhe fauna tokësore janë më të ndjeshme gjatë periudhave të riprodhimit dhe aktivitetit maksimal, kryesisht midis prillit dhe korrikut. Specie me rëndësi konservimi përfshijnë *Emys orbicularis* dhe *Testudo hermanni* (të dyja Near Threatened dhe të mbrojtura rreptësisht në nivel kombëtar). Pastrimi i vegjetacionit dhe shqetësimi i habitatit në zonat ripariane duhet të minimizohet.
- Shpendët (avifauna): Speciet e shpendëve janë të ndjeshme gjatë periudhave të folezimit dhe shumimit, zakonisht midis marsit dhe korrikut. Specie me rëndësi konservimi përfshijnë *Microcarbo pygmaeus*, *Caprimulgus europaeus* dhe *Streptopelia turtur* (IUCN: Vulnerable). Pastrimi i vegjetacionit dhe aktivitetet me zhurmë pranë habitateve ripariane duhet të shmangen kur është e mundur gjatë kësaj periudhe, dhe inspektimet e foleve duhet të kryhen përpara heqjes së vegjetacionit.

Këto kufizime sezonale duhet të zbatohen si më poshtë:

- Punimet që mund të shkaktojnë turbullirë ose ndryshime ekstreme të shpejtësisë së rrjedhës, ose që mund të rrezikojnë vezët dhe larvat, nuk do të kryhen gjatë periudhës mars–qershor.
- Për punime të tjera, veçanërisht pranë brigjeve të lumit dhe vegjetacionit riparian, duhet të kryhen kontrole ekologjike paraprake nga një biolog/ekolog i kualifikuar përpara dhe gjatë punimeve, për të verifikuar mungesën e foleve aktive (tokësore ose në pemë), vendeve të shumimit ose pranisë së faunës së ndjeshme, si dhe për të përcaktuar masa shtesë zbutëse nëse nevojiten.
- Nëse identifikohen fole të specieve të mbrojtura dhe të ndjeshme, Kontraktori duhet:
 - të ndalojë punimet në afërsi të menjëhershme të folesë deri në kryerjen e vlerësimit,
 - të konfirmojë: specien e pranishme, statusin e folesë (aktive/inaktive) dhe ndjeshmërinë e specieve,
 - nëse specia është e ndjeshme dhe foleja aktive, të vendoset një zonë mbrojtëse (buffer zone) pa shqetësime rreth folesë,
 - të përjashtohet zona nga të gjitha aktivitetet ndërtimore (pastrim, zhurmë, vibrime) brenda zonës mbrojtëse,
 - të ruhet zona mbrojtëse deri sa: vezët të çelin dhe të vegjlit të bëhen të pavarur (faza e fluturimit/zhvillimit), ose foleja të konfirmohet si joaktive nga një ekspert i kualifikuar,
 - të kufizohen aktivitetet në afërsi të zonës mbrojtëse vetëm në punë me ndikim të ulët,
 - të kufizohet zhurma, vibrimi dhe prania njerëzore,
 - të përdoren barriera vizuale ose ekrane për të reduktuar shqetësimin (në varësi të specieve),
 - të mbahet mbikëqyrje ekologjike e vazhdueshme.

Ruajtja e funksionalitetit ekologjik të rrjedhës ujore

Megjithëse projekti i Urës së Klosit nuk përfshin marrje uji, krijim digash apo ndryshim të përhershëm të regjimit natyror hidrologjik, aktivitetet e ndërtimit brenda Përroit të Bejnit

mund të ndikojnë përkohësisht në kushtet lokale të rrjedhës dhe habitatet ujore. Për të ruajtur funksionalitetin ekologjik të përroit, gjatë ndërtimit do të zbatohen parimet e rrjedhës ekologjike duke siguruar kalimin e vazhdueshëm të ujit në drejtim të poshtëm në çdo kohë, shmangien e bllokimit ose devijimit të plotë të shtratit të përroit, si dhe kufizimin e shtrirjes dhe kohëzgjatjes së punimeve brenda shtratit të lumit.

Kur kërkohen devijime të përkohshme ose platforma pune, ato do të projektohen në mënyrë që të ruajnë lidhjen e mjaftueshme të rrjedhës dhe të shmangin reduktimin e tepruar të habitateve të lagura, veçanërisht gjatë periudhave me prurje të ulët. Sekuenca e ndërtimit do të minimizojë shqetësimin e kanalit aktiv, ndërsa strukturat e përkohshme do të hiqen menjëherë pas përfundimit të punimeve. Vetë projekti i urës ruan vazhdimësinë natyrore të shtratit dhe kapacitetin hidraulik të Përroit të Bejnit, përfshirë hapësirën e mjaftueshme të hapjes së urës dhe shmangien e ngushtimit të konsiderueshëm të kanalit, duke mbështetur kështu ruajtjen afatgjatë të kushteve të rrjedhës ekologjike dhe lidhjes së habitateve ujore.

Masat specifike që do të zbatohen për ruajtjen e rrjedhës ekologjike përfshijnë:

- shmangien e izolimit të plotë të kanalit të përroit,
- ndërtimin në faza brenda shtratit të lumit,
- sigurimin e kalimit funksional të organizmave ujorë: ruajtjen e një pjese funksionale të kanalit natyror të prurjes së ulët të hapur gjatë punimeve, që lejon migrimin dhe lëvizjen e papenguar të organizmave dhe materieve (peshq, amfibë, vezë, larva, ushqim etj.),
- ndalimin e depozitimit të panevojshëm ose pengimit brenda kanalit aktiv,
- rehabilitimin e shpejtë të brigjeve dhe substratit të shqetësuar.

Në varësi të prurjes, sigurimi i kalimit funksional të organizmave ujorë dhe ruajtja e rrjedhës ekologjike në kushte të prurjes së ulët (dhe kushteve të tjera) mund të arrihet përmes zgjidhjeve të mëposhtme:

- Instalimi i tubave të mëdhenj të inkorporuar: përdorimi i tubave me diametër të madh (si EUROFLO® HDPE ose tuba çeliku, me diametër minimal 800 mm), të varrosur ose të integruar në shtratin e përroit, lejon rikrijimin e substratit natyror (zhavorr, gurë, rërë) brenda tubit. Nuk duhet të vendosen objekte në hyrje ose dalje të tubit.
- Tubacione me deflektorë (baffles), nëse është e nevojshme, për të ulur shpejtësinë e ujit dhe për të krijuar zona pushimi për peshqit.
- Harqe tubash pa fund (bottomless pipe arches) për ruajtjen e karakteristikave natyrore të shtratit të përroit.
- Krijimi i kanaleve të izoluar me shtresa gjeotekstili dhe mbrojtje me gurë (riprap), për të ngadalësuar shpejtësinë e rrjedhës.

Kërkesat e projektimit për kalim efektiv përfshijnë:

- Shpejtësia dhe thellësia: Shpejtësia e ujit duhet të jetë mjaft e ulët që peshqit të mund të notojnë kundër saj, dhe thellësia duhet të jetë e mjaftueshme për kalim (uji i cekët me shpejtësi të lartë është një nga dështimet më të zakonshme).
- Vazhdimësia e substratit: Tubi duhet të imitojë shtratin natyror të përroit për të nxitur migrimin e organizmave.

- Orientimi: Tubi duhet të ndjekë pjerrësinë dhe drejtimin natyror të përroit për të shmangur krijimin e një daljeje “të ngritur” (kur tubi ndodhet më lart se niveli i ujit).
- Zgjidhje të përkohshme: Gjatë ndërtimit mund të përdoren sisteme fleksibël tubacionesh për vendosje të shpejtë, siç është evidentuar në studimet mbi teknologjitë e kalimit të peshqve përmes tubave. Përdorimi i tubave me përmasa më të mëdha se minimumi i nevojshëm për prurjen e ujit rekomandohet për të siguruar lidhjen ekologjike gjatë fazës së ndërtimit.

Restaurimi dhe rigjëlberimi

- Të gjitha zonat e shqetësuara përkohësisht duhet të rehabilitohen pas përfundimit të punimeve.
- Brigjet e lumit duhet të stabilizohen dhe të rigjëlberohen me specie vendase ripariane (p.sh. *Salix spp.*, *Populus spp.*), aty ku është e përshtatshme.
- Përdorimi i specieve jo-vendase ose invazive ndalohet.
- Rigjëlberimi duhet të synojë një normë minimale prej 80% mbijetese të bimësisë pas sezonit të parë të rritjes, me mbjellje zëvendësuese kur është e nevojshme.

Nëpërmjet zbatimit të këtyre masave, ndikimet në biodiversitet do të mbeten lokale, të përkohshme dhe të rikthyeshme, duke siguruar që funksionet ekologjike të korridorit të Përroit të Bejnit të ruhen dhe që habitatet e prekura të restaurohen në kushte të krahasueshme me gjendjen para ndërtimit.

4.2.8 Ndikimet Sociale

Ndërtimi i Urës së Klosit do të gjenerojë një sërë ndikimesh sociale të përkohshme brenda qytetit të Klosit dhe zonave përreth peri-urbane dhe rurale. Siç përshkruhet në kontekstin bazë, zona karakterizohet nga përdorimi i përzier banimi dhe bujqësor, me varësi të lartë nga lidhjet rrugore për lëvizjen e përditshme dhe aksesin në rrjetet rajonale, përfshirë Rrugën e Arbrit, e cila siguron lidhje më të mira me Tiranën dhe zonat bregdetare. Ura përfaqëson një nyje të rëndësishme lokale, dhe për këtë arsye shqetësimet gjatë ndërtimit mund të kenë ndjeshmëri të rritur sociale, megjithëse janë të kufizuara në kohë dhe hapësirë.

Punësimi lokal dhe efektet ekonomike afatshkurtra

Gjatë fazës së ndërtimit mund të krijohen mundësi të përkohshme punësimi për fuqinë punëtore lokale, furnitorët dhe ofruesit e shërbimeve. Edhe pse shkalla e kërkesës për punë pritet të jetë mesatare dhe nuk parashikohet fluks i madh punëtorësh të jashtëm, përfshirja lokale mund të:

- ofrojë mundësi të përkohshme të ardhurash,
- mbështesë bizneset e vogla lokale (p.sh. furnizim me karburant, shërbime ushqimore, logjistikë e vogël),
- kontribuojë në aktivitetin ekonomik lokal.

Duke marrë parasysh kontekstin socio-ekonomik lokal, edhe mundësi të kufizuara punësimi mund të sjellin efekte pozitive në nivel lokal.

Ndërprerja e Trafikut dhe Kufizimet e Aksesit (ESS4)

Ura funksionon si një nyje kyçe kalimi brenda një rrjeti rrugor lokal të kufizuar. Aktivitetet e ndërtimit, përfshirë lëvizjen e mjeteve të rënda dhe organizimin e përkohshëm të trafikut, mund të rezultojnë në:

- reduktim të hapësirës për manovrim dhe bllokime lokale të trafikut,
- vonesa për banorët, fermerët dhe ofruesit e shërbimeve,
- rritje të ndërveprimit midis trafikut të ndërtimit dhe përdoruesve të rrugës publike,
- rritje të rreziqeve të sigurisë, veçanërisht për këmbësorët dhe mjetet bujqësore.

Duke pasur parasysh rëndësinë e urës për akses në shkolla, shërbime shëndetësore, tregje dhe lidhje rajonale, edhe ndërprerjet afatshkurtra mund të ndikojnë lëvizshmërinë e përditshme. Ndikimi është i përkohshëm, por me ndjeshmëri mesatare për shkak të varësisë nga ky kalim.

Ndikime të përkohshme në aktivitetet bujqësore

Bujqësia mbetet një aktivitet i rëndësishëm në zonën përreth. Punimet e ndërtimit mund të shkaktojnë përkohësisht:

- vështirësi në akses për makineritë bujqësore,
- vonesa në transportin e inputeve ose produkteve bujqësore,
- kufizime të vogla operationale pranë hyrjeve të urës.

Nuk parashikohet humbje e përhershme e tokës bujqësore apo e aseteve prodhuese; megjithatë, mund të ndodhin ndërprerje logjistike afatshkurtra. Këto efekte janë të përkohshme dhe të menaxhueshme me koordinimin e duhur.

Ndikimet sociale të lidhura me shëndetin dhe sigurinë e komunitetit, përfshirë rreziqet e trafikut, trajtohen në Nënseksionin 4.2.5. Ndikimet shqetësuese si zhurma, pluhuri dhe vibrimet trajtohen në Nënseksionin 4.2.1, ndërsa aspektet që lidhen me tokën mbulohen në Nënseksionin 4.1.1.

Masat Zbutëse

Masat zbutëse do të zbatohen përmes K- PMMS të Kontraktorit nën mbikëqyrjen e Autoritetit Rrugor Shqiptar, në përputhje me ESS1, ESS4, ESS5 dhe ESS10.

Përmirësimi i efekteve pozitive ekonomike lokale

- Kur është e mundur, të prioritizohet punësimi i fuqisë punëtore lokale dhe përfshirja e furnitorëve lokalë, në përputhje me kërkesat e prokurimit.
- Të zbatohen procedura transparente punësimi për të siguruar mundësi të barabarta.
- Të nxitet furnizimi lokal i mallrave dhe shërbimeve, kur është teknikisht dhe komercialisht i realizueshëm.

Menaxhimi i Trafikut dhe Aksesit (ESS4)

Të përgatitet dhe zbatohet një Plan i Përshtatur për Menaxhimin e Trafikut dhe Aksesit përpara fillimit të punimeve.

- Të ruhet funksionaliteti i urës gjatë ndërtimit, kur është e mundur, duke minimizuar dhe njoftuar paraprakisht çdo mbyllje të përkohshme.
- Të sigurohet akses i sigurt dhe i vazhdueshëm për banorët, mjetet bujqësore dhe shërbimet emergjente.
- Të instalohen sinjalistika e duhur, barriera mbrojtëse dhe masa për kufizimin e shpejtësisë.
- Të vendosen punonjës të trajnuar për menaxhimin e trafikut gjatë aktiviteteve me rrezik të lartë.
- Të koordinohet me autoritetet lokale dhe përfaqësuesit e komunitetit për të përshtatur masat sipas kushteve lokale.

Zbutja e kufizimeve në aksesin bujqësor

- Të ruhet akses i vazhdueshëm në tokat bujqësore gjatë ndërtimit.
- Të komunikohen paraprakisht çdo kufizim i përkohshëm për përdoruesit e prekur.
- Kur është e mundur, punimet të planifikohen për të shmangur periudhat kulmore të aktiviteteve bujqësore.
- Të sigurohet kalim i sigurt për makineritë bujqësore pranë hyrjeve të urës.
- Të mbahet komunikim i vazhdueshëm me përdoruesit lokalë përmes mekanizmit të ankesave.

Zonat e rrezikut social të ndërlidhura

- Rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit trajtohen në Nënseksionin 4.2.5.
- Ndikimet nga zhurma, pluhuri dhe vibrimet trajtohen në Nënseksionin 4.2.1.
- Procedurat lidhur me tokën trajtohen në Nënseksionin 4.1.1.

Angazhimi i palëve të interesit do të vazhdojë gjatë gjithë fazës së ndërtimit. Komunitetet lokale do të informohen paraprakisht për oraret e punimeve, organizimin e trafikut dhe çdo ndërprerje të përkohshme. Do të mbahet një Mekanizëm funksional për Ankesat (Grievance Redress Mechanism) për të siguruar që shqetësimet të regjistrohen dhe trajtohen në kohë.

Nëpërmjet zbatimit të këtyre masave, ndikimet sociale do të mbeten të përkohshme, lokale dhe të menaxhueshme, duke mbështetur përfitimet ekonomike lokale dhe duke ruajtur aksesin dhe sigurinë e komunitetit.

4.2.9 Trashëgimia Kulturore

Karakterizimi i ndikimit

Nënprojekti i Urës së Klosit ndodhet në një peizazh peri-urban dhe rural të formuar nga përdorimi i gjatë njerëzor, përfshirë vendbanimet dhe aktivitetet bujqësore. Bazuar në vlerësimin bazë dhe të dhënat e disponueshme, nuk janë identifikuar site të trashëgimisë kulturore të mbrojtura, mbetje arkeologjike apo monumente të mbrojtura brenda gjurmës direkte të ndërtimit ose në afërsinë e saj të menjëhershme.

Duke marrë parasysh mungesën e aseteve të trashëgimisë së identifikuar brenda ose pranë zonës së projektit, nuk parashikohen ndikime të drejtpërdrejta fizike mbi burime të njohura të trashëgimisë kulturore. Mjedisi përreth nuk përfshin struktura me rëndësi të njohur kulturore ose historike që mund të preken nga aktivitetet e ndërtimit.

Megjithatë, si në shumicën e projekteve infrastrukturore që përfshijnë gjurmime, mbetet një rrezik i ulët por i pranishëm i gjetjeve arkeologjike rastësore, veçanërisht gjatë punimeve të themeleve ose lëvizjes së dherave në zona që më parë nuk janë shqetësuar. Korridoret lumore dhe tarracat përreth mund, në disa raste, të përmbajnë materiale arkeologjike në nëntokë që nuk janë të dukshme gjatë vlerësimeve bazë.

Në përgjithësi, ndikimet e lidhura me ndërtimin në trashëgiminë kulturore vlerësohen me intensitet të ulët dhe të kufizuara në shtrirje hapësinore, ku ndjeshmëria lidhet kryesisht me mundësinë e burimeve të pazbuluara dhe jo me asete të njohura.

Masat Zbutëse

Masat zbutëse do të zbatohen në përputhje me ESS8, legjislacionin kombëtar për trashëgiminë kulturore dhe Praktikën e Mira Ndërkombëtare të Industrisë.

Masat e përgjithshme

- Aktivitetet e ndërtimit do të kufizohen brenda gjurmës së miratuar të projektit për të shmangur shqetësimin e panevojshëm të zonave përreth.
- Do të zbatohen praktikat e mira të menaxhimit të kantierit, përfshirë organizimin e rregullt të materialeve dhe largimin në kohë të mbetjeve, për të shmangur ndikimin vizual të panevojshëm në peizazhin përreth.

Procedura për gjetje rastësore (Chance Finds Procedure)

- Do të hartohet dhe zbatohet një Procedurë për Gjetjet Rastësore përpara fillimit të punimeve të gjurmimit.
- I gjithë personeli ndërtimor do të informohet për këtë procedurë dhe do të trajnohet për të njohur materiale të mundshme arkeologjike.
- Në rast të një gjetjeje rastësore, punimet në zonën e prekur do të pezullohen menjëherë.
- Zona do të sigurohet dhe do të njoftohet menjëherë autoriteti kompetent për trashëgiminë kulturore.
- Punimet do të rifillojnë vetëm pas autorizimit formal nga autoriteti përkatës, pas çdo vlerësimi ose dokumentimi të nevojshëm.

Koordinimi institucional

- Ekipi i zbatimit të projektit do të koordinojë me autoritetet kompetente të trashëgimisë kulturore, përfshirë Drejtorinë Rajonale përkatëse dhe institucionet kombëtare, sipas nevojës gjatë fazës së lejeve dhe ndërtimit.

Në përfundim dhe gjatë vënies në punë, Ura e Klosit do të hyjë në fazën operacionale, gjatë së cilës ndikimet pritet të jenë kryesisht pozitive dhe afatgjata. Këto lidhen me përmirësimin e lidhshmërisë në rrjetin lokal rrugor dhe forcimin e lidhjes me korridorin e Rrugës së Arbrit, duke kontribuar në reduktimin e kohës së udhëtimit drejt Tiranës dhe zonave bregdetare. Ndikimet operative lidhen kryesisht me përmirësimin e sigurisë, performancës strukturore dhe efikasitetit hidraulik, ndërsa ndikimet negative janë të kufizuara dhe zakonisht lidhen me praktikatat e mirëmbajtjes.

Ndikime Pozitive

Përmirësimi i sigurisë rrugore

Ura e re do të përfshijë standarde moderne të projektimit, përfshirë barriera mbrojtëse (guardrails), gjeometri të përmirësuar të kuvertës, sinjalistikë dhe kalim më të sigurt për këmbësorët. Këto elemente pritet të ulin rrezikun e aksidenteve dhe të rrisin sigurinë si për automjetet ashtu edhe për këmbësorët, veçanërisht në kushtet e trafikut të përzier tipik për zonën peri-urbane.

Përmirësimi i lidhshmërisë dhe besueshmërisë

Struktura e përmirësuar do të ofrojë integritet më të lartë strukturor dhe kapacitet hidraulik më të mirë, duke ulur ndjeshmërinë ndaj përmbytjeve dhe degradimit. Kjo do të sigurojë akses më të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit për banorët, fermerët dhe ofruesit e shërbimeve, duke forcuar rolin e urës si nyje kryesore lokale.

Mbështetje për aktivitetin ekonomik lokal dhe rajonal

Përmirësimi i aksesit do të lehtësojë lëvizjen e produkteve bujqësore, mallrave dhe shërbimeve, duke mbështetur aktivitetin ekonomik lokal. Lidhja e përmirësuar me rrjetin rajonal rrugor, veçanërisht përmes Rrugës së Arbrit, do të kontribuojë në përfitime më të gjera socio-ekonomike.

Përmirësimi i performancës hidraulike dhe qëndrueshmërisë ndaj klimës

Dizajni i ri i urës përfshin masa të përmirësuar të drenazhimit dhe mbrojtjes nga erozioni (scour protection), duke rritur rezistencën ndaj ngjarjeve me prurje të larta dhe duke reduktuar rreziqet e përmbytjeve dhe erozionit përgjatë korridorit të Përroit të Bejnit.

Ndikime të mundshme negative

Edhe pse ndikimet operative janë kryesisht pozitive, mund të shfaqen disa efekte të vogla ose indirekte:

Karakteristikatat e trafikut

Përmirësimi i kushteve të rrugës mund të çojë në rritje të lehtë të shpejtësisë së automjeteve ose volumit të trafikut. Pa mirëmbajtjen e duhur, kjo mund të krijojë çështje të lokalizuara të sigurisë, veçanërisht për këmbësorët.

Rrjedhja sipërfaqësore dhe cilësia e ujit

Rrjedhja sipërfaqësore nga kuverta e urës mund të përmbajë sasi të vogla sedimenti, hidrokarburesh ose mbetjesh. Nëse sistemet e drenazhimit nuk mirëmbahen siç duhet, mund të shfaqen ndikime të lokalizuara në cilësinë e ujit. Megjithatë, sistemi i drenazhimit dhe menaxhimit të rrjedhjeve është integruar në projektimin e përgjithshëm hidraulik dhe të mbrojtjes nga erozioni për të siguruar kushte të sigurta drenazhimi dhe për të minimizuar ndikimet negative në Përroin e Bejnit dhe habitatet ripariane përreth. Prandaj, rreziku vlerësohet minimal.

Menaxhimi i vegjetacionit

Mirëmbajtja rutinë e hyrjeve të urës dhe zonave të drenazhimit mund të përfshijë prerje të vegjetacionit. Nëse nuk menaxhohet si duhet, pastrimi i tepruar mund të ndikojë vegjetacionin riparian dhe të rrisë ndjeshmërinë ndaj erozionit.

Mbetjet nga mirëmbajtja

Aktivitetet e mirëmbajtjes rutinë mund të gjenerojnë sasi të vogla mbetjesh, përfshirë mbetje nga pastrimi i drenazheve ose zëvendësimi i elementeve infrastrukture. Menaxhimi i papërshtatshëm mund të sjellë ndikime të lokalizuara mjedisore.

Në përgjithësi, ndikimet gjatë fazës operative vlerësohen pozitive në aspekt socio-ekonomik dhe të ulëta në aspekt mjedisor, me kusht që mirëmbajtja dhe monitorimi të kryhen në përputhje me ESF dhe legjislacionin kombëtar, duke zbatuar gjithmonë standardet më strikte. Vetëm kompanitë e licencuara lejohen të kryejnë mbledhjen dhe menaxhimin e mbetjeve. Hedhja e mbeturinave dhe depozitimi i paligjshëm ndalohe rreptësisht.

Masat Zbutëse dhe Menaxhimi

Gjatë fazës operative, përgjegjësia për menaxhimin mjedisor dhe social do t’i takojë autoritetit kompetent rrugor.

Inspektimi dhe mirëmbajtja rutinë

- Inspektim i rregullt i strukturës së urës, sistemeve të drenazhimit, nyjeve të zgjerimit dhe elementeve të mbrojtjes nga erozioni (scour protection);
- Pastrim periodik i sistemeve të drenazhimit për të parandaluar bllokimet dhe rrjedhjet e pakontrolluara;
- Riparim në kohë i elementeve të dëmtuara të sigurisë, përfshirë barrierat mbrojtëse dhe sinjalistikën.

Menaxhimi i sigurisë rrugore

- Mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore, vijëzimeve dhe masave për kontrollin e shpejtësisë;
- Monitorimi i kushteve të trafikut dhe performancës së sigurisë.

Menaxhimi mjedisor

- Mirëmbajtja e brigjeve të stabilizuara të lumit dhe vegjetacionit të rikthyer duke përdorur specie vendase;
- shmangia e pastrimit të panevojshëm të vegjetacionit përtej kërkesave të sigurisë;
- grumbullimi dhe asgjësimi i duhur i mbetjeve të lidhura me mirëmbajtjen.

Mbrojtja e cilësisë së ujit

- sigurimi i funksionimit të duhur të sistemeve të drenazhimit të urës;
- reagim i menjëhershëm ndaj derdhjeve aksidentale ose incidenteve që ndodhin mbi urë.

Përmes inspektimit sistematik, mirëmbajtjes parandaluese dhe zbatimit të Praktikave të Mira Ndërkombëtare të Industrisë, ndikimet e mbetura mjedisore dhe sociale gjatë fazës operative pritet të mbeten të ulëta dhe të menaxhueshme, ndërsa përfitimet afatgjata lidhur me sigurinë, lidhshmërinë dhe qëndrueshmërinë do të ruhen.

5. Masat e Zbatimit të PMMS

5.1 Qëllimi dhe Fusha e Zbatimit

Ky seksion përcakton rregullimet institucionale, përgjegjësitë, kërkesat e monitorimit dhe procedurat e raportimit për zbatimin e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) për nënprojektin e Urës së Klosit. Ai operacionalizon kërkesat e Kornizës Programore për Menaxhimin Mjedisor dhe Social (ESMF) dhe siguron përputhshmëri me Standardet përkatëse Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore (ESS) gjatë gjithë fazave: para-ndërtimit, ndërtimit dhe operimit.

Të gjitha masat zbutëse të listuara në PMMS, përfshirë masat specifike të paraqitura në tabelat në fund të këtij dokumenti, do të monitorohen gjatë zbatimit të punimeve.

Ky PMMS do të jetë pjesë e dokumenteve të tenderit dhe kontratës së punimeve. Ai do të zbatohet në mënyrë të barabartë për kontraktorët dhe nënkontraktorët.

Masat e parashikuara në PMMS do të zbatohen nga kontraktori dhe do të kontrollohen dhe raportohen rregullisht dhe shpesh pranë PIT/ARA nga supervizori. Raporti i përmbledhur i monitorimit do t’i dorëzohet Bankës Botërore në baza gjashtëmujore, përveç rasteve kur kërkohet ose dakordësohet ndryshe. Të gjitha mos-përputhjet duhet të adresohen menjëherë, ndërsa mosadresimi i tyre mund të çojë në ndërprerje të punimeve dhe madje edhe në ndalim të pagesave, deri në rivendosjen e përputhshmërisë mjedisore dhe sociale.

Rregullimet e përshkruara më poshtë janë të detyrueshme dhe zbatohen për Kontraktorin, Inxhinierin e Supervizionit dhe Ekipin e Zbatimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARA PIT).

5.2 Roli Institucional dhe Përgjegjësitë

Zbatimi i Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) për nënprojektin e Urës së Klosit do të kryhet përmes roleve dhe përgjegjësive institucionale të përcaktuara qartë, në përputhje me Kornizën Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore (ESF), Planin e Angazhimit Mjedisor dhe Social (ESCP) dhe dispozitat e Marrëveshjes së Financimit. Këto rregullime përcaktojnë qartë përgjegjësinë për zbatim, mbikëqyrje, monitorim, raportim dhe zbatim të detyrimeve mjedisore dhe sociale (E&S) gjatë gjithë periudhës së ndërtimit.

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH), përmes Ekipit të Zbatimit të Projektit (PIT), ka përgjegjësi të përgjithshme për sigurimin e përputhshmërisë me Kornizën Mjedisore dhe Sociale (ESF) dhe Standardet përkatëse Mjedisore dhe Sociale (ESS). Kontraktori është përgjegjës për zbatimin e përditshëm të të gjitha masave zbutëse, ndërsa Inxhinieri i Supervizionit siguron mbikëqyrje të vazhdueshme në emër të ARA. Këto role janë plotësuese dhe së bashku sigurojnë menaxhim efektiv të rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale në përputhje me kërkesat e Bankës Botërore.

Kontraktori

Kontraktori do të jetë përgjegjës për zbatimin e të gjitha masave mjedisore, sociale, të shëndetit dhe sigurisë në punë (ESHS) të aplikueshme për nënprojektin, siç përcaktohet në këtë PMMS, në Planin e miratuar të Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Kontraktorit (K-PMMS), në Kornizën Mjedisore dhe Sociale (ESMF) dhe në kontratën e punimeve. Këto detyrime do të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë nënkontraktorët dhe furnitorët e angazhuar nga Kontraktori.

Përgjegjësitë e Kontraktorit përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Përgatitjen, dorëzimin për miratim dhe zbatimin e një K-PMMS (plotësisht në përputhje dhe duke integruar të gjitha kërkesat e PMMS) dhe të të gjitha planeve të nevojshme specifike për kantierin (SSMP), përfshirë Planin për Prishje dhe Menaxhimin e Mbetjeve, Planin e Menaxhimit të Trafikut dhe Aksesit, Planin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, Planin e Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentimit, si dhe masat për Angazhimin e Palëve të Interesuara, përpara fillimit të punimeve dhe në një mënyrë të pranueshme për Inxhinierin e Supervizionit dhe ARA.
- Zbatimin e të gjitha masave zbutëse dhe menaxhuese lidhur me menaxhimin e mbetjeve dhe materialeve të rrezikshme, parandalimin e ndotjes, mbrojtjen e biodiversitetit dhe habitateve ripariante, kushtet e punës dhe punësimin, shëndetin dhe sigurinë e komunitetit, menaxhimin e trafikut dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në përputhje me ESS-të e aplikueshme.
- Krijimin, publikimin dhe funksionimin e mekanizmave për ankesa të punëtorëve dhe komunitetit, në përputhje me ESS2 dhe ESS10, përfshirë mbajtjen e regjistrave të ankesave dhe zgjidhjen në kohë të tyre.
- Monitorimin e vazhdueshëm të performancës ESHS, mbajtjen e regjistrave të saktë në kantier dhe përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve periodike të monitorimit ESHS në formën dhe frekuencën e përcaktuar në kontratë dhe në këtë PMMS.
- Njoftimin e menjëhershëm të Inxhinierit të Supervizionit dhe ARA PIT për çdo incident serioz, aksident, fatalitet ose mos-përputhje të rëndësishme, në përputhje me kërkesat e raportimit të ESF dhe ESCP.

- Sigurimin që të gjithë nënkontraktorët dhe furnitorët të përmbushin kërkesat e PMMS, K- PMMS dhe ESS-ve të aplikueshme, përmes dispozitave kontraktuale, trajnimeve, induksionit dhe mbikëqyrjes.
- Mbajtjen e regjistrave dhe paraqitjen e dokumentacionit përkatës kur kërkohet.
- Zbatimin e masave korrigjuese dhe veprimeve të kërkuara nga ARRSH PIT.

Inxhinieri Supervisor

Inxhinieri i Supervizionit do të veprojë në emër të ARA dhe do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe verifikimin e përditshëm të përputhshmërisë së Kontraktorit me PMMS, K-PMMS të miratuar dhe kërkesat përkatëse të ESS.

Përgjegjësitë e Inxhinierit të Supervizionit përfshijnë:

- Shqyrtimin dhe rekomandimin për miratim të K- PMMS të Kontraktorit, SSMP-ve dhe metodologjive të punës përpara fillimit të punimeve ndërtimore.
- Kryerjen e inspektimeve rutinë dhe të paplanifikuara në terren për të verifikuar përputhshmërinë me:
 - PMMS dhe K- PMMS të miratuar,
 - kërkesat kontraktuale ESHS, dhe
 - ESS-të përkatëse të Bankës Botërore dhe Udhëzimet për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë (EHS) të Grupit të Bankës Botërore.
- Verifikimin e të dhënave të monitorimit mjedisor dhe social, treguesve të performancës, regjistrave të trajnimeve, regjistrave të incidenteve dhe regjistrave të ankesave të dorëzuara nga Kontraktori, si dhe përcaktimin e masave korrigjuese.
- Identifikimin, dokumentimin dhe njoftimin formal të mos-përputhshmërive, si dhe dhënien e udhëzimeve për masa korrigjuese dhe parandaluese me afate të përcaktuara.
- Raportimin e menjëhershëm tek ARA PIT për çdo incident serioz, fatalitet, pretendime për SEA/SH (shfrytëzim dhe abuzim seksual/ngacim seksual), ose mos-përputhshmëri të vazhdueshme, në përputhje me klasifikimin dhe procedurat e raportimit të ESF.
- Ndjekjen dhe verifikimin që masat korrigjuese të dakorduara janë zbatuar në mënyrë efektive.

Inxhinieri i Supervizionit duhet të përfshijë specialistë të kualifikuar mjedisorë, të shëndetit dhe sigurisë në punë (OHS) dhe socialë, me përvojë në projekte infrastrukturore të financuara nga Banka Botërore ose institucione të tjera financuese ndërkombëtare (IFI).

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) – Ekipi i Zbatimit të Projektit (PIT)

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH), përmes Ekipit të Zbatimit të Projektit (PIT), ka përgjegjësi të përgjithshme për përputhshmërinë me ESF dhe për sigurimin që nënprojekti të zbatohet në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së Financimit, ESCP dhe ESS-ve të aplikueshme.

Përgjegjësitë e ARRSH PIT përfshijnë:

- Sigurimin që kërkesat e PMMS, K- PMMS dhe ESS të përfshihen në dokumentet e tenderit, kontratat e punimeve dhe procedurat e menaxhimit të kontratave.

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
 Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
 Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

- Mbikëqyrjen dhe koordinimin e Inxhinierit të Supervizionit, përfshirë shqyrtimin e rezultateve të mbikëqyrjes dhe performancës.
- Shqyrtimi dhe miratimi i raporteve të monitorimit ESHS, njoftimeve për incidente dhe planeve të masave korrigjuese të dorëzuara nga Kontraktori dhe Inxhinieri i Supervizionit.
- Monitorim periodik në terren nga specialistë të caktuar mjedisorë dhe socialë, duke përdorur lista kontrolli të standardizuara në përputhje me ESMF.
- Sigurimi i përgatitjes dhe dorëzimit të raporteve dhe deklaratave të monitorimit mjedisor pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare.
- Njoftim në kohë i Bankës Botërore për incidente të rëndësishme, aksidente ose mos-përputhshmëri materiale, në përputhje me ESF dhe ESCP.
- Përcaktimi dhe zbatimi i masave korrigjuese, përfshirë pezullimin e punimeve kur është e nevojshme, në rast të mos-përputhshmërisë serioze ose të përsëritur me PMMS ose detyrimet ESS.
- Raportim i konsoliduar mbi performancën mjedisore dhe sociale pranë Bankës Botërore si pjesë e raportimit të rregullt të progresit të projektit.

Palë të tjera relevante në zbatimin e PMMS

Përveç institucioneve kryesore zbatuese, mbikëqyrëse dhe mbikëqyrjes së përmendur më sipër, zbatimi efektiv i Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) për nënprojektin e Urës së Klosit kërkon koordinim me një sërë palësh të tjera të interesuara. Këto palë kanë role rregullatore, mbikëqyrëse, lehtësuese ose përfituese dhe kontribuojnë në përputhshmërinë me Kornizën Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore (ESF), legjislacionin kombëtar dhe Praktikën e Mira Ndërkombëtare të Industrisë.

Edhe pse ato nuk kanë përgjegjësi të drejtpërdrejta për zbatim, angazhimi i tyre është thelbësor për sigurimin e menaxhimit efektiv të rreziqeve, përputhshmërisë rregullatore dhe trajtimit të ankesave gjatë gjithë periudhës së ndërtimit.

Table 1 Stakeholders Involved in PMMS Implementation and Oversight

Palët e Interesuara	Roli në Zbatimin e PMMS	Rëndësia për ESS	Mekanizmi i Ndërveprimit / Koordinimit
Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Mbikëqyrje rregullatore sipas legjislacionit shqiptar për mjedisin; shqyrton deklaratat mjedisore dhe raportet e monitorimit; kryen inspektime	ESS1, ESS3, ESS6 \nSiguron që pajtueshmëria ligjore kombëtare të jetë në përputhje me kërkesat e ESF të Bankës Botërore. \nMund të kryejë inspektime dhe të kërkojë masa korrigjuese.	Merr periodikisht raportet e monitorimit; koordinohet me ARA PIT për pajtueshmërinë dhe masat korrigjuese
Pushteti Vendor (Bashkia)	Mbështet koordinimin lokal për menaxhimin e trafikut, organizimin e	ESS4, ESS10	Konsultohet për zbatimin e TMP/TAMP; njoftohet

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
 Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
 Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

	aksesit dhe komunikimin me komunitetin	Thelbësor për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë së komunitetit Mbështet shpërndarjen e informacionit mbi oraret e punimeve ndërtimore dhe ndërprerjet.	paraprakisht për mbylljet ose aktivitetet që shkaktojnë ndërprerje
Pushteti Vendor (Bashkia)	Mbështet koordinimin lokal për menaxhimin e trafikut, organizimin e aksesit dhe komunikimin me komunitetin	ESS4, ESS10 Thelbësor për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë së komunitetit, vazhdimësinë e trafikut dhe aksesin në shërbime. Mbështet shpërndarjen e informacionit mbi oraret e punimeve ndërtimore dhe ndërprerjet.	Konsultohet për zbatimin e TMP/TAMP; njoftohet paraprakisht për mbylljet ose aktivitetet që shkaktojnë ndërprerje
Policia Rrugore / Autoritetet e Sigurisë Rrugore	Mbështet zbatimin e menaxhimit të trafikut dhe masave të sigurisë rrugore në rrugët publike	ESS4 Rrit efektivitetin e TMP dhe ul rrezikun e aksidenteve.	Koordinim gjatë periudhave me trafik të lartë; inspektime ose kontrole të përbashkëta nëse kërkohet
Ofruesit e Shërbimeve Utilitare (Ujë, Energji Elektrike, Telekomunikacion)	Identifikimi, mbrojtja ose zhvendosja e utiliteteve; parandalimi i ndërprerjeve të shërbimeve	ESS1, ESS4 Parandalon ndërprerjet e shërbimeve dhe rreziqet dytësore të sigurisë.	Konsultim para gërmimeve; koordinim emergjent në rast dëmtimi aksidental
Autoritetet e Trashëgimisë Kulturore	Autoritet teknik në rast të gjetjeve të rastësishme; udhëzim për mbrojtjen dhe masat zbutëse	ESS8 Siguron përputhshmërinë me ligjin kombëtar për trashëgiminë dhe ESF.	Aktivizohet përmes Procedurës së Gjetjeve të Rastësishme; autorizon rifillimin e punimeve
Komunitetet Lokale dhe Përdoruesit e Tokës	Palë të prekura nga projekti dhe përfitues; japin feedback mbi aksesin, sigurinë dhe ndikimet shqetësuese	ESS4, ESS10 Burim kyç për paralajmërimin e hershëm të problemeve gjatë zbatimit.	Angazhim përmes SEP, njoftimeve publike dhe GRM; njoftim paraprak për punimet dhe ndryshimet në trafik
Operatorët e Licencuar të Mbetjeve dhe	Grumbullimi, transporti, trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve	ESS3	Kontraktohen nga Kontraktori; dokumentacioni

Impiantet e Depozitimit	të ndërtimit dhe prishjes	I nënshtrohen licencimit dhe mbikëqyrjes kombëtare.	shqyrtohet nga Inxhinieri Mbikëqyrës dhe ARA PIT
-------------------------	---------------------------	---	--

5.3 Frekuenca e Monitorimit dhe Raportimit

Monitorimi mjedisor dhe social do të kryhet gjatë gjithë periudhës së ndërtimit për të verifikuar përputhshmërinë me PMMS, K- PMMS të miratuar, Standardet përkatëse Mjedisore dhe Sociale (ESS) dhe kërkesat rregullore kombëtare. Aktivitetet e monitorimit do të jenë proporcionale me natyrën dhe shkallën e punimeve dhe me rreziqet e lidhura me to dhe do të zbatohen sipas frekuencave minimale të përcaktuara më poshtë.

5.3.1 Frekuenca e monitorimit

• Përditshëm (Daily)

- Inspektime vizuale të kantierit të kryera nga Kontraktori, duke mbuluar: pastërtinë e kantierit, kontrollin e pluhurit, organizimin e aksesit, magazinimin e mbetjeve, masat e sigurisë në trafik dhe kushtet e përgjithshme të kantierit.
- Praktikant e OHS dhe përdorimi i PPE-së (pajisjeve mbrojtëse personale).

• Javore (Weekly)

- Inspektime mjedisore, sociale dhe të shëndetit e sigurisë në punë të kryera nga Inxhinieri i Supervizionit, duke përfshirë verifikimin e:
 - praktikave të OHS dhe përdorimit të PPE-së,
 - menaxhimit të mbetjeve dhe materialeve të rrezikshme,
- masave për erozion, sedimentim dhe parandalimin e derdhjeve,
- masave për mbrojtjen e biodiversitetit dhe zonave ripariane,
- menaxhimit të trafikut dhe aksesit në kantier,
- përputhshmërisë së përgjithshme me PMMS dhe K- PMMS të miratuar.

• Mujore (Monthly)

- Monitorim instrumental mjedisor, kur kërkohet, duke përfshirë:
 - Cilësia e ajrit: grimcat PM₁₀ dhe PM_{2.5} dhe parametra të lidhur me djegien kur është e nevojshme;
 - Niveli i zhurmës: në receptorë të ndjeshëm dhe përgjatë rrugëve të aksesit;
 - Cilësia e ujit (kur kryhen punime në lumë): turbullira, lëndë të pezulluara, pH dhe vajra/yndyra të dukshme;
 - Gjendja e tokës: inspektim vizual për ndotje dhe testime të synuara për vajra dhe yndyra në rast derdhjesh ose rrjedhjesh të dyshuara.
- Përgatitja e raporteve mujore të konsoliduara të monitorimit mjedisor dhe social nga Kontraktori, të verifikuara dhe të plotësuara nga Inxhinieri i Supervizionit.
- Dorëzimi i raportit mujor të progresit dhe përputhshmërisë nga Inxhinieri i Supervizionit pranë ARA PIT.

• Gjashtëmujor (Semi-annually)

- Raportim i performancës mjedisore dhe sociale nga ARA pranë Bankës Botërore, përveç rasteve kur është dakordësuar ndryshe, duke përmbledhur statusin e zbatimit të PMMS, rreziqet kryesore, incidentet dhe masat korrigjuese.

5.3.2 Rregullimet e raportimit

Kontraktori dhe Inxhinieri i Supervizionit do të raportojnë për zbatimin e PMMS pranë ARA PIT në baza mujore, së bashku me raportimin mbi progresin fizik të punimeve. Raportet mujore do të përfshijnë një kapitull të dedikuar për performancën mjedisore dhe sociale, të strukturuar sipas kërkesave të PMMS dhe formateve të dakorduara të raportimit.

Në rast të ndonjë aksidenti serioz, fataliteti, incidenti të rëndësishëm mjedisor ose ndikimi të paparashikuar që nuk është parashikuar në PMMS, Inxhinieri i Supervizionit do të njoftojë ARA PIT brenda 24 orëve, në përputhje me kërkesat e raportimit të incidenteve të ESF të Bankës Botërore. Një raport i detajuar i incidentit, përfshirë analizën e shkaqeve dhe masat korrigjuese, do të dorëzohet më pas.

5.3.3 Përmbajtja e raporteve të monitorimit

Raportet e monitorimit mjedisor dhe social do të dorëzohen në baza mujore dhe do të përfshijnë, si minimum:

- Statusin e zbatimit të masave zbutëse dhe korrigjuese të PMMS;
- Rezultatet e monitorimit të krahasuara me treguesit dhe kufijtë e përcaktuar;
- Identifikimin e mos-përputhshmërive, incidenteve ose devijimeve, si dhe përshkrimin e masave korrigjuese dhe parandaluese të ndërmarra;
- Përmbledhjen e ankesave të pranuar, statusin e zgjidhjes së tyre dhe çështjet e mbetura;
- Regjistrin e aksidenteve, incidenteve, “near-miss” dhe masave pasuese;
- dokumentimi fotografik dhe regjistrat e inspektimeve në terren, kur është e nevojshme.
- informacione të tjera të kërkuara.

5.4 Raportimi i incidenteve dhe aksidenteve

Raportimi i incidenteve dhe aksidenteve do të kryhet në përputhje të plotë me ESCP dhe kërkesat e Kornizës Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore (ESF).

Kontraktori duhet të njoftojë menjëherë ARA PIT për çdo incident ose aksident të lidhur me Projektin që ka ose mund të ketë ndikim të rëndësishëm negativ në mjedis, komunitetet e prekura, publikun ose punëtorët, përfshirë, ndër të tjera, rastet e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual (SEA), ngacmimit seksual (SH), si dhe aksidentet që rezultojnë në vdekje, lëndime të rënda ose të shumëfishta. Njoftimi duhet të përfshijë detaje të mjaftueshme mbi shtrirjen, ashpërsinë dhe shkaqet e mundshme të incidentit ose aksidentit, duke treguar masat e menjëhershme të ndërmarra ose që planifikohen të ndërmerren për adresimin e tij, si dhe çdo informacion ose dokumentacion përkatës të kërkuar.

5.4.1 Njoftimi i menjëhershëm

Kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Inxhinierin e Supervizionit dhe ARA PIT për:

- Fatalitetet,
- Lëndime serioze ose që rrezikojnë jetën (lost-time injury),
- Aksidente të mëdha rrugore që përfshijnë publikun,
- Ngjarje të rëndësishme ndotjeje,
- Pretendime serioze për SEA/SH,
- “Near-miss” të rëndësishëm,
- Akte dhune/proteste,
- Shpërthime sëmundjesh,
- Punë të fëmijëve,
- Punë të detyruar,
- Ngjarje/ndikime të rëndësishme në trashëgiminë kulturore dhe biodiversitetin, OHS.

ARA PIT duhet të njoftojë Bankën Botërore brenda 24–48 orëve, në varësi të nivelit të seriozitetit, në përputhje me kërkesat e raportimit të incidenteve të ESF.

5.4.2 Hetimi dhe ndjekja e incidenteve

Për të gjitha incidentet e rëndësishme:

- Do të kryhet një hetim formal i incidentit.
- Do të identifikohen shkaqet rrënjësore.
- Do të përcaktohen dhe zbatohen masat korrigjuese dhe parandaluese.
- Do të dorëzohen raporte pasuese pranë ARA PIT dhe Bankës Botërore.

Të gjithë incidentet, përfshirë edhe rastet e mos-përputhshmërisë, do të regjistrohen në një regjistër incidentesh që do të mbahet nga Kontraktori. Për çdo incident që shkakton ose ka potencial të shkaktojë dëm serioz mjedisor dhe social, Inxhinieri i Supervizionit/Kontraktori duhet të njoftojë ARA/PIT sa më shpejt të jetë e mundur. Në raste të tilla, Kontraktori do të ndërpresë punimet deri sa të përfundojë rehabilitimi i situatës.

Mosraportimi i incidenteve ose mos-përputhshmëria serioze e përsëritur mund të çojë në pezullim të punimeve ose në sanksione kontraktuale.

5.5 Dokumentimi dhe gatishmëria për auditim

Të gjitha regjistrimet e monitorimit, listat e kontrollit të inspektimeve, raportet e incidenteve, regjistrat e ankesave dhe regjistrat e masave korrigjuese do të ruhen nga Kontraktori dhe Inxhinieri i Supervizionit dhe do të jenë të disponueshme për:

- shqyrtim të brendshëm nga ARA,
- misione mbikëqyrëse të Bankës Botërore,
- auditime të pavarura, nëse kërkohen.

Tabelat e Planit të Masave Zbutëse Mjedisore dhe Planit të Monitorimit përbëjnë instrumentin kryesor të përputhshmërisë dhe auditimit për nënprojektin e Urës së Klosit.

5.6 Ngritja e kapaciteteve për PMMS

Operatori i ndërtimit dhe të gjithë nënkontraktorët dhe/ose supervizori duhet të jenë plotësisht të vetëdijshëm për dispozitat e PMMS dhe të trajnuar për zbatimin e tij. Zbatimi efektiv i Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) kërkon që të gjitha institucionet dhe personeli i përfshirë në nënprojektin e Urës së Klosit të kenë kapacitete të mjaftueshme, ndërgjegjësime dhe kompetencë teknike në lidhje me menaxhimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale. Në përputhje me Kornizën Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore (ESF), Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMF) dhe praktikatat e mira ndërkombëtare, do të zbatohen masa të synuara për ngritjen e kapaciteteve gjatë fazave para-ndërtimore dhe ndërtimore. PMMS do të jetë pjesë e detyrueshme e dokumentacionit kontraktor për të gjithë nënkontraktorët.

Qëllimet e ngritjes së kapaciteteve për PMMS janë:

- të sigurohet që Kontraktori, Inxhinieri i Supervizionit, nënkontraktorët dhe Ekipi i Zbatimit të Projektit të ARA (PIT) të kuptojnë plotësisht detyrimet e tyre mjedisore dhe sociale;
- të mundësohet zbatimi efektiv, i qëndrueshëm dhe në kohë i masave zbutëse të PMMS;
- të forcohen proceset e monitorimit, raportimit dhe veprimeve korrigjuese; dhe
- të promovohet menaxhimi proaktiv i rrezikut, përputhshmëria me Standardet Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore (ESS) dhe përmirësimi i vazhdueshëm i performancës mjedisore dhe sociale.

Grupet

Aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve do të drejtohen, sipas rastit, për grupet e mëposhtme:

- Personeli i menaxhimit në kantier të Kontraktorit, personeli mjedisor, social, shëndetësor dhe i sigurisë në punë (ESHS), si dhe nënkontraktorët;
- Inxhinieri i Supervizionit, përfshirë specialistët mjedisorë dhe socialë përgjegjës për mbikëqyrjen në terren;
- Staf i ARA PIT përgjegjës për mbikëqyrjen mjedisore dhe sociale, raportimin dhe koordinimin me Bankën Botërore; dhe
- Kur është e nevojshme, autoritetet lokale dhe palët e tjera të interesuara të përfshira në menaxhimin e trafikut, reagimin emergjent ose komunikimin me komunitetin.

Fushëveprimi dhe përmbajtja e trajnimeve

Programet e trajnimit do të jenë në përpjesëtim me rreziqet e projektit dhe do të mbulojnë, si minimum, temat e mëposhtme:

- Përmbledhje e shkurtër e Kornizës Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore, EHSG dhe GIIP;
- Kërkesat e PMMS dhe masat zbutëse specifike për kantierin;
- Zbatimi i C- PMMS të Kontraktorit dhe planeve shoqëruese, përfshirë menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e trafikut dhe aksesit, kontrollin e erozionit dhe sedimentimit, mbrojtjen e biodiversitetit dhe gatishmërinë emergjente;

- Kërkesat për shëndetin dhe sigurinë në punë, përfshirë identifikimin e rreziqeve, praktikat e sigurta të punës, raportimin e incidenteve dhe reagimin emergjent, në përputhje me ESS2 dhe Udhëzimet EHS të Grupit të Bankës Botërore;
- Masat për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit, sigurinë rrugore dhe menaxhimin e aksesit në përputhje me ESS4;
- Angazhimi i palëve të interesuara dhe funksionimi i mekanizmave të ankesave për komunitetin dhe punëtorët, në përputhje me ESS10 dhe ESS2;
- Kushtet e punës dhe punësimit, Kodi i Sjelljes dhe parandalimi i shfrytëzimit dhe abuzimit seksual dhe ngacmimit seksual (SEA/SH);
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe zbatimi i Procedurës për Gjetje Rastësore (ESS8);
- Monitorimi mjedisor dhe social, mbajtja e regjistrave, raportimi dhe ndjekja e masave korrigjuese.

Koha dhe frekuenca

- Trajnimi fillestar (induction) do të ofrohet për të gjithë personelin e Kontraktorit dhe nënkontraktorët përpara fillimit të punimeve në kantier.
- Trajnime rifreskuese do të kryhen periodikisht, përfshirë kur ka ndryshime në personel, metoda ndërtimi ose mos-përputhshmëri të identifikuar.
- Trajnime të specializuara do të ofrohen përpara aktiviteteve me rrezik të lartë, si punimet e prishjes, punimet në lumë ose devijimet e trafikut.

Rolet dhe përgjegjësitë

- Kontraktori: Përgjegjës për sigurimin që i gjithë personeli në kantier dhe nënkontraktorët të marrin trajnim dhe induksion të përshtatshëm lidhur me PMMS, si dhe për mbajtjen e regjistrave të pjesëmarrjes në trajnim.
- Inxhinieri i Supervizionit: Përgjegjës për verifikimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të programeve të trajnimit dhe për identifikimin e nevojave shtesë për trajnim bazuar në vëzhgimet në terren.
- ARA PIT: Përgjegjës për ofrimin e përgjithshëm, përmbajtjen, koordinimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve, përfshirë ofrimin e trajnimeve për stafin e PIT dhe, kur është e nevojshme, lehtësimin e trajnimeve në përputhje me kërkesat e Bankës Botërore.

Dokumentimi dhe monitorimi

Të gjitha aktivitetet e trajnimit do të dokumentohen, përfshirë materialet e trajnimit, listat e pjesëmarrjes dhe vlerësimin e efektivitetit të tyre. Regjistrat e trajnimeve do të jenë të disponueshëm për shqyrtim nga Inxhinieri i Supervizionit, ARA PIT dhe Banka Botërore, kur të kërkohet. Efektiviteti i masave të ngritjes së kapaciteteve do të rishikohet periodikisht dhe do të përditësohet sipas nevojës për të adresuar mangësitë e identifikuar ose rreziqet e reja që mund të shfaqen.

5.7 Informimi dhe publikimi i informacionit

E drejta e publikut për t’u informuar është një proces i detyrueshëm sipas Konventës së Aarhus-it, të cilën Shqipëria e ka nënshkruar.

Konsultimi publik do të organizohet në Bashkinë e Klosit për të bërë publik dokumentin.

Ky projekt kërkon miratim mjedisor, por konsultimi publik për VNM nuk është i detyrueshëm sipas legjislacionit shqiptar. Megjithatë, në përputhje me Kornizën e Bankës Botërore (ESF), drafti i PMMS do të publikohet në gjuhën shqipe në Bashkinë Klos dhe në faqen e internetit të ARA. Komentet e mbledhura gjatë konsultimit publik do të merren parasysh në versionin përfundimtar të PMMS.

Në përfundim, ky nënprojekt klasifikohet si “Rrezik Substancial” sipas udhëzimeve të Bankës Botërore, pasi ndikimet e tij mjedisore dhe sociale mund të menaxhohen përmes zbatimit të masave zbutëse të përshtatshme të përshkruara në planet përkatëse të menaxhimit dhe monitorimit mjedisor dhe social.

5.8 Mekanizmi i Ankesave (ESS10)

Në përputhje me Standardin Mjedisor dhe Social 10 të Bankës Botërore (Angazhimi i Palëve të Interesuara dhe Publikimi i Informacionit), Standardin Mjedisor dhe Social 2 (Kushtet e Punës dhe Punësimit) dhe Kornizën Programore të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMF), për nënprojektin e Urës së Klosit është vendosur një Mekanizëm i Ankesave (GRM) në nivel projekti. GRM ofron një proces të strukturuar, transparent dhe të përshtatur kulturorisht për marrjen, vlerësimin dhe zgjidhjen e ankesave dhe shqetësimeve të lidhura me aktivitetet e projektit.

Mekanizmi i Ankesave për Punëtorët (Worker GRM)

Mekanizmi i Ankesave për Punëtorët është i disponueshëm për të gjithë punonjësit e angazhuar në projekt, përfshirë punëtorët e Kontraktorit dhe nënkontraktorëve. Ai siguron një kanal të veçantë, të sigurt dhe konfidencial për adresimin e shqetësimeve të lidhura me kushtet e punës dhe marrëdhëniet e punësimit, në përputhje me ESS2.

Ky mekanizëm trajton, por nuk kufizohet vetëm në, çështje si:

- kushtet e punës dhe pagesat;
- shëndeti dhe siguria në punë (OHS);
- diskriminimi ose trajtimi i padrejtë;
- shkelje të Kodit të Sjelljes;
- ngacmimi seksual dhe shfrytëzimi/abuzimi seksual (SEA/SH);
- mosrespektimi i orarit të punës dhe pushimeve;
- çdo shqetësim tjetër i lidhur me vendin e punës.

Punëtorët mund të paraqesin ankesa përmes:

- mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë në kantier;
- përfaqësuesit të Kontraktorit për ESHS;
- përfaqësuesit të Sindikatës ose personit të caktuar për çështje të punës (nëse aplikohet);
- kutive të ankesave të vendosura në kantier (ku është e mundur);
- kontaktit të drejtpërdrejtë me Supervizorin ose ARA PIT.

Të gjitha ankesat do të trajtohen në mënyrë konfidenciale dhe pa hakmarrje ndaj ankuesit. Çdo rast SEA/SH do të trajtohet sipas protokolleve specifike të konfidencialitetit dhe referimit të sigurt, në përputhje me kërkesat e ESS2 dhe ESS10.

Procedura e trajtimit të ankesave

GRM do të ndjekë një proces të strukturuar që përfshin:

- regjistrimin e ankesës menjëherë pas marrjes së saj;
- vlerësimin dhe klasifikimin sipas natyrës dhe urgjencës;
- hetimin dhe verifikimin e fakteve;
- propozimin e masave për zgjidhje;
- komunikimin e përgjigjes ndaj ankuesit brenda afateve të përcaktuara;
- ndjekjen dhe mbylljen e rastit pas zbatimit të zgjidhjes.

Të gjitha ankesat dhe mënyra e trajtimit të tyre do të dokumentohen në një regjistër të posaçëm të GRM-së, i cili do të jetë pjesë e raportimit periodik të PMMS.

Monitorimi dhe transparenca

- Performanca e GRM do të monitorohet rregullisht nga Kontraktori dhe Supervizori.
- ARA PIT do të kryejë verifikim dhe raportim periodik për efektivitetin e mekanizmit.
- Informacioni mbi numrin e ankesave dhe statusin e tyre do të përfshihet në raportet mujore dhe gjashtëmujore të PMMS.

Dispozita përfundimtare

Zbatimi efektiv i GRM konsiderohet një komponent thelbësor për menaxhimin e rreziqeve sociale dhe mjedisore të projektit. Mekanizmi synon të sigurojë zgjidhje të shpejtë të problemeve në nivel lokal, të shmangë përshkallëzimin e konflikteve dhe të forcojë marrëdhëniet midis projektit dhe komunitetit të prekur.

Monitorimi dhe raportimi

Zbatimi i Mekanizmit të Ankesave (GRM) do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar funksionim efektiv, transparencë dhe pajtueshmëri me kërkesat e ESF dhe ESMF.

- Kontraktori do të mbajë dhe përditësojë rregullisht regjistrin e ankesave, duke përfshirë statusin e trajtimit, veprimet korrigjuese dhe kohën e zgjidhjes.
- Inxhinieri i Supervizionit do të verifikojë saktësinë e regjistrimeve dhe efektivitetin e zgjidhjes së ankesave gjatë inspektimeve në terren dhe raportimeve periodike.
- ARA PIT do të kryejë mbikëqyrje të përgjithshme dhe do të sigurojë që të gjitha ankesat e rëndësishme të trajtohen në përputhje me procedurat e përcaktuara.
- Ankesat dhe statusi i tyre do të përfshihen në raportet mujore të Kontraktorit dhe Supervizorit, si dhe në raportet periodike të ARA PIT drejtuar Bankës Botërore.
- Çdo ankesë serioze, e përsëritur ose e pazgjidhur do të analizohet për të identifikuar shkaqet rrënjësore dhe për të përmirësuar performancën e projektit në të ardhmen.
- Të gjitha ankesat do të regjistrohen, gjurmohen dhe dokumentohen.

- Përmbledhje mujore e ankesave dhe statusit të zgjidhjes së tyre do të përfshihet në raportet e monitorimit të PMMS.
- Tendencat dhe çështjet e përsëritura do të analizohen dhe do të përdoren për të nxitur masa korrigjuese ose parandaluese.

5.9 Korniza e Menaxhimit dhe Monitorimit Mjedisor dhe Social

Monitorimi mjedisor dhe social për nënprojektin e Urës së Klosit strukturohet përmes dy instrumenteve kryesore:

- Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS), dhe
- Plani i Monitorimit Mjedisor dhe Social, i paraqitur në formë tabelare në PMMS.

Çdo tabelë është strukturuar për të përcaktuar qartë:

- Ndikimin ose rrezikun që po menaxhohet,
- Masat zbutëse ose monitoruese,
- Indikatorët dhe pragjet e matshme,
- Frekuencën e monitorimit,
- Subjektin përgjegjës,
- Mjetet e verifikimit / formatin e raportimit,
- Referencën përkatëse të ESS dhe ESMF.

Kjo strukturë siguron gjurmueshmëri të plotë midis rreziqeve të identifikuara, masave zbutëse, veprimeve të monitorimit dhe përgjegjësiwe institucionale.

efektiv kontribuon në reduktimin e rreziqeve sociale dhe të punës, si dhe në forcimin e besimit midis palëve të përfshira në projekt.

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

5.9.1 Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (Environmental and Social Management Plan)

Faza	Çështja	Masat Zbutëse	Kosto(EUR)		Përgjegjësia Institucionale		Komente
			Instalim	Operim	Instalim	Operim	
<i>Projektim / Para-ndërtim</i>	<i>Humbja e pemëve dhe vegjetacionit</i>	<i>Projektimi duhet të minimizojë pastrimin e vegjetacionit; çdo heqje e pashmangshme duhet të lejohet dhe të kompensohet përmes rimbjelljes me specie vendase</i>	<i>Kontrata e projektimit</i>		<i>Projektuesi -ARRSH</i>	<i>Kontraktori / Mbikëqyrësi (SE)</i>	<i>Zero heqje të paautorizuara të pemëve</i>
Projektim	<i>Siguria e trafikut dhe këmbësorëve</i>	<i>Projektimi duhet të përfshijë elemente të sigurisë rrugore, masa sigurie për transportin dhe trafikun për të reduktuar rrezikun e aksidenteve, për të garantuar qarkullimin e sigurt të automjeteve dhe këmbësorëve dhe për të ruajtur vazhdimësinë e trafikut gjatë ndërtimit dhe operimit, në përputhje me standardet kombëtare të projektimit rrugor, Kodin Rrugor Shqiptar dhe Udhëzimet WBG EHS për Shëndetin dhe Sigurinë e Komunitetit</i>	<i>Kontrata e projektimit</i>		<i>Projektuesi -ARRSH</i>		<i>Elementet e sigurisë të përfshira në projektin e miratuar</i>
<i>Projektim</i>	<i>Cenueshmëria sizmike</i>	<i>Projektimi strukturor në përputhje me Eurocode 8</i>	<i>Kontrata e projektimit</i>		<i>Projektuesi -ARRSH</i>		
<i>Projektim</i>	<i>Rreziku nga përmytjet dhe hidraulika</i>	<i>Ura duhet të projektohet për përmytje $\geq 1:100$ vjet, duke përfshirë ndikimin e ndryshimeve klimatike; të sigurohet që të mos pengohet rrjedha e ujit. Të projektohen themele dhe mbështetëse të ngritura për të përballuar luhatjet ekstreme të nivelit të ujit. Të instalohen sensorë monitorimi në kohë reale të nivelit të ujit për të zbuluar dhe reaguar ndaj ndryshimeve të papritura</i>	<i>Kontrata e projektimit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Projektuesi -ARRSH</i>		
<i>Projektim</i>	<i>Kontrasti i erozionit</i>	<i>Projektimi duhet të përfshijë mbrojtje kundër gërryerjes dhe masa për stabilizimin e brigjeve të lumit. Të përdoren teknika bioinxhinierike si mbjellja e vegjetacionit vendas përgjatë brigjeve dhe vendosja e gurëve mbrojtës rreth themeleve për të parandaluar erozionin</i>	<i>Kontrata e projektimit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Projektuesi -ARRSH</i>		
Projektim	<i>Stabiliteti i tokës</i>	<i>Të kryhen hetime të detajuara gjeoteknike. Projektimi duhet të integrojë stabilizimin e shpateve, mbrojtjen nga erozioni dhe projektimin e themeleve</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Projektuesi -ARRSH</i>		

<i>Projektim</i>	<i>Lidhja e biodiversitetit</i>	<i>Projektimi duhet të ruajë vazhdimësinë hidraulike dhe lëvizjen e faunës së egër. Punimet duhet të organizohen jashtë sezonit të shumimit të specieve të cënueshme ose të rrezikuara, kur është e mundur. Të miratohen vetëm projektet e ndriçimit që reduktojnë ndotjen nga drita, subjekt i miratimit nga Banka Botërore. Eksperti mjedisor do të inspektojë zonën për praninë e strogave të vidrës së ujit ose kafshëve. Në rast pranije, do të informohet menjëherë Banka Botërore dhe do të propozohen masa të mëtejshme</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Projektuesi -ARRSH</i>	<i>Projektuesi-ARRSH</i>	<i>Pa pengesa për rrjedhën e lumit / faunën</i>
<i>Projektim</i>	<i>Lejet</i>	<i>Të gjitha lejet e kërkuara ligjërisht (ndërtimore, mjedisore dhe të tjera) duhet të jenë marrë përpara fillimit të punimeve. Kontraktorët dhe nënkontraktorët duhet të kenë licenca të vlefshme operimi</i>	<i>NA</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>ARRSH, Bashkia dhe kontraktori</i>		<i>Të gjitha lejet janë marrë para mobilizimit</i>
<i>Projektim</i>	<i>Pjesëmarrja publike, konsultimi dhe njoftimi</i>	<i>Komentet përkatëse nga (i) projektimi paraprak dhe (ii) konsultimet publike të PMMS -së do të adresohen në projektin përfundimtar dhe PMMS-në e rishikuar. Të gjitha institucionet përkatëse (p.sh. policia rrugore, inspektorati i ndërtimit, mjedisit dhe sigurisë në punë, etj.) duhet të njoftohen për punimet e ardhshme. Publiku duhet të marrë informacion në kohë dhe të përshtatshëm përmes mjeteve adekuate dhe sipas shtrirjes gjeografike dhe kohore</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>ARRSH</i>	<i>Projektuesi-ARRSH</i>	<i>Komentet e adresuara në projektin final</i>
Para-ndërtim	<i>Angazhimi i palëve të interesuara dhe njoftimi/shpalo sja para ndërtimi</i>	<i>Duhet të përgatitet dhe zbatohet Plani i miratuar i Angazhimit të Palëve të Interesuara (SEP) si pjesë e C- PMMS , në koordinim me ARA. Para fillimit të punimeve, kontraktori duhet: • Të kryejë njoftime para-ndërtimore për komunitetet dhe palët e prekura; • Të publikojë informacion kyç mbi objektin, afatin, ndikimet dhe kontaktet; • Të koordinohet me autoritetet dhe institucionet lokale</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Kontraktori</i>	<i>Mbikëqyret nga SE</i>	<i>Plani i miratuar para fillimit të ndërtimit</i>
Para-ndërtim	<i>Rreziqe E&S të pamenaxhuara</i>	<i>Kontraktori duhet të përgatisë një C-PMMS gjithëpërfshirës duke përfshirë të gjitha (1) kërkesat e PMMS -së dhe (2) nënplanet (Plani i Menaxhimit të Mbetjeve, Plani i Prishjes, Plani i Menaxhimit të Trafikut, Plani i Emergjencave dhe Reagimit ndaj</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>		<i>Kontraktori</i>	<i>Mbikëqyret nga SE</i>	<i>C-ESMP i miratuar para fillimit të punimeve</i>

		<i>Derdhjeve, Plani i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, Plani i Kontrollit të Erozionit dhe Sedimenteve, Plani i Shëndetit dhe Sigurisë së Komunitetit, Plani i Materialeve të Rrezikshme, SEP/GRM). C-ESMP duhet të përcaktojë rolet, planimetrinë e kantierit, metodologjitë e punimeve, indikatorët e monitorimit, procedurat e raportimit dhe kërkesat për trajnim.</i>					
Para-ndërtim	<i>Zhvendosja e pavullneshme</i>	<i>Përgatitja e Planit të Veprimit për Zhvendosje në rast se kërkohet zhvendosje e pavullneshme; ARRSH duhet të verifikojë që të gjitha blerjet e tokës janë përfunduar përpara fillimit të ndërtimit. Nëse lindin ndikime shtesë, të përgatitet dhe zbatohet RAP/RAP i Shkurtuar në përputhje me ESS5. Të sigurohen konsultimi, kompensimi dhe dokumentimi i personave të prekur.</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>		<i>ARRSH / Projektuesi / Bashkia</i>	<i>ARRSH</i>	<i>Pa zhvendosje fizike ose ekonomike</i>
Para-ndërtim	<i>Trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve</i>	<i>Të përgatitet dhe zbatohet një Plan i Prishjes dhe Menaxhimit të Mbetjeve duke përfshirë identifikimin e mbetjeve, klasifikimin (të rrezikshme / jo të rrezikshme), ndarjen në burim, ruajtjen e përkohshme (të mbrojtura / të etiketuara), transportin nga operatorë të licencuar dhe rrugët e depozitimit përfundimtar. Të përfshihen procedurat e kontrolluara të prishjes për të parandaluar ndotjen e lumit. Plani duhet të përmbushë kërkesat e protokollit të menaxhimit të mbetjeve nga ndërtimi dhe prishja.</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Kontraktori / SE</i>		<i>Plani i miratuar para fillimit të ndërtimit</i>
Para-ndërtim	<i>Siguria e trafikut dhe këmbësorëve</i>	<i>Të përgatitet një Plan i Menaxhimit të Trafikut (TMP) që siguron rrjedhë të sigurt të trafikut, akses të këmbësorëve, sinjalistikë, devijime dhe akses emergjence. Të ruhet funksionimi i urës ekzistuese dhe aksesit në prona dhe toka bujqësore. Të merret miratimi nga autoriteti kompetent. Plani duhet të miratohet nga autoriteti kompetent (p.sh. Ministria e Brendshme ose policia rrugore lokale).</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Kontraktori / SE</i>		<i>Plani i miratuar para fillimit të ndërtimit</i>
Para-ndërtim	<i>Incidente emergjente</i>	<i>Të përgatitet një Plan Emergjence dhe Reagimi ndaj Derdhjeve që mbulon derdhjet, zjarret, përmytjet, aksidentet</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Kontraktori / SE</i>		<i>Plani i miratuar dhe i publikuar</i>

		<i>dhe ndotjen e lumit. Të përfshihen kontaktet emergjente, procedurat e reagimit, protokollet e komunikimit dhe trajnimet. Të sigurohen pajisje për përballimin e derdhjeve në të gjitha vendet përkatëse përpara mobilizimit.</i>					
Para-ndërtim	<i>Situata aksidentale</i>	<i>Të përgatitet një Plan i Përgjithshëm i Gatishmërisë për Emergjencën, duke përfshirë procedurat e evakuimit, ndihmën e parë, raportimin e incidenteve dhe koordinimin me autoritetet. Të zhvillohen trajnime dhe simulime praktike për punëtorët.</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>		<i>Kontraktori / SE</i>		<i>Plani i miratuar para fillimit të ndërtimit</i>
Para-ndërtim	<i>Menaxhimi i mbetjeve</i>	<i>Të identifikohen dhe kontraktohen operatorë të licencuar për menaxhimin e mbetjeve dhe impiante depozitimi për të gjitha llojet e mbetjeve (inerte, jo të rrezikshme dhe të rrezikshme). Të verifikohet licencimi dhe kapaciteti i tyre. Kur kërkohet, të organizohet transporti drejt impianteve rajonale/kombëtare ose eksporti në përputhje me legjislacionin.</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>		<i>Kontraktori / SE</i>		
Para-ndërtim	<i>Pastrimi i pakontrolluar i kantierit</i>	<i>Të kufizohet pastrimi vetëm brenda zonës së miratuar të projektit; të rrethohen zonat e ndjeshme dhe të mbrohet vegjetacioni përgjatë brigjeve të lumit. Të përcaktohet qartë zona e miratuar e punimeve; të rrethohen zonat e ndjeshme dhe të mbrohet vegjetacioni përgjatë brigjeve të lumit.</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>		<i>Kontraktori / SE</i>		<i><u>Nuk lejohet pastrimi i vegjetacionit jashtë zonave të miratuara</u></i>
Para-ndërtim	<i>Dëmtimi i infrastrukturës / shërbimeve utilitare</i>	<i>Të kryhen verifikime të rrjeteve utilitare; të koordinohet puna me ofruesit e shërbimeve dhe të zbatohet sistemi i lejeve për gërmime.</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Kontraktori / ARRSH</i>	<i>Kontraktori / SE</i>	<i>Zero ndërprerje të paplanifikuara të shërbimeve</i>
<i>Projektin</i>	<i>Menaxhimi i ujërave – turbullira</i>	<i>Të projektohen tombinot, sistemet e drenazhimit dhe shkarkimet në mënyrë që uji të mos hyjë në mjedisin pritës duke shkaktuar turbullirë ose dëmtim të tokës.</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Projektuesi / ARrsh</i>	<i>Kontraktori / SE</i>	
Ndërtim	<i>Emetimet e pluhurit</i>	<i>Të zbatohen masa të vazhdueshme për kontrollin e pluhurit, duke përfshirë spërkatjen e rregullt me ujë të rrugëve të transportit dhe sipërfaqeve të ekspozuara, si dhe mbulimin e kamionëve që transportojnë materiale të imëta.</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Kontraktori</i>	<i>Mbikëqyret nga SE</i>	<i>Asnjë nivel i tepërt pluhuri përtej kufirit të kantierit; zbatohet kontrolli i shpejtësisë; ankesat regjistrohen</i>

		<p><i>Të kufizohet shpejtësia e automjeteve brenda zonës së ndërtimit, me maksimum 30 km/orë në zonat e banuara.</i></p> <p><i>Të stabilizohen dhe mbulohen grumbujt e materialeve dhe të zbatohet rehabilitimi progresiv i zonave të dëmtuara.</i></p> <p><i>Të minimizohen aktivitetet që gjenerojnë pluhur gjatë kushteve të thata dhe me erë, si dhe të rritet spërkatja me ujë gjatë prishjeve dhe punimeve intensive të dheut.</i></p> <p><i>Sipërfaqet e dëmtuara të rehabilitohen sa më shpejt të jetë e mundur.</i></p> <p><i>Të monitorohen emetimet e dukshme të pluhurit dhe të regjistrohen e trajtohen çdo ankesë e komunitetit lidhur me pluhurin.</i></p>					
Ndertim	Zhurma dhe vibrimet	<p><i>Punimet të kufizohen gjatë orëve standarde të ditës, përveç rasteve kur miratohen ndryshe nga Inxhinieri. Të planifikohen dhe programohen prishjet dhe aktivitetet e tjera me nivel të lartë zhurme për të reduktuar shqetësimet ndaj receptorëve pranë zonës së punimeve.</i></p> <p><i>Të sigurohet që të gjitha pajisjet e ndërtimit të jenë të pajisura me silenciatorë të përshtatshëm dhe të mirëmbahen në gjendje të mirë pune.</i></p> <p><i>Të monitorohen nivelet e zhurmës në receptorët e ndjeshëm të përcaktuar për të verifikuar përputhjen me kufijtë e zbatueshëm.</i></p> <p><i>Të instalohen barriera ose ekrane të përkohshme kundër zhurmës pranë receptorëve të ndjeshëm në rastet kur monitorimi tregon tejkallim të kufijve.</i></p> <p><i>T'u jepet njoftim paraprak komuniteteve pranë zonës së punimeve përpara fillimit të aktiviteteve me zhurmë të lartë ose aktiviteteve shqetësuese. Të kontrollohen aktivitetet që gjenerojnë vibrime, përfshirë prishjet dhe pilotimet, dhe të aplikohen metoda ndërtimi me vibrime më të ulëta kur kjo është teknikisht e realizueshme.</i></p> <p><i>Të monitorohen nivelet e vibrimeve gjatë punimeve të prishjes dhe pilotimit në pikat e përcaktuara të monitorimit, duke përfshirë zonat pranë strukturave ngjitur.</i></p>	E përfshirë në koston e projektit	E përfshirë në koston e projektit	Kontraktori	Mbikëqyret nga SE	Zhurma ≤ 65 dB(A) në zonat e banimit (gjatë ditës); regjistër i ankesave

<i>Ndertim</i>	<i>Emetimet e gazrave në ajër</i>	<i>Nuk lejohet mbajtja ndezur e motorëve në regjim bosh (>3 minuta); të kryhet mirëmbajtje e rregullt e pajisjeve; ndalohet djegia e hapur; të përdoren karburante në përputhje me standardet.</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Kontraktori</i>	<i>Mbikëqyret nga SE</i>	<i>Nuk lejohet djegia e hapur; regjistrat e mirëmbajtjes të disponueshëm</i>
<i>Ndertim</i>	<i>Aksidentet në trafik dhe siguria rrugore</i> <i>Kufizimi i aksesit të komunitetit</i>	<i>Të zbatohet Plani i miratuar i Menaxhimit të Trafikut, duke përfshirë instalimin e sinjalistikës dhe angazhimin e personelit të trajnuar për drejtimin e trafikut. Të vendosen kufizime sigurie për shpejtësinë. Të instalohen barriera fizike për të ndarë zonat e ndërtimit nga korsitë aktive të trafikut dhe zonat e këmbësorëve. Të zbatohen dhe të monitorohen masat për kontrollin e shpejtësisë brenda dhe përreth kantierit të ndërtimit. Ura ekzistuese të mbahet funksionale gjatë gjithë periudhës së ndërtimit, përveç rasteve të mbylljeve afatshkurtra të miratuara paraprakisht nga Inxhinieri. Të sigurohet akses i sigurt për këmbësorët, duke përfshirë kalime të përcaktuara qartë dhe sinjalistikë paralajmëruese. Të garantohet akses i vazhdueshëm drejt banesave, tokave bujqësore dhe shërbimeve thelbësore, përfshirë aksesin e automjeteve emergjente në çdo kohë.</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Kontraktori</i>	<i>Mbikëqyret nga SE</i>	<i>TMP i miratuar është zbatuar; zero incidente madhore që lidhen me punimet Aksesi i vazhdueshëm është ruajtur / Pa izolim të paplanifikuar të komuniteteve</i>
<i>Ndertim</i>	<i>Erozioni i tokës dhe transporti i sedimenteve</i>	<i>Të instalohen barriera për sendimentet përpara fillimit të punimeve të dheut dhe të mirëmbahen gjatë gjithë periudhës së ndërtimit. Të kryhen gërmime me faza dhe të sigurohet heqja, ruajtja dhe ripërdorimi i duhur i shtresës sipërfaqësore të tokës. Të instalohen sisteme të përkohshme drenazhimi dhe masa për kontrollin e erozionit për të parandaluar rrjedhjen dhe transportin e sedimenteve drejt tokave dhe rrjedhave ujore përreth. Të mos depozitohen materialet e gërmuara brenda zonës së përmytjes ose pranë brigjeve të lumit, përveç rasteve kur</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>E përfshirë në koston e projektit</i>	<i>Kontraktori</i>	<i>Mbikëqyret nga SE</i>	<i>Pa erozion të dukshëm ose rrjedhje të pakontrolluar të sedimenteve</i>

		<p>janë të izoluar dhe të mbrojtura në mënyrë adekuate nga rrjedhjet.</p> <p>Të stabilizohen gradualisht zonat e ekspozuara përmes riformësimit të terrenit dhe revegetimit me specie vendase.</p> <p>Të kufizohet lëvizja e makinerive të rënda vetëm në rrugët e përcaktuara të aksesit për të minimizuar ngjeshjen e tokës.</p> <p>Në rast derdhesh, toka e kontaminuar të izolohet menjëherë, të hiqet dhe të depozitohet në një impiant të miratuar.</p> <p>Të rehabilitohen gradualisht zonat e dëmtuara pas përfundimit të punimeve, duke përfshirë riformësimin e terrenit, zëvendësimin e shtresës sipërfaqësore të tokës dhe revegetimin me specie vendase të përshtatshme.</p>					
Ndertim	Ndotja e ujit / turbullira	<p>Të izolohen punimet brenda rrjedhës së lumit dhe të instalohen diga të përkohshme (cofferdams) kur kërkohet për të kontrolluar rrjedhën e ujit dhe përhapjen e sedimenteve.</p> <p>Të ndalohet shkarkimi i ujërave të patrajuara në Përroin e Bejnit.</p> <p>Të ndalohet larja e pajisjeve brenda ose pranë rrjedhës ujore</p> <p>Të përcaktohen zona për larjen e pajisjeve larg rrjedhës ujore, me grumbullim dhe depozitim të duhur të ujërave të përdorura nga larja.</p> <p>Furnizimi me karburant të kryhet vetëm në zona të përcaktuara, me sipërfaqe të papërshkueshme dhe masa për kontrollin e derdhjeve, të vendosura larg ujit.</p> <p>Të sigurohen gropa të papërshkueshme nga uji për larjen e çimentos aty ku është e nevojshme.</p> <p>Nuk do të lejohet parkimi pranë brigjeve të lumit.</p>	E përfshirë në koston e projektit	E përfshirë në koston e projektit	Kontraktori	Mbikëqyret nga SE	Nuk ka shtresë të dukshme vaji; turbullira është e kontrolluar; nuk ka shkarkime direkte
Ndertim	Materialet e rrezikshme dhe derdhjet	<p>Ruani karburantet dhe materialet e rrezikshme në zona të izoluar me barriera mbrojtëse dhe sipërfaqe të papërshkueshme, me kapacitet minimal prej 110% të vëllimit të materialit të ruajtur, të vendosura në një distancë të sigurt nga rrjedha ujore.</p> <p>Përdorni konteinerë të sigurt dhe të</p>	E përfshirë në koston e projektit	E përfshirë në koston e projektit	Kontraktori	Mbikëqyret nga SE	Pajisjet për përballimin e derdhjeve janë të disponueshme; zero derdhje të pakontrolluara; raportet e incidenteve mbahen të përditësuar

		<p>etiketuar qartë për të gjitha substancat e rrezikshme.</p> <p>Siguroni pajisje për menaxhimin e derdhjeve aksidentale (spill kits) në të gjitha frontet aktive të punës dhe garantoni që personeli të jetë i trajnuar për procedurat e reagimit ndaj derdhjeve.</p> <p>Përbani dhe rehabilitoni menjëherë çdo derdhje aksidentale.</p> <p>Asgjësoni mbetjet e rrezikshme përmes operatorëve të licencuar, në përputhje me rregulloret në fuqi.</p>					
Ndertim	Menaxhimi i papërshtatshëm i mbetjeve	<p>Zbatoni Planin e miratuar të Menaxhimit të Mbetjeve si pjesë të Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMP) të Kontraktorit.</p> <p>Përcaktoni zona të përkohshme dhe të shënuara qartë për depozitimin e mbetjeve, të vendosura larg lumit dhe kanaleve të kullimit. Të ndahen mbetjet në burim dhe t'i jepet përparësi ripërdorimit dhe riciklimit kur është e mundur.</p> <p>Të gjitha mbetjet të depozitohen përmes operatorëve të licencuar dhe në impiante të miratuara.</p> <p>Të ndalohet hedhja e çdo lloj mbetjeje në lumë, në brigjet e lumit ose në zonat e përmytshme.</p> <p>Të mbahen regjistra për gjurmimin e mbetjeve, duke përfshirë sasinë e gjeneruara, të ripërdorura, të ricikluara dhe të depozituara.</p> <p>Të sigurohet etiketimi, ruajtja dhe ndarja e duhur e materialeve të rrezikshme.</p> <p>Të sigurohen pajisje për përballimin e derdhjeve në zonat e ruajtjes së karburantit dhe në zonat aktive të punës.</p> <p>Toka ose materialet e kontaminuara të izoloohen, mblidhen dhe depozitohen menjëherë pas çdo derdhjeje.</p> <p>Personeli të trajnohet për trajtimin e mbetjeve, ruajtjen dhe procedurat e reagimit ndaj emergjencave.</p>	E përfshirë në koston e projektit	E përfshirë në koston e projektit	Kontraktori	Mbikëqyret nga SE	Dokumentacioni i transferimit të mbetjeve është i disponueshëm; nuk lejohet depozitimi i paligjshëm

Table 2: Environmental and Social Mitigation Plan

NDËRTIMI	SHQETËSIMI I BIODIVERSITETIT (TOKËSOR)	<p>TË MINIMIZOHET GJURMA E PUNIMEVE; TË MBROHET BIMËSIA RIPARIANE; TË NDALOHET GJUETIA; TË RIKTHEHEN ZONAT E PREKURA ME SPECIE VENDORE.</p> <p>TË KUFIZOHEN PUNIMET RIGOROZISHT VETËM NË GJURMËN E MIRATUAR; TË CAKTOHEN DHE TË SHËNOHEN FIZIKISHT TË GJITHA ZONAT JASHTË SAJ, PËRFSHIRË ZONAT RIPARIANE, SI ZONA TË NDALUARA .</p> <p>TË RUHET BIMËSIA RIPARIANE NË MASËN MË TË MADHE TË MUNDSHME; TË NDALOHET DEPOZITIMI I MATERIALEVE, QASJA E MJETEVE, HEDHJA E MBETJEVE DHE ÇDO SHQETËSIM BRENDA ZONAVE TË NDALUARA.</p> <p>TË KUFIZOHET HEQJA E BIMËSISË VETËM NË ZONA THELBËSORE; HEQJA E PEMËVE LEJOHET VETËM PËR ARSYE TË JUSTIFIKUARA TË SIGURISË/INXHINIERIKE DHE VETËM ME MIRATIM PARAPRAK DHE DOKUMENTIM.</p> <p>TË KRYHET INSPEKTIM PARA HEQJES SË BIMËSISË NGA NJË SPECIALIST I KUALIFIKUAR MJEDISOR PËR TË KONFIRMUAR MUNGESËN E SPECIEVE TË MBROJTURA, STREHËVE OSE FOLEVE.</p> <p>TË ZBATOHET HEQJE E GRADUAR DHE NË FAZA PËR TË LEJUAR LARGIMIN NATYRAL TË FAUNËS; TË INSPEKTOHEN GËRMIMET ÇDO DITË DHE TË RIVENDOSEN NË MËNYRË TË SIGURT ÇDO KAFSHË E MBAJTUR BRËNDA.</p> <p>TË NDALOHET RIGOROZISHT GJUETIA, PESHKIMI, MBLEDHJA E FLORES/FAUNËS, ZJARRI I HAPUR DHE MBLEDHJA E DRURËVE NGA TË GJITHË PUNËTORËT.TË NDALOHET PËRDORIMI OSE FUTJA E SPECIEVE JO-VENDORE OSE INVAZIVE.</p> <p>TË RIKTHEHEN TË GJITHA ZONAT E PREKURA ME SPECIE VENDORE DHE TË PËRSHTATSHME PËR TERRITORIN.TË ARRIHET ≥80% MBIJETESË E BIMËVE PAS SEZONIT TË PARË TË RRRITJES; BIMËT E DËSHTUARA TË ZËVENDËSOHEN NË SEZONIN PASUES.</p>	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	KONTRAKT ORI	SUPERVIZORI SE	PA HEQJE JASHTË GJURMËS SË MIRATUAR; RIKTHIMI I ZONAVE I PËRFUNDUAR
NDËRTIMI	NDIKIMET NË HABITATET UJORE	TË SIGUROHET RRJEDHJE E PAKUFIZUAR EKOLOGJIKE GJATË PUNIMEVE. TË MINIMIZOHET KOHA E PËRDORIMIT TË BYPASS-EVE. TË KUFIZOHEN PUNIMET BRENDA LUMIT VETËM NË	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	PËRFSHIRË NË KOSTON	KONTRAKT ORI	SUPERVIZORI SE	BRIGJET E RIKTHYERA; VAZHDIMËSIA HIDRAULIKE E MBAJTUR

		<p>SIPËRFAQEN DHE KOHËZGJATJEN MINIMALE TË NEVOJSHME. TË PLANIFIKOHEN KËTO PUNIME JASHTË PERIUDHAVE TË NDJESHME EKOLOGJIKE, KUR ËSHTË E MUNDSHME.</p> <p>TË NDALOHEN PUNIMET BRENDA LUMIT GJATË NATËS DHE NDËRHYRJET ME NDRIÇIM ARTIFICIAL TË PAKONTROLLUAR PRANË RRJEDHËS UJORE.</p> <p>TË ZBATOHEN GJITHMONË MASA PËR KONTROLLIN E SEDIMENTEVE DHE EROZIONIT, ME QËLLIM PARANDALIMIN E TURBULLIRËS DHE DEGRADIMIT TË HABITATEVE.</p> <p>TË NDALOHET SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA TË PATRJATUARA NË PËRROIN DUNAVECI.</p> <p>TË RIKTHEHEN BRIGJET E LUMIT DHE ZONAT E PREKURA NË PROFILIN E TYRE ORIGJINAL DHE TË STABILIZOHEN ME TEKNIKA TË PËRSHTATSHME TË INXHINIERISË BIOLOGJIKE.</p> <p>TË RIBIMËSËROHEN ZONAT E PREKURA VETËM ME SPECIE VENDORE RIPARIANE, PËRFSHIRË SALIX ALBA DHE PLATANUS ORIENTALIS, KUR ËSHTË E PËRSHTATSHME.</p>		E PROJEKTIT			
NDËRTIMI	KONSERVIMI I UJIT	UJI I LUMIT NUK DUHET TË PËRDORËT PËR QËLLIME NDËRTIMI OSE PASTRIMI; TË PËRDORËN BURIME ALTERNATIVE FURNIZIMI ME UJË.	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	KONTRAKT ORI	SUPERVIZORI SE	
NDËRTIMI	GJETJE TË RASTËSISHME	<p>TË ZBATOHET NJË PROCEDURË ZYRTARE PËR GJETJE TË RASTËSISHME PARA FILLIMIT TË PUNIMEVE TË GËRMIMIT.</p> <p>TË TRAJNOHET I GJITHË PERSONELI PËR TË NJOHUR MATERIALET POTENCIALE ARKEOLOGJIKE DHE PËR TË NDJEKUR PROCEDURËN E KËRKUAR.</p> <p>TË NDALOHEN MENJËHERË PUNIMET NË RAST ZBULIMI DHE TË SIGUROHET ZONA E PREKUR.</p> <p>TË NJOFTOHET PA VONESË AUTORITETI KOMPETENT PËR TRASHËGIMINË KULTURORE.</p>	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	KONTRAKT ORI	SUPERVIZORI SE	ROCEDURA PËR GJETJE TË RASTËSISHME E ZBATUAR; DOKUMENTACIONI I ARKIVUAR

		<i>PUNIMET TË RIFILLOJNË VETËM PAS MARRJES SË AUTORIZIMIT ZYRTAR ME SHKRIM NGA AUTORITETI.</i>					
<i>NDËRTIMI</i>	<i>RREZIQE PËR SHËNDETIN DHE SIGURINË NË PUNË</i>	<p><i>TË ZBATOHET NJË PLAN SPECIFIK I SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË) SI PJESË E PMMSK, PARA FILLIMIT TË PUNIMEVE.</i></p> <p><i>TË KRYHEN TRAJNIME TË DETYRUESHME HYRËSE DHE RIFRESKUESE PËR SHËNDETIN DHE SIGURINË NË PUNË PËR TË GJITHË PUNËTORËT.</i></p> <p><i>TË SIGUROHET DHE TË ZBATOHET PËRDORIMI I PAJISJEVE MBROJTËSE PERSONALE (PPE) TË PËRSHTATSHME (KASKA, VESHJE ME VIZIBILITET TË LARTË, KËPUCË SIGURIE, DOREZA, MBROJTJE PËR SYTË, SISTEME PËR PARANDALIMIN E RËNIES NGA LARTËSIA).</i></p> <p><i>TË ZBATOHEN PROCEDURA TË SIGURTA PUNE DHE METODOLOGJI PUNE PËR AKTIVITETET ME RREZIK TË LARTË (PRISHJE, NGRITJE ME VINÇ, PUNË NË LARTËSI, HAPËSIRA TË MBYLLURA, PUNIME BRENDA LUMIT).</i></p> <p><i>TË MBAHEN NË DISPOZICION SHËRBIME TË NDIHMËS SË PARË, PERSONEL I TRAJNUAR DHE PROCEDURA PËR REAGIM NDAJ EMERGJENCAVE, PËRFSHIRË MASAT E SHPËTIMIT PËR PUNIMET BRENDA LUMIT.</i></p> <p><i>TË REGJISTROHEN, HETOHEN DHE RAPORTOHEN TË GJITHA AKSIDENTET, INCIDENTET DHE GATI-INCIDENTET, DHE TË ZBATOHEN MASA KORRIGJUESE.</i></p> <p><i>NË RAST AKSIDENTI, TË NJOFTOHET MENJËHERË ARRSH DHE SUPERVIZORI PA VONESË.</i></p>	<i>PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT</i>	<i>PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT</i>	<i>KONTRAKT ORI</i>	<i>SUPERVIZORI SE</i>	<i>ZERO AKSIDENTE FATALE; PËRPUTHSHMËRI ME PËRDORIMIN E PAJISJEVE MBROJTËSE PERSONALE (PPE); MBAHET REGJISTRI I AKSIDENTEVE</i>
<i>NDËRTIMI</i>	<i>SHKELJE TË TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE</i>	<i>TË ZBATOHEN PROCEDURAT E MENAXHIMIT TË PUNËTORËVE; TË NËNSHKRUHET KODI I SJELLJES; TË JETË FUNKSIONAL MEKANIZMI I ZGJIDHJES SË ANKESAVE (GRM); TË KRYHEN TRAJNIME PËR NDËRGJEGJËSIMIN MBI SHFRYTËZIMIN DHE ABUZIMIN SEKSUAL / NGACMIMIN SEKSUAL (SEA/SH). TË SIGUROHEN KONTRATA ME SHKRIM, KUSHTE TË QARTA</i>	<i>PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT</i>	<i>PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT</i>	<i>KONTRAKT ORI</i>	<i>SUPERVIZORI SE</i>	<i>100% E PUNËTORËVE KANË NËNSHKRUAR KODIN E SJELLJES; MEKANIZMI I ZGJIDHJES SË ANKESAVE (GRM) FUNKSIONAL; REGJISTRAT E TRAJNIMEVE TË DISPONUESHËM</i>

		<p><i>PUNËSIMI DHE PËRPUTHSHMËRI ME LEGJISLACIONIN E PUNËS.</i></p> <p><i>TË PROMOVOHET MOSDISKRIMINIMI, BARAZIA E MUNDËSIVE DHE RESPEKTI PËR TË DREJTAT E PUNËTORËVE.</i></p> <p><i>TË SIGUROHET AKOMODIM I PËRSHTATSHËM PËR PUNËTORËT, KUR ËSHTË E APLIKUESHME.</i></p> <p><i>TË SIGUROHET QË TË GJITHË PUNËTORËT TË NËNSHKRUAJNË DHE TË ZBATOJNË KODIN E SJELLJES PARA FILLIMIT TË PUNËS.</i></p> <p><i>TË OFROHEN TRAJNIME TË DETYRUESHME MBI SEA/SH PËR TË GJITHË PUNËTORËT; TË SHFAQEN NË KANTIER INFORMACIONE MBI SJELLJEN E PRANUESHME DHE MEKANIZMAT E RAPORTIMIT; TË SIGUROHET TRAJTIM KONFIDENCIAL DHE I ORIENTUAR TE VIKTIMA I ANKESAVE.</i></p> <p><i>TË KRYHEN INSPEKTIME TË RREGULLTA NË KANTIER DHE TË RISHIKOHEN REGJISTRAT E SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË (OHS) DHE REGJISTRAT E TRAJNIMEVE.</i></p> <p><i>TË KRYHET RAPORTIM PERIODIK MBI PËRPUTHSHMËRINË ME KËRKESAT E LEGJISLACIONIT TË PUNËS.</i></p>					
<i>NDËRTIMI</i>	<i>ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT</i>	<p><i>TË ZBATOHET PLANI I MIRATUAR I ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT (SEP) NË KOORDINIM ME ARA.</i></p> <p><i>TË JEPET NJOFTIM PARAPRAK PËR AKTIVITETET E NDËRTIMIT DHE SHQETËSIMET E MUNDSHME (TRAFIKU, QASJA, ZHURMA).</i></p> <p><i>TË MBAHET KOMUNIKIM I VAZHDUESHËM ME KOMUNITETET LOKALE DHE PALËT E INTERESIT.</i></p> <p><i>TË INSTALOHEN SINJALISTIKË E QARTË DHE TABELA INFORMUESE NË KANTIER.</i></p> <p><i>TË SIGUROHEN PIKA KONTAKTI TË QASSHME (TELEFON, EMAIL, PËRFAQËSUES NË KANTIER).</i></p> <p><i>TË FUNKSIONOJË NJË MEKANIZËM PËR ZGJIDHJEN E ANKESAVE (GRM):</i></p>	<i>PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT</i>	<i>PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT</i>	<i>KONTRAKTORI</i>	<i>SUPERVIZORI SE</i>	<i>REGJISTRI I ANKESAVE I MBAJTUR; KOHA E PËRGJIGJES E REGJISTRUAR</i>

		<p>TË JETË I QASSHËM, PËRFSHIRË ANKESAT ANONIME;</p> <p>TË GARANTOHET PËRGJIGJE BRËNDA AFATIT TË PËRCAKTUAR (≤ 15 DITË).</p> <p>TË REGJISTROHEN DHE GJURMOHEN TË GJITHA ANKESAT DHE TË SIGUROHET ZGJIDHJA NË KOHË. TË SIGUROHET ANGAZHIM INKLUZIV, PËRFSHIRË GRUPET VULNERABËL. TË MBAHET DOKUMENTACION DHE RAPORTIM PERIODIK MBI AKTIVITETET E ANGAZHIMIT. TË TRAJNOHEN PUNËTORËT PËR KODIN E SJELLJES DHE NDËRVEPRIMIN ME KOMUNITETIN.</p>					
NDËRTIMI	STRESI NGA NXEHTËSIA DHE KUSHTET EKSTREME TË MOTIT	<p>TË SIGUROHEN ZONA PUSHIMI TË MBROJTURA NGA DIELLI; TË GARANTOHET HIDRATIMI (PIJE IZOTONIKE); TË PLANIFIKOHEN PUNIMET E RËNDA GJATË ORAREVE MË TË FTOHTA TË DITËS; TË PARASHIKOHET REAGIM EMERGJENT NË RAST GODITJE NGA NXEHTËSIA (HEAT STROKE). TË NDALOHEM PUNIMET NË RAST TË ERËRAVE TË FORTA OSE NGJARJEVE TË TJERA TË RREZIKSHME. TË SIGUROHEN STREHË TË PËRKOSSHME PËR PUNËTORËT.</p>	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	KONTRAKT ORI	NËN MBIKËQYRJEN E SE DHE ARRSH	
NDËRTIMI	SIGURIA NË KANTIER DHE SIGURIA PUBLIKE	<p>TË RRETHOHEN ZONAT E PUNËS ME RRETHIME MBROJTËSE; TË INSTALOHEM SINJALISTIKË PARALAJMËRUESE; TË SIGUROHET NDRIÇIMI PËRSHTATSHËM; TË VENDOSIM APARATE FIKSE ZJARRI; TË SIGUROHET OBJEKTE SANITARE.</p>	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	KONTRAKT ORI	SUPERVIZORI SE	PA QASJE TË PALEJUAR; INSPEKTIME TË SIGURISË TË DOKUMENTUARA
NDËRTIMI	DËMTIMI RRJETIT TË SHËRBIMEVE	<p>HARTËZIMI I RRJETIT TË SHËRBIMEVE PARA GËRMIMIT; KOORDINIMI ME OFRUESIT E SHËRBIMEVE; GËRMIME PROVË (GROPË PROVE); PROTOKOLL PËR RIPARIME EMERGJENTE.</p>	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	KONTRAKT ORI	SUPERVIZORI SE	ZERO NDËRPRERJE TË PAPANIFIKUARA TË SHËRBIMEVE GJATË GËRMIMEVE
NDËRTIMI	SITUATA EMERGJENTE (PËRMBYTJE, NGJARJE EKSTREME)	<p>PLANI I GATISHMËRISË PËR EMERGJENCA; RRUGËT E EVAKUIMIT; KOORDINIMI ME AUTORITETET LOKALE; USHTRIME SIMULIMI</p>	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	KONTRAKT ORI	SUPERVIZORI SE	PLANI EMERGJENT I MIRATUAR; REGJISTRAT E USHTRIMEVE (DRILLS) TË DISPONUESHME
NDËRTIMI	RIVENDOSJA MJEDISORE PAS NDËRTIMIT	<p>TË RIKTHEHEN HABITATET E PREKURA DUKE PËRDORUR SPECIE VENDORE TË QËNDRUESHME NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE.</p>	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	PËRFSHIRË NË KOSTON E PROJEKTIT	KONTRAKT ORI	SUPERVIZORI SE	

OPERIMI DHE MIRËMBAJTJA	MIRËMBAJTJAE ZHURMAVE	TË KUFIZOHEN PUNIMET E MIRËMBAJTJES VETËM NË ORARIN E DITËS (07:00–19:00); TË NJOFTOHET KOMUNITETI PËR PUNIMET KRYESORE.			KONTRAKT ORI O&M	NËN MBIKËQ YRJEN E ARRSH	PA ANKESA TË JUSTIFIKUARA; MBAHET REGJISTRI I ANKESAVE
O&M	SIGURIA STRUKTURE	INSPEKTIVE PERIODIKE TË URËS; MIRËMBAJTJE PARANDALUESE; RIPARIM I MENJËHERSHËM I DEFEKTEVE; ZBATIMI I KUFIZIMEVE TË NGARKESËS.			KONTRAKT ORI O&M	NËN MBIKËQ YRJEN E ARRSH	RAPORTE VJETORE TË INSPEKTIMIT; PA NGJARJE TË DËSHTIMIT STRUKTURE
O&M	EROZIONI DHE STABILITETI I BRIGJEVE	INSPEKTIVE PERIODIKE TË ARGJINATURAVE DHE BRIGJEVE TË LUMIT; RIPARIMI I EROZIONIT; MIRËMBAJTJE E MASAVE TË INXHINIERISË BIOLOGJIKE.			KONTRAKT ORI O&M	NËN MBIKËQ YRJEN E ARRSH	PA EROZION PROGRESIV; BRIGJE TË STABILIZUARA
O&M	PERFORMANCA E SIGURISË RRUGORE	TË MBAHEN NË GJENDJE TË MIRË SHENJAT RRUGORE, SINJALISTIKA, PARAPETA MBROJTËSE DHE NDRIÇIMI (KUR ËSHTË I APLIKUESHËM); TË RIPAROHEN MENJËHERË BARRIERAT E DËMTUARA.			KONTRAKT ORI O&M	NËN MBIKËQ YRJEN E ARRSH	ELEMENTET E SIGURISË RRUGORE FUNKSIONALE ; STATISTIKAT E AKSIDENTEVE TË MONITURUARA
O&M	AKUMULIMI I MBETURINAVE DHE BLLLOKIMI I RRJEDHJES SË UJIT	PASTRIMI I RREGULLT I SHTRATIT TË URËS, KULVERTAVE DHE HAPJEVE TË LUMIT; HEQJE E MATERIALEVE TË AKUMULUARA, VEÇANËRISHT PAS STUHIVE.			KONTRAKT ORI O&M	NËN MBIKËQ YRJEN E ARRSH	PA OBSTRUKSION TË RRJEDHJES HIDRAULIKE; PA PËRMBYTJE TË SHKAKTUARA NGA STRUKTURA
O&M	SHËNDETI DHE SIGURIA E KOMUNITETIT	TË MBAHET QASJE E SIGURT PËR KËMBËSORËT; TË MBAHEN NË GJENDJE TË MIRË PARAPETAT DHE ELEMENTET MBROJTËSE; TË TRAJTOHEN ANKESAT E KOMUNITETIT.			KONTRAKT ORI O&M	NËN MBIKËQ YRJEN E ARRSH	PA ANKESA TË PAZGJIDHURA TË SIGURISË
O&M	REZISTENCA NDAJ KUSHTEVE EKSTREME TË MOTIT DHE PËRMBYTJEVE	TË INSPEKTOHET URA PAS NGJARJEVE TË MËDHA PËRMBYTËSE; TË HIQEN MBETURINAT; TË VERIFIKOHET EROZIONI NË SHKATËRRIM TË SHTRATIT DHE STABILITETI I THEMELIT.			KONTRAKT ORI O&M	NËN MBIKËQ YRJEN E ARRSH	RAPORTE TË INSPEKTIMIT PAS NGJARJEVE TË PËRFUNDUARA
O&M	MEKANIZMI I ZGJIDHJES SË ANKESAVE	TË MBAHET FUNKSIONAL MEKANIZMI I ZGJIDHJES SË ANKESAVE TË KOMUNITETIT (GRM) GJATË FAZËS SË OPERIMIT; TË JEPET PËRGJIGJE BRËNDA AFATIT TË PËRCAKTUAR (≤ 15 DITË).			KONTRAKT ORI O&M	NËN MBIKËQ YRJEN E ARRSH	$\geq 90\%$ E ANKESAVE TË ZGJIDHURA BRËNDA AFATIT TË CAKTUAR
FAZA E OPERIMIT	QËNDRUESHMËRI A	TË SIGUROHET MIRËMBAJTJE E RREGULLT, KONTROLLE DHE RIPARIME.			ARRSH	ARRSH	

Table 3: Plani i Monitorimit Mjedisor dhe Social

Faza	Cila veprimtari/ndikim duhet të monitorohet?	Ku do të monitorohet?	Si duhet të monitorohet? / Lloji i pajisjeve të monitorimit	Kur duhet të monitorohet? (Frekuenca e matjes apo monitorim i vazhdueshëm)	Pse duhet të monitorohet parametri? (opsionale)	Indikatorët	Kosto		Përgjegjësia institucionale	
							Instalimi	Operimi	Instalimi	Operimi
Para ndërtimi	Të gjitha lejet merren përpara fillimit të punimeve. Disponimi i miratimit zyrtar ose i një licence të vlefshme operative për guroret dhe subjektet e tjera furnizuese me materiale (p.sh. kompanitë e shfrytëzimit të zhavorrit dhe rërës). Kjo përfshin edhe kushtet e Trashëgimisë Kulturore.	në vendndodhjen e gurores anive të shfrytëzimit të mineraleve	Inspektimi i të gjitha dokumenteve të nevojshme	Përpara fillimit të punimeve	për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të materialeve	posedimi i miratimit zyrtar ose i një licence operative të vlefshme dhe koncesioni	NA	NA	Operatori gurores	Operatori gurores
Para ndërtimi	Institucionet publike dhe përkatëse njoftohen për punimet.	zyrat/objektet e kontraktorit	Inspektimi i të gjitha dokumenteve të nevojshme	Përpara fillimit të punimeve	Për të siguruar ndërgjegjësimin e publikut	Shpërndarja e informacionit	Përfshirë në koston e projektit	Përfshirë në koston e projektit	Inxhinieri mbikëqyrës, ARA	Inxhinieri mbikëqyrës, ARA
Para ndërtimi	Plani i përgatitjes për emergjencë dhe plani i organizimit të trafikut janë përgatitur. Është përcaktuar pozicioni i infrastrukturës ekzistuese në seksionet përkatëse. Është përgatitur Plani i menaxhimit të trafikut.	zyrat/objektet e kontraktorit	Inspektimi i të gjitha dokumenteve të nevojshme	Përpara fillimit të punimeve	Për të zvogëluar rreziqet dhe ndikimet e situatave aksidentale dhe dëmet në infrastrukturë.	Planet dhe projektet (skicat teknike) janë të disponueshme	Përfshirë në koston e projektit	Përfshirë në koston e projektit	Inxhinieri mbikëqyrës, ARA	Inxhinieri mbikëqyrës, ARA
Para ndërtimi	Punimet organizohen dhe planifikohen në mënyrë që të shmanget shqetësimi i kafshëve gjatë periudhave të rëndësishme të ciklit të tyre jetësor.	zyrat/objektet e kontraktorit	Inspektimi i të gjitha dokumenteve të nevojshme	Përpara fillimit të punimeve	Për të reduktuar rreziqet dhe ndikimet mbi biodiversitetin.	Planet janë përgatitur	Përfshirë në koston e projektit	Përfshirë në koston e projektit	Inxhinieri mbikëqyrës, ARA	Inxhinieri mbikëqyrës, ARA

							projekt t			
Ndërtimi	Mbulimi ose lagia e materialeve të transportuara që mund të gjenerojnë pluhur, si guri, rëra ose zhavorri, si dhe mbajtja e kantierit të lagësht dhe të mbrojtur nga përhapja e pluhurit. Mbrojtja nga pluhuri gjatë shkarkimit. Nuk lejohet djegia në kantier.	kantieri i punës – çdo mjet	supervizion	vazhdimisht	të sigurohet minimizimi i ndikimit në cilësinë e ajrit	Ngarkesë e mbuluar e kamionit – raport nga inxhinieri mbikëqyrës	NA	minimal e, e përfshirë në koston e projektit	ARA	Supervizori/Kontraktori

Ndërtim	Mbipopullim në kantier, ndërprerje të modeleve të trafikut dhe ankesa lidhur me menaxhimin e trafikut. Janë siguruar kalime të sigurta për këmbësorët.	Në kantier	Mbikëqyrje vizuale	rregulli sht nga mbikëqyrja	Për të siguruar ndërprerje minimale të trafikut lokal, për të parandaluar aksidentet dhe për të garantuar sigurinë.	Numri i ankesave të pranuar.		minimale, e përfshirë në koston e projektit.	a) ARA	Supervizori/ Kontraktori
Ndërtim	Dëmtime të strukturës së tokës, rrëshqitje dhe shembje të shpateve, dëmtime të argjinaturave. Janë zbatuar masa për parandalimin e erozionit të tokës dhe rrëshqitjeve (p.sh. barriera kundër sedimentit, balë me kashtë, studime gjeoteknike, përfundime dhe masa të tjera të nevojshme).	Në kantier	Mbikëqyrje	inspektime të paparalajmëruara gjatë punimeve, pas reshjeve të mëdha të shiut; rregullisht para dhe gjatë punimeve të dheut në një seksion të caktuar	Për të siguruar ndikime minimale në tokë.	rrëshqitje toke, erozion, dëmtime të argjinaturave; masa të zbatuara, studime të përfunduara përpara punimeve në zonën e prekur.	NA	minimale, e përfshirë në koston e projektit.	ARA	Minimale
Ndërtim	Shqetësim nga zhurma për popullatën njerëzore dhe shtazore, si dhe për punëtorët në kantier.	Në kantier	matës dhe analizues i zhurmës, inspektim; monitorim i zhurmës në rast ankesash	një herë për çdo makineri dhe pajisje në fillim të punimeve. Në rast mosrespektimi – rregullisht. Në rast ankesash ose gjetjeje negative gjatë inspektimit.	të sigurohet përputhshmëria e performancës me rregulloret dhe standardet mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë.	mos-përputhje (>85 dB), ankesë, gjetje negative gjatë inspektimit.	minimale, e përfshirë në koston e projektit.	minimale, e përfshirë në koston e projektit.	ARA	Supervizori/ Kontraktori
Ndërtim	Parametrat e ndotjes së ajrit nga pluhuri dhe grimcat	Në kantierin te afert	Marrje mostrash nga agjenci e autorizuar	Në rast ankesash ose gjetjeje negative gjatë inspektimit.	Për të siguruar që nuk ka emetime të tepërta gjatë punimeve.	Mos-përputhje, ankesë.	minimale, e përfshirë në koston e projektit.	100/ muaj	ARA	Supervizori/ Kontraktori

Ndërtim	cilësia e ujit dhe e tokës (lëndët e ngurta të pezulluara, vajrat).	Në dhe pranë kantierit të punës (sipër rrjedhës dhe poshtë rrjedhës).	Marrje mostrash nga agjenci e autorizuar; inspektim vizual i rrjedhjeve, turbullirës dhe ndotjes.	Në rast ankese ose nëse vërehet derdhje/rrjedhje/turbullirë në lumë/trup ujqor apo në tokë pranë trupit ujqor.	Për të siguruar që nuk ka emetime të tepërta gjatë punimeve.	Mos-përputhje, numri i ankesave të regjistruara.	Minimal, e përfshirë në koston e projektit.	minimal, e përfshirë në koston e projektit.	ARA	Kontraktori mbikëqyrës
Ndërtim	Siguria e trafikut, sinjalistika dhe aksesueshmëria.	Në zonën më të gjerë të kantierit të punës.	Inspektim vizual, konsultim e me policinë e trafikut, konsultim e me banorët lokalë.	Në fillim të punimeve në një seksion të caktuar, si dhe në rast ankesash.	Për të parandaluar aksidentet dhe për të siguruar akses në shërbime dhe mjete jetese.	Numri i ankesave të regjistruara.	e përfshirë në koston e projektit.	Minimale, e përfshirë në koston e projektit.	Inxhinieri mbikëqyrës ARA	ARA
Ndërtim	Sinjalistika e sigurisë dhe procedurat janë në fuqi. Rrethimi është vendosur. Shenjat paralajmëruese janë vendosur.	pranë kantierit të punës.	Vizualisht nga mbikëqyrësi.	Rregullisht	Për të siguruar vendosjen e qartë të shenjave të sigurisë.	Numri I shenjave	Minimale, e përfshirë në koston e projektit.	ARA	Kontraktori mbikëqyrës	ARA
Ndërtim	Depozitimi i mbetjeve në landfill-e ose impiante të licencuara, të transportuara nga kompani transporti të licencuara.	Në kantier për grumbullim dhe largim në kohë drejt vendit përfundimtar të depozitimit.	Kontroll i dokumenteve (licenca, regjistra të mbetjeve), vizitë në terren, inspektim vizual.	Para fillimit të punimeve dhe rregullisht.	Për të siguruar menaxhim të duhur të mbetjeve dhe për të parandaluar ndotjen.	Licencat e lëshuara nga organet kompetente, sasia e mbetjeve të larguara.	E përfshirë në koston e projektit.	ARA	Kontraktori mbikëqyrës	ARA

<i>Ndërtim / mbetje.</i>	Grumbullim i veçantë i mbetjeve.	Ne kantier.	Vizualisht, numri, etiketimi dhe kapaciteti i kontejnereve, përzierja e mbetjeve, siguria e kontejnereve.	Rregullisht	Parandalim ndotje.	Numri i kontejnereve, përzierja e mbetjeve, etiketimi, procedurat.	e përfshirë në koston e projektit.	minimal, e përfshirë në koston e projektit.	Kontraktori mbikëqyrës	ARA
<i>Ndërtim / menaxhimi i substancave të rrezikshme (përfshirë mbetjet).</i>	Kontejnerët janë hermetikë dhe me sistem të dytë mbajtës (sekondar). Kontejnerët janë të aksesueshëm vetëm nga personeli i autorizuar. Gjatë përdorimit, janë në fuqi sisteme për mbrojtjen nga derdhjet aksidentale.	Ne Kantier.	Vizuale	Rregullisht	Parandalim ndotje.	Numri dhe madhësia e derdhjeve, sasia e tokës ose ujit të ndotur, rrjedhjet.	e përfshirë në koston e projektit.	minimale, e përfshirë në koston e projektit.	Kontraktori mbikëqyrës	ARA

	. Kontejnerët janë të etiketuar në mënyrë të përshtatshme. Kontrollohen depozitat, makineritë dhe automjetet për rrjedhje.									
<i>Ndërtim/ Siguria e punetoreve</i>	Pajisjet mbrojtëse (syze, maska, helmata, çizme, etj.) përdoren në çdo kohë; sinjalistika dhe udhëzimet e sigurisë janë në kantier; është organizuar devijimi i trafikut, si dhe masa të tjera të shëndetit dhe sigurisë (H&S). Punëtorët janë të trajnuar dhe të certifikuar në mënyrë të përshtatshme për pozicionet dhe punët që kryejnë. Plani i gatishmërisë për emergjencën dhe procedurat emergjente janë të disponueshme në kantier dhe u komunikohen të gjithë punëtorëve përmes trajnimeve të H&S.	Ne kantier.	Inspektim	inspektim e të paparalajmëruara gjatë punimeve .	Të parandalohen aksidentet.	numri i aksidenteve në punë të regjistruara, procedura të disponueshme, pajisje mbrojtëse të disponueshme.	N/A	Minimale, e përfshirë në koston e projektit	Supervizion/ARA	N/A
<i>Ndërtim/ Organizimi i kantierit</i>	. Kantieri është i organizuar mirë: rrethimet, paralajmërimet dhe sinjalistika janë në vend. Zonat e rrezikshme janë të rrethuara dhe të shënuara. Janë të disponueshme objekte sanitare në numër të mjaftueshëm. Kampi është i paarritshëm për publikun.	Ne kantier.	Inspektim	inspektim e të paparalajmëruara gjatë punimeve .	Të parandalohen aksidentet.	numri i aksidenteve të regjistruara në punë	N/A	Minimale, e përfshirë në koston e projektit	Supervizion , ARA	N/A
<i>Ndërtim/ Shkatërrimi i të mbjellave, pemëve, livadheve, etj.</i>	humbje/ndikim në vegjetacion.	Ne kantier.	Mbikëqyrje, raporte fotografike.	gjatë dorëzimit të materialeve dhe punimeve të ndërtimi	Mbrojtja e vlerës së peizazhit.	Raporte të vizitave të shpeshta në kantier nga eksperti mjedisor.	N/A	Minimale, e përfshirë në koston e projektit	Kontratori mbikqyres ose , ARA	ARA

<p><i>Ndërtim / ndikim në biodiversitet dhe natyrë.</i></p>	<p>Përdoren vetëm bime vendase për gjelbërim dhe rehabilitimin e kantierit. Kantieri rikthehet në gjendjen e mëparshme. Nuk ka shqetësim të kafshëve dhe nuk lejohet grumbullimi/shkatërrimi i florës.</p>	<p>Ne kantier.</p>	<p>Inspektim vizual i kantierit, kontroll i dokumenteve.</p>	<p>Rregullisht, lejet para fillimit të punimeve.</p>	<p>Mbrojtja e vlerës së peizazhit dhe natyres.</p>	<p>Ankesa</p>	<p>minimale , e përfshirë në koston e projektit.</p>	<p>Minimale, e përfshirë në koston e projektit</p>	<p>Kontratori mbikqyresose , ARA</p>	<p>ARA</p>
<p><i>Ndërtim / gjetje rastësore.</i></p>	<p>Pasuri kulturore. Zbatohet klauzola për gjetje rastësore.</p>	<p>Ne kantier.</p>	<p>Vizita të ekspertëve nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, mbikëqyrje e rregullt.</p>	<p>Vazhdimisht, në rast gjetjesh.</p>	<p>Ruajtja e trashëgimisë kulturore.</p>	<p>Katalogu i objekteve të gjetura, përfshirë dokumentacion fotografik dhe tekstual; raport i gjetjeve rastësore.</p>	<p>Duhet të jetë pjesë e aktiviteteve të planifikuara .</p>	<p>Minimale, e përfshirë në koston e projektit</p>	<p>Kontratori mbikqyresose , ARA</p>	<p>Kontraktori mbikëqyrës, Drejtoria e Kulturës, ARA.</p>

<p><i>Ndërtim /</i> <i>a) Parandalimi i sëmundjeve dhe kontrollet shëndetësore</i> <i>b) Krijimi i vendeve shtesë të punës</i> <i>c) Akomodimi i fuqisë punëtore</i> <i>d) Siguria e punëtorëve në kantiër</i></p>	<p>1.Kontrollet shëndetësore për punëtorët, 2.Trajnime për parandalimin e sëmundjeve, përfshirë IST (infeksionet seksualisht të transmetueshme) 3.Informimi i popullatës lokale për vendet e lira të punës 4.Përfshirja e fuqisë punëtore lokale 5.Nevojat për akomodim dhe standardet 6..Udhëzimet sigurisë dhe pajisjet mbrojtëse (syze, maska, helmata, etj.)</p> <p>Siguria 2) organizimi i devijimit të trafikut 3) disponueshmëria e mekanizmit të ankesave dhe e pikës fokale për ankesat</p>	<p>Ne kantiër.</p>	<p>vizita në terren dhe komunikim me punëtorët dhe komunitetin.</p>	<p>Nje here ne jave nga ARA</p>	<p>Për të siguruar zbatimin e duhur të kërkesave të shëndetit dhe sigurisë.</p>	<p>Fuqia punëtore e trajnuar mbi procedura t, e pajisur me pajisje sigurie.</p>	<p>Duhet të jetë pjesë e aktivitetev e të planifikuar</p>	<p>Minimale, e përfshirë në koston e projektit</p>	<p>Kontratori mbikqyres ose ,ARA</p>	<p>Supervizori/ Kontraktori</p>
--	---	--------------------	---	---------------------------------	---	---	---	--	--------------------------------------	---------------------------------

<p><i>Siguria e automjeteve dhe këmbësorëve</i></p>	<p>dukshmëria dhe përshtatshmëria e sinjalistikës</p>	<p>pranë kantiërit</p>	<p>vëzhgim</p>	<p>një herë në javë në mbrëmje</p>	<p>Siguria</p>	<p>Numri i shenjave paralajmëruese të vendosura, përshtatshmëria e tyre, numri i aksidenteve të regjistruara</p>	<p>minimale</p>	<p>minimale, i përfshirë në koston e projektit</p>	<p>ARA</p>	<p>Kontraktori i mirëmbajtjes, ARA.</p>
<p><i>Rritja e mbetjeve të ngurta shkak të rritjes së numrit të vizitorëve në zonë – ndikim vizual</i></p>	<p>Impakti vizual</p>	<p>pranë kantiërit</p>	<p>vizita në terren dhe komunikim me autoritetet lokale</p>	<p>një herë në çdo dy ditë nga Njësia e Qeverisjes Vendore (NJQV) për arsye mirëmbajtjeje</p>	<p>për arsye estetike</p>	<p>mungesa e mbetjeve në tokë, koshat e mbeturinave të zbratur</p>	<p>duhet të jetë pjesë e aktiviteteve të planifikuara rregullisht nga NJQV</p>		<p>NJQV</p>	<p>NJQV</p>

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Aneksi1: Formulari i Ankesave

Reference No: Full Name <i>Note: you can remain anonymous if you prefer, or request not to disclose your identity to the third parties without your consent. In case of anonymous grievances, the decision will be disclosed at the Projects website</i> First name _____ Last name _____ <input type="checkbox"/> I wish to raise my grievance anonymously <input type="checkbox"/> I request not to disclose my identity without my consent Contact Information Please mark how you wish to be contacted (mail, telephone, e-mail). <input type="checkbox"/> By Post: Please provide mailing address: _____ _____ <input type="checkbox"/> By Telephone: _____ <input type="checkbox"/> By E-mail _____ <input type="checkbox"/> I will follow up the resolution at the website as I want to remain anonymous Preferred Language for communication <input type="checkbox"/> Albanian <input type="checkbox"/> Other (indicate) Description of Incident or Grievance (What happened? Where did it happen? Who did it happen to? What is the result of the problem? Date of Incident/ Grievance) <input type="checkbox"/> One-time incident/grievance (date _____) <input type="checkbox"/> Happened more than once (how many times? _____) <input type="checkbox"/> On-going (currently experiencing problem) What would you like to see happen to resolve the problem? Signature: _____ Date: _____ Please return this form to: The Ministry of Infrastructure and Energy.

Aneksi

Aneksi 1: Përmbledhja e C-ESMP dhe SSMP-ve

Seksioni 1.01 Përmbledhja e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Kontraktorit (C-ESMP)

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social i Kontraktorit (C-ESMP) është një instrument i detajuar dhe specifik për kantierin, i përgatitur nga Kontraktori përpara fillimit të punimeve të ndërtimit. C-ESMP zhvillohet në përputhje me Kuadrin Mjedisor dhe Social të Bankës Botërore, me rëndësi të veçantë për ESS1 (Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale), ESS2 (Punëtorët dhe Kushtet e Punës), ESS3 (Eficienca e Burimeve dhe Parandalimi dhe Menaxhimi i Ndotjes), ESS4 (Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit), ESS5 (Shpronësimi i Tokës, Kufizimet në Përdorimin e Tokës dhe Zhvendosja e Pavullnetshme), ESS6 (Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore të Gjalla), ESS8 (Trashëgimia Kulturore) dhe ESS10 (Angazhimi i Palëve të Interesit dhe Informimi

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

(Angazhimi dhe Shpërndarja e Informacionit). C-ESMP është plotësisht në përputhje me Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMF) dhe me përfundimet e ESMP-së specifike për vendin.

C-ESMP përkthen masat zbutëse dhe kërkesat e përcaktuara në ESMP-në e miratuar specifike për vendin, rezultatet e shqyrtimit (screening) dhe specifikimet kontraktuale Mjedisore, Sociale, Shëndetësore dhe të Sigurisë (ESHS) në procedura të detajuara, praktike dhe të zbatueshme në kantierin e ndërtimit. Ai përcakton mënyrën se si Kontraktori do të menaxhojë rreziqet mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë që lidhen me prishjen e urës ekzistuese, ndërtimin e urës së re dhe rrugës lidhëse, punimet në shtratin e lumit, punimet e dheut, gjenerimin e mbetjeve, menaxhimin e trafikut dhe organizimin e fuqisë punëtore.

Nënprojekti i Urës së Klosit paraqet rreziqe të konsiderueshme, por specifike për vendin dhe të kthyeshme gjatë fazës së ndërtimit, veçanërisht të lidhura me gjenerimin e mbetjeve nga prishja, punimet në lumë që ndikojnë në lumin Dunavec, erozionin dhe transportin e sedimenteve, shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe shqetësimet e përkohshme në trafik dhe te receptorët përreth. Në përputhje me këtë, përgatitja dhe miratimi i C-ESMP është një kusht i detyrueshëm përpara mobilizimit dhe fillimit të punimeve, dhe i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit nga Inxhinieri dhe Njësia e Zbatimit të Projektit.

Si minimum, C-ESMP përfshin masat zbutëse dhe të monitorimit të ESMP-së specifike për vendin, të përkthyer në plane veprimi praktike dhe detyra të detajuara, duke përfshirë, por pa u kufizuar në komponentët e mëposhtëm:

Vlerësimi i rreziqeve dhe masat zbutëse specifike për kantierin, të harmonizuara me ESMP-në dhe gjetjet e screening-ut, që mbulojnë aktivitetet e prishjes, punimet e dheut, punimet në shtratin e lumit, fazimin e ndërtimit dhe rehabilitimin e kantierit;

Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, që trajton identifikimin e rreziqeve dhe kontrollin e tyre, metodat e sigurta të prishjes dhe punimeve në lumë, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, induksionin dhe trajnimin e punëtorëve, gatishmërinë dhe reagimin ndaj emergjencave, ndihmën e parë, raportimin e incidenteve dhe rasteve pothuaj-incident, si dhe monitorimin e performancës së SST, në përputhje me ESS2;

Procedurat e Menaxhimit të Punës, që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve, kushtet e punës dhe të punësimit, marrëveshjet kontraktuale, orët e punës, standardet e akomodimit kur është e aplikueshme, kodet e sjelljes, parandalimin e punës së fëmijëve dhe të detyruar, si dhe krijimin e një Mekanizmi të ankesave për punëtorët, konfidencial dhe të aksesueshëm, në përputhje me ESS2;

Masat për Shëndetin dhe Sigurinë e Komunitetit, duke përfshirë rrethimin e kantierit, sinjalistikën, menaxhimin e trafikut dhe aksesit, kontrollin e vibrimeve dhe zhurmës, koordinimin me autoritetet lokale dhe mbrojtjen e përdoruesve vulnerabël të rrugës dhe komuniteteve përreth, në përputhje me ESS4;

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Procedurat për menaxhimin e mbetjeve dhe materialeve, duke përfshirë ndarjen, klasifikimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve inerte të prishjes, reduktimin e pluhurit gjatë prishjes dhe trajtimit, parandalimin e hedhjes së paligjshme dhe transportin dhe depozitimin nëpërmjet faciliteteve të licencuara, në përputhje me ESS3 dhe Protokollin e BE-së për Menaxhimin e Mbetjeve të Ndërtimit dhe Prishjes;

Masat për erozionin, sedimentimin, ndotjen e ujit dhe menaxhimin ekologjik, duke përfshirë metodologjitë për punimet në lumë, ruajtjen e rrjedhës minimale ekologjike, menaxhimin e larjes së betonit dhe derdhjeve aksidentale, si dhe mbrojtjen e brigjeve të lumit, habitateve ujore dhe vegjetacionit riparian. Këto masa adresojnë në mënyrë eksplicite ndikimet e mundshme mbi speciet dhe habitatet ujore dhe ripariane dhe janë në përputhje me ESS3 dhe ESS6.

Procedura e Gjetjeve Rastësore (Chance Finds Procedure), në përputhje me ESS8, e integruar në trajnimin e kontraktorit, induksionin në kantier dhe rregullimet e mbikëqyrjes, duke përcaktuar hapat e qartë për ndalimin e punimeve, njoftimin, mbrojtjen e gjetjeve dhe koordinimin me autoritetet kompetente të trashëgimisë kulturore në rast të zbulimeve të papritura; dhe

Kuadri i zbatimit, monitorimit dhe raportimit, që përcakton rolet dhe përgjegjësitë, organizimin e inspektimeve dhe mbikëqyrjes, procedurat e veprimeve korrigjuese dhe raportimin e rregullt Mjedisor, Social, Shëndetësor dhe të Sigurisë (ESHS), përfshirë raportet mujore të monitorimit që i dorëzohen Inxhinierit dhe Njesisë së Zbatimit të Projektit.

C-ESMP duhet të trajtohet si një dokument dinamik dhe të përditësohet sipas nevojës për të reflektuar ndryshimet në metodologjinë e ndërtimit, fazimin e punimeve ose kushtet e kantierit, me miratimin e Inxhinierit mbikëqyrës dhe Njesisë së Zbatimit të Projektit. Zbatimi efektiv i C-ESMP-së, i kombinuar me mbikëqyrje të pavarur dhe monitorim të rregullt, është thelbësor për të siguruar përputhshmërinë me Standardet Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore, legjisllacionin kombëtar dhe angazhimet e përcaktuara në ESMF dhe Raportin e Screening-ut.

Seksioni 1.02 Plani i Shembjes dhe Menaxhimit të Mbetjeve

Plani i **Shembjes** dhe Menaxhimit të Mbetjeve (PSMM) përgatitet si një instrument i detyrueshëm, specifik për vendin, e menaxhimit mjedisor në përputhje me Kornizën Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore, kryesisht ESS1 (Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale) dhe ESS3 (Eficienca e Burimeve dhe Parandalimi dhe Menaxhimi i Ndotjes), si dhe në përputhje të plotë me Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS).

PSMM përcakton një qasje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar për planifikimin dhe zbatimin e sigurt të aktiviteteve të shembjeve të urave, si dhe për parandalimin, minimizimin, trajtimin, ruajtjen, transportin, përpunimin, ripërdorimin dhe asgjësimin përfundimtar të të gjitha mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme të gjeneruara gjatë punimeve të shembjeve dhe ndërtimit. Objektivat kryesore janë parandalimi i ndotjes së tokës, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së komunitetit, mbrojtja e punëtorëve, si dhe siguri i përputhshmërisë me legjisllacionin shqiptar, direktivat e zbatueshme të BE-së, Protokollin e

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

BE-së për Menaxhimin e Mbetjeve nga Ndërtimi dhe Demolimi, Udhëzimet e Bankës Botërore për Shëndetin, Sigurinë dhe Mjedisin, si dhe Praktikën e Mirë Ndërkombëtare Industriale (PMNI), duke zbatuar standardet më të rrepta.

Plani hartohet përpara fillimit të çdo aktiviteti shembjeje ose ndërtimi dhe zbatohet gjatë fazave të para-shembjes, shembjes, ndërtimit dhe rehabilitimit të kantierit. Ai është një dokument dinamik dhe përditësohet sipas nevojës për të reflektuar ndryshime në metodologjinë e shembjes, sasinë e mbetjeve, kushtet e kantierit ose kërkesat rregullatore.

Procedurat e Shembjes së Urës

PSMM përcakton procedura të detajuara dhe të renditura për shembjen e urës me qëllim garantimin e sigurisë, mbrojtjes së mjedisit dhe rikuperimit të materialeve. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në:

Përgatitjen e një deklaratë metodologjike të shembjes, duke identifikuar teknikat e shembjes, renditjen e punimeve, pajisjet, zonat e përjashtimit dhe masat e sigurisë;

Vlerësimin e qëndrueshmërisë strukturore përpara shembjes, për të parandaluar shembjen e pakontrolluar;

Çmontimin progresiv dhe të kontrolluar të elementeve të urës për të minimizuar dridhjet, zhurmën, pluhurin dhe shpërndarjen e mbetjeve;

Mbrojtjen e rrjedhave ujore dhe brigjeve të lumenjve përmes strukturave të përkohshme mbrojtëse si rrjeta për mbetje, barriera ose platforma, kur është e nevojshme; dhe

Ndarjen e qartë ndërmjet zonave të shembjes dhe zonave të hapura për publikun ose trafikun e ndërtimit, në koordinim me Planin e Menaxhimit të Trafikut.

Strategjia dhe Hierarkia e Menaxhimit të Mbetjeve

Në përputhje me ESS3 dhe PMNI, PSMM zbaton hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve dhe udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

Minimizimi i gjenerimit të mbetjeve në burim përmes optimizimit të renditjes së shembjes dhe planifikimit të rikuperimit të materialeve;

Maksimizimi i ripërdorimit dhe riciklimit të materialeve, veçanërisht materialeve inerte si betoni, asfalti dhe materialet murature, përmes ndarjes në burim;

Sigurimi që mbetjet që nuk mund të ripërdoren të transportohen dhe asgjësohen vetëm në impiante të licencuara dhe të autorizuara, në përputhje me kërkesat kombëtare; dhe

Sigurimi i trajtimit, ruajtjes, transportit dhe asgjësimit të sigurt të mbetjeve të rrezikshme përmes operatorëve të miratuar, në koordinim me autoritetet përkatëse vendore dhe kombëtare.

Rrjedhat e Mbetjeve dhe Masat e Menaxhimit

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

PSMM mbulon të gjitha rrjedhat e mbetjeve të gjeneruara gjatë shembjes dhe ndërtimit, duke përfshirë:

Mbetjet inerte nga shembjet, materialet e gërmuara, betoni, asfalti dhe materialet murature;

Materialet e tepërta të ndërtimit dhe mbetjet e paketimit;

Mbetjet e tipit komunal të gjeneruara nga fuqia punëtore;

Ujërat e ndotura nga ndërtimi, përfshirë larjen e betonit; dhe

Mbetjet e rrezikshme si vajrat, karburantet, lubrifikantët, materialet e kontaminuara dhe tokat potencialisht të ndotura.

Përcaktohen procedura specifike për të parandaluar shkarkimet e pakontrolluara, derdhjet ose rrjedhjet, veçanërisht në afërsi të rrjedhave ujore ose receptorëve të ndjeshëm mjedisorë. Zonat e përkohshme të magazinimit përcaktohen qartë, sigurohen dhe mbrohen nga rrjedhjet sipërfaqësore, me etiketim të përshtatshëm dhe sisteme dytësore mbajtjeje kur kërkohet.

Kontrolli i Pluhurit, Zhurmës dhe Shqetësimeve gjatë Shembjeve

PSMM përfshin masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe shpërndarjes së mbetjeve gjatë aktiviteteve të shembjeve, duke përfshirë:

Përdorimin e sistemeve të spërkatjes me ujë ose mjegull për reduktimin e pluhurit gjatë thyerjes, prerjes dhe ngarkimit të materialeve;

Mbulesën e grumbujve të materialeve dhe mjeteve të transportit që mbajnë materiale të imta;

Kufizimin e lartësisë së hedhjes dhe ngarkimin e kontrolluar të mbetjeve nga shembjet; dhe

Koordinimin e orareve të shembjeve për të reduktuar shqetësimet ndaj receptorëve pranë.

Transporti, Asgjësimi dhe Dokumentimi

Të gjitha aktivitetet e mbledhjes, transportit, ripërdorimit, riciklimit dhe asgjësimit të mbetjeve kryhen nga operatorë të licencuar, në bazë të detyrimeve kontraktuale që kërkojnë përputhshmëri me kushtet kombëtare të lejeve dhe kërkesat e Bankës Botërore, përfshirë Praktikën e Mira Ndërkombëtare (PMNI), në këtë rast Protokollin e BE-së për Menaxhimin e Mbetjeve nga Ndërtimi dhe Shembja, duke zbatuar gjithmonë kërkesat më të rrepta. PSMM përfshin dispozita, por pa u kufizuar në:

Ndarjen në burim, etiketimin dhe magazinimin e përkohshëm të rrjedhave të mbetjeve në kantier;

Mbajtjen e regjistrave të mbetjeve që dokumentojnë llojin, sasinë, origjinën, ripërdorimin, riciklimin, transportin dhe destinacionin përfundimtar;

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Fletë-dorëzimet e mbetjeve, certifikatat e asgjësimit dhe regjistrimet e dorëzimit tek impiantet e licencuara;

Inspektime dhe auditime të rregullta të praktikave të menaxhimit të mbetjeve;

Përfshirjen e performancës së menaxhimit të mbetjeve në raportet periodike të monitorimit Mjedisor, Social, Shëndetësor dhe të Sigurisë;

Masa për kontrollin e pluhurit dhe zhurmës dhe masa të tjera sipas nevojës dhe kërkesave.

Trajnimi, Komunikimi dhe Mbikëqyrja

PSMM përfshin trajnime të detyrueshme për punëtorët dhe stafin teknik mbi sigurinë gjatë prishjes, ndarjen e mbetjeve, parandalimin e derdhjeve, reagimin në emergjencë dhe kërkesat e raportimit. Gjithashtu përcaktohen procedura për komunikimin dhe koordinimin me palët e interesuara dhe komunitetet e prekura, veçanërisht kur aktivitetet e prishjes ose rrugët e transportit të mbetjeve mund të shkaktojnë shqetësime të përkohshme.

Zbatimi efektiv i Planit të Prishjes dhe Menaxhimit të Mbetjeve, i mbështetur nga mbikëqyrja dhe monitorimi sipas kërkesave të KMMS, siguron që rreziqet mjedisore dhe sociale të lidhura me prishjen dhe mbetjet të mbeten të kontrolluara, të lokalizuara dhe të kthyeshme, si dhe që Projekti të jetë në përputhje me standardet ESS të Bankës Botërore, legjislacionin shqiptar dhe praktikat më të mira ndërkombëtare (PMNI), përfshirë Protokollin e BE-së për Menaxhimin e Mbetjeve nga Ndërtimi dhe Prishja, duke zbatuar gjithmonë kërkesat më të rrepta.

Seksioni 1.03 Procedurat e Kontrollit të Gjenerimit të Mbetjeve

Kontraktori duhet të hartojë këtë Procedurë të Kontrollit të Gjenerimit të Mbetjeve si pjesë e Planit të tij të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (C-ESMP) dhe PSMM.

Objektivat:

Të sigurohet parandalimi, reduktimi, ripërdorimi, rikuperimi, riciklimi, largimi dhe asgjësimi i mbetjeve të krijuara nga aktivitetet e projektit në mënyrë që të minimizohet ndikimi ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit;

Asgjësimi i mbetjeve që nuk mund të rikuperohen ose ripërdoren në impiante të miratuara dhe të licencuara (me leje operimi), në mënyrë të sigurt mjedisore;

Minimizimi, përmbajtja, transportimi, trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme në mënyrë që të minimizohen ndikimet ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit;

Asgjësimi i mbetjeve në impiante të licencuara të miratuara nga autoritetet.

Si prodhues mbetjesh, Kontraktori ka një detyrim “kujdesi” për menaxhimin e tyre. Ai është i detyruar të minimizojë rrezikun e ndotjes dhe të sigurojë që personat ose subjektet që trajtojnë dhe asgjësojnë mbetjet janë të autorizuar për këtë.

Parimet Udhëzuese

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Kontraktori angazhohet të zbatojë këto parime në menaxhimin e mbetjeve:

Përputhshmëri me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe procedurat e Bankës Botërore;

Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi menaxhimi të mbetjeve dhe praktikave në kantier që janë në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e punimeve dhe me llojin dhe sasinë e mbetjeve të gjeneruara (“i përshtatshëm për qëllimin”);

Respektimi i hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve (në rend zbritës: shmangia, minimizimi, ndarja në burim, magazinimi i përkohshëm, mbledhja, transporti, trajtimi, ripërdorimi, riciklimi dhe asgjësimi përfundimtar);

Zbatimi i praktikave më të mira ndërkombëtare për asgjësimin e mbetjeve, kur është e mundur.

Hierarkia e Dokumenteve të Menaxhimit të Mbetjeve

Aktivitetet e mbuluara nga ky Plan i Menaxhimit të Mbetjeve (PMM) përfshijnë minimizimin, ndarjen, magazinimin e përkohshëm, transportin, ripërdorimin, riciklimin dhe asgjësimin përfundimtar të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme të krijuara gjatë punimeve për rrugë hyrëse dhe ura sipas kontratës A.

Ky dokument është Plani i Menaxhimit të Mbetjeve dhe përshkruan në nivel të përgjithshëm sistemin e menaxhimit të mbetjeve të Kontraktorit.

Procedura përshkruan në mënyrë të detajuar aktivitetet për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, si dhe kohën, vendin dhe përgjegjësit përkatës.

Aktivitetet përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Minimizimin e mbetjeve
- Identifikimin dhe ndarjen
- Magazinimin e përkohshëm
- Trajtimin
- Transferimin/transportin
- Ripërdorimin dhe riciklimin
- Asgjësimin përfundimtar

Aktivitetet e përmendura më sipër gjenerojnë një sërë mbetjesh të cilat klasifikohen si më poshtë:

Mbetje jo të rrezikshme: që përfshijnë mbetje urbane dhe materiale inerte si: letra, qese plastike, mbeturina, qelq, dëmtime nga aksidentet automobilistike, largim i vegetacionit, shkurre, barishte, gurë të rënë nga shpatet, zhavorr, toka, llum nga pastrimi i kanaleve, dru, mbeturina të ndryshme, karton, skrap metalik; si dhe mbetje ndërtimi si mbetje nga heqja e shtresave të asfaltit, zhavorr, agregate guri, etj.

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Mbetje të rrezikshme: lecka/rroba të ndotura, vaj i përdorur, kanaçe lubrifikantësh, kanaçe boje, enë kimikatesh, derdhje aksidentale.

Menaxhimi i mbetjeve jo të rrezikshme.

Menaxhimi i mbetjeve urbane

Mbetjet urbane përfshijnë mbeturina, letër, karton, plastikë, qelq, ambalazhe ushqimore, shishe, etj. Në kampin e kantierit janë vendosur kosha të veçantë për mbetjet sipas kategorive dhe janë të etiketuar për t’u dalluar më mirë. Kjo bëhet për të mundësuar ndarjen e tyre në burim dhe për të lehtësuar procesin deri në depozitimin përfundimtar.

Mbetjet biodegraduese do të mblidhen çdo ditë dhe nuk do të lejohen të grumbullohen në mënyrë që të shkaktojnë rrezik për mjedisin.

Mbetjet urbane mblidhen dhe transportohen me mjete drejt një landfilli të miratuar nga bashkia përkatëse ose njësi administrative lokale. Transporti do të bëhet me mjete të etiketuara, të projektuara për të reduktuar rrezikun e shpërndarjes së materialeve dhe mbeturinave nga era. Drejtuesit e këtyre mjeteve janë të trajnuar për trajtimin dhe asgjësimin e ngarkesës.

Çdo punëtor është i trajnuar për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve drejt vendit përfundimtar të depozitimit. Ata janë gjithashtu të ndërgjegjshëm për ndikimet negative në shëndet dhe mjedis që mund të shkaktohen nga menaxhimi i dobët i mbetjeve.

Menaxhimi i mbetjeve të ndërtimit

Në vendet e punës janë përcaktuar gjithashtu zona për mbledhjen e dheut të gërmuar, zhavorrit dhe agregateve. Këto mbetje mblidhen dhe më pas ripërdoren për rehabilitim në kantier ose jashtë tij, sipas nevojave të kompanisë në projekte të tjera.

Asnjë material i gërmuar, veçanërisht gjatë fazës së rehabilitimit, nuk do të hidhet apo depozitohet në lumenj, rrugë apo vende të tjera që mund të shkaktojnë ndikime negative në mjedis, përveç në impiante të licencuara për rikuperim, magazinim, trajtim dhe depozitimin përfundimtar nga autoritetet përkatëse.

Materiali i tepërt që nuk mund të përdoret në kantier do t’u vihet në dispozicion palëve të treta për ripërdorim në projekte zhvillimi lokale.

Menaxhimi i vegjetacionit

Në lidhje me pastrimin dhe heqjen e vegjetacionit, punëtorët presin barin me makina prerëse dhe e grumbullojnë në një zonë të përcaktuar dhe të menaxhuar mirë për një periudhë të shkurtër, me qëllim ripërdorimin si humus në terren. Zona e punës rrethohet me sinjalistikë dhe masa të përshtatshme sigurie.

Aktualisht, plani ynë i menaxhimit të vegjetacionit përfshin prerje dhe kositje mekanike. Ekipet e mirëmbajtjes kryejnë kositjen anësore të rrugës dhe presin pemë të vogla ose shkurre. Nuk parashikohet prerja e pemëve të mëdha. Nëse është e nevojshme, në kushte normale, do të merret leje paraprake nga bashkitë përkatëse. Në raste emergjente (p.sh. rrëshqitje dheu) kur

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

trafiku pengohet ose ka rreziqe për sigurinë rrugore, pemët mund të priten, por paraprakisht dokumentohen me fotografi dhe regjistrime.

Sipas Kodit Rrugor Shqiptar, kufiri i rrugës (pronë e ARRSH) përkufizohet nga skaji i jashtëm i kanalit ose nga baza e shpatit kur rruga është në ngritje, ose nga skaji i sipërm i shpatit kur rruga është në thellësi.

Në zonat e mbrojtura, çdo prerje apo kositje mekanike do të kryhet vetëm pas marrjes së lejes përkatëse duke njoftuar Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme

Në këtë projekt, mbetjet e rrezikshme përfshijnë jo vetëm ato që krijohen nga mirëmbajtja e mjeteve ose rrjedhjet e tyre (si vaj i përdorur, bateri e dëmtuar, etj.), por edhe mbetje të gjetura gjatë pastrimit të rrugës si lecka të ndotura, enë kimikatesh, etj.

Në magazinat tona ekziston një zonë e dedikuar për derdhjet aksidentale (spill kit), ku vendoset një fuçi për vajin e përdorur dhe një enë për mbledhjen e mbetjeve të tjera të rrezikshme. Të gjitha mbetjet vajore mblidhen veçmas në enë hermetike dhe dorëzohen te kompani të autorizuara për menaxhim dhe asgjësim. Mbetjet e tjera ruhen përkohësisht në këtë zonë dhe më pas transportohen në vende të përcaktuara për trajtim nga kompani të licencuara, në përputhje me kuadrin ligjor. Lloje të ndryshme mbetjesh të rrezikshme duhet të mblidhen veçmas dhe nuk duhet të përzihen.

Për të garantuar mbrojtjen e shëndetit, punëtorët pajisen me mjete mbrojtëse personale si doreza, maska, veshje mbrojtëse dhe këpucë sigurie, veçanërisht gjatë mbledhjes së mbetjeve. Kjo ndihmon në parandalimin e përhapjes së sëmundjeve nga materialet e ndotura.

Në fund të ditës, personi përgjegjës për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve raporton te menaxheri i kantierit për kategorinë, sasinë e mbetjeve dhe të gjitha të dhënat sipas formatit të raportimit. Baza e të dhënave për mbetjet mbahet nga specialisti i mjedisit dhe shoqëron raportin mujor të progresit.

Gjurmimi i mbetjeve

Procedura e menaxhimit të mbetjeve përfshin gjithashtu krijimin dhe përditësimin periodik të një sistemi elektronik për gjurmimin e mbetjeve (p.sh. tabelë në Microsoft Excel), ku regjistrohen të dhënat sipas llojit të mbetjeve dhe kërkesave specifike.

Të gjitha mbetjet e krijuara në kantier do të transportohen në një vend të përkohshëm të përshtatshëm, i cili miratohet paraprakisht nga bashkia lokale. Do të nënshkruhet një marrëveshje midis kompanisë dhe autoriteteve lokale për aktivitetet e depozitimit. Do të vendosen kontenierë për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve të rrezikshme si kimikate, karburante, etj., dhe do të regjistrohen llojet dhe sasinë përkatëse.

Regjistrimet

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Zhvillimi dhe zbatimi i këtij Plani të Menaxhimit të Mbetjeve (PMM) dhe procedurave përkatëse do të çojë në krijimin e regjistrimeve të dokumentuara. Këto regjistrime do të shërbejnë si provë e zbatimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve dhe praktikave përkatëse në zyrën qendrore, në njësitë dhe në kantier.

Dokumentacioni do të ruhet për të vërtetuar depozitimin ligjor të të gjitha llojeve të mbetjeve. Kërkohej dokumentacion i shkruar si fatura, kuponë dhe dokumente transferimi të mbetjeve që përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

Një kopje e licencës tregtare të kontraktorit për menaxhimin e mbetjeve dhe miratimi përkatës nga Bashkia

Për çdo ngarkesë mbetjesh të mbledhura: data, lloji i mbetjeve (p.sh. vaj i përdorur, ujëra të zeza, mbetje të përziera), sasia e mbetjeve në atë ngarkesë, landfilli i destinacionit, nënshkrimi i përfaqësuesit tonë të autorizuar

Dokumentacioni i listuar më sipër do t'i nënshtrohet auditimeve të brendshme dhe të jashtme

Masat e kontrollit për menaxhimin e mbetjeve

Masat e mëposhtme të kontrollit do të zbatohen për të reduktuar ndikimet mjedisore nga gjenerimi, trajtimi, magazinimi dhe depozitimi i mbetjeve:

- Ndalohet djegia në ambient të hapur e mbetjeve ose hedhja e tyre në zona të paautorizuara.
- Do të sigurohen kontenierë/kosha të veçantë dhe të etiketuar për plastikë, karton/letër, kanaçe dhe qelq.
- Ndalohet hollimi i mbetjeve të rrezikshme.
- Ndalohet përzierja e mbetjeve të rrezikshme me ato jo të rrezikshme.
- Do të zbatohet një program për mbledhjen dhe largimin e rregullt të kontenierëve dhe koshave.
- Kur është e mundur, do të zhvillohen dhe zbatohen tregues performance dhe objektiva për reduktim, ripërdorim dhe riciklim.
- Çdo mbetje që nuk mund të ripërdoret ose riciklohet do të transportohet dhe depozitohet në përputhje me kërkesat e Bashkisë.
- Vëllimet dhe llojet e mbetjeve do të monitorohen për të identifikuar mundësi shtesë për përmirësim në menaxhimin e mbetjeve (shmangie, reduktim, ripërdorim, riciklim), aty ku është e zbatueshme.
- Të gjithë punonjësit do të trajnohen për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve (PMM), përmes informimeve në turne, etj.
- Zonat e përkohshme të magazinimit të mbetjeve dhe kontenierët do të monitorohen për të siguruar që nuk ndodh ndotje e ndërsjellë. Do të kryhen inspektime rutinë nga drejtuesit e departamenteve për të garantuar përputhshmërinë me Planin e Menaxhimit të Mbetjeve.

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

- Depozitimi përfundimtar do të bëhet në landfill ose zona të tjera të miratuara nga Bashkia, të licencuara nga shteti dhe me leje të vlefshme operimi.

Kufomat e kafshëve të ngordhura

Si pjesë e detyrave tona si Kontraktor, ne jemi përgjegjës për mirëmbajtjen dhe sigurinë e rrugëve për përdoruesit. Në këtë kuadër, jemi përgjegjës për mbledhjen e disa kafshëve të ngordhura në rrugë. Synojmë largimin e tyre brenda pak orësh nga momenti i njoftimit.

Është e rëndësishme të shmanget prekja direkte e kafshës së ngordhur ose të përdoren doreza. Duhet përdorur një lopatë për ta marrë dhe vendosur në një qese plastike. Trupi mbështillet në qese plastike, vendoset në një kuti dhe varroset në një gropë të thellë. Kufomat do të varrosen në një vend të përshtatshëm bazuar në lejen/miratimin me shkrim të Shërbimit Veterinar (që mund të merret paraprakisht). Kontraktori do të mbajë regjistra për to dhe për vendet e varrimit.

Për këtë është përcaktuar procedura si më poshtë:

Njoftimi/raportimi i kafshës së ngordhur me Shërbimin Veterinar të Qarkut

Mbledhja e kafshëve të ngordhura

Transporti dhe dorëzimi në zonën e depozitimit të miratuar zyrtarisht nga Shërbimi Veterinar i Qarkut (edhe pse nuk ka kontratë formale, bashkëpunimi është detyrim ligjor)

Sigurimi që vëndndodhja është (i) të paktën 500 m larg zonave të banuara dhe (ii) nuk rrezikon burimet ujore

Regjistrimi dhe dokumentimi me fotografi

Këto regjistrime mbahen nga specialisti i mjedisit i kontraktorit dhe përfshihen në raportet mujore/tremujore/vjetore për ARRSH/ekspertët mjedisorë përkatës.

Seksioni 1.04 – Plani i Menaxhimit të Materialeve të Rrezikshme

Kontraktori ka hartuar këtë Plan të Menaxhimit të Materialeve të Rrezikshme si pjesë e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (C-ESMP).

Objektivi

Objektivi i këtij plani është:

Parandalimi i çlirimeve të pakontrolluara të materialeve të rrezikshme gjatë transportit, trajtimit, magazinimit dhe përdorimit;

Sigurimi që çdo kimikat ose material i ndaluar ose në proces ndalimi sipas legjislacionit kombëtar apo ndërkombëtar të mos përdoret.

Ky plan duhet të lexohet në lidhje me planet e tjera të menaxhimit mjedisor dhe social. Si kërkesë e përgjithshme, transporti, trajtimi dhe përdorimi i materialeve të rrezikshme duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet e Bankës Botërore. Ky plan

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

përcakton protokollin që duhet ndjekur gjatë magazinimit, transportit, trajtimit dhe asgjësimit të materialeve të rrezikshme për të garantuar:

Mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së personelit

Mbrojtjen e mjedisit

Përputhshmërinë me kërkesat ligjore përkatëse

Reduktimin dhe kontrollin e rreziqeve që lidhen me materialet e rrezikshme

Magazinimi

Të gjitha materialet e rrezikshme do të magazinohen në zona të dedikuara, të cilat duhet të jenë në përputhje me të gjitha ligjet, rregulloret dhe standardet shqiptare në fuqi, si dhe të plotësojnë kërkesat e autoriteteve lokale dhe ato të fletëpalosjeve të sigurisë përkatëse (p.sh. rregullat për papajtueshmërinë në magazinim, ventilimin, tabakatë për derdhje, mjetet kundër zjarrit dhe sinjalistikën). Sasia e çdo materiali të lejuar në kantier do të kontrollohet rreptësisht. Vendndodhja e magazinimit të materialeve të rrezikshme do t’u komunikohet të gjithë punonjësve.

Kërkesa të përgjithshme

Materialet e rrezikshme do të magazinohen në zona të përcaktuara, përveç sasive të nevojshme për aktivitetet e përditshme të ndërtimit. Materialet e rrezikshme që kërkojnë magazinim të përkohshëm do të ruhen në zonën e magazinimit të dedikuar në kampin e kantierit.

Nëse është e nevojshme krijimi i zonave të tjera magazinimi, ato nuk do të lejohen:

- brenda 50 m nga rrjedhat e vogla ujore,
- brenda 100 m nga rrjedhat e mëdha ujore,
- në zona të përmblytshme,
- ose në vende ku ekziston rreziku që materialet e derdhura të depërtojnë në ujërat nëntokësore.
- Zonat ku magazinohen materialet e rrezikshme do të jenë:
 - të ajrosura mirë dhe të ndriçuara mirë,
 - të ndara nga burimet e ndezjes,
 - të mbrojtura nga luhatjet e temperaturës dhe rrezet direkte të diellit,
 - të pajisura me mjete për përmbajtjen e derdhjeve (p.sh. tabaka),
 - me konstrukcion rezistent ndaj flakës,
 - të sigurta për të parandaluar aksesin ose përdorimin e paautorizuar.
- Nëse magazinimi realizohet me strukturë metalike, ajo duhet të lidhet me tokën për të shmangur incidentet nga elektriciteti statik.

Nëse kontenierët vendosen në rafte apo dollapë, ato duhet:

- të jenë prej materialesh rezistente ndaj kimikateve,

- të kenë një buzë mbrojtëse në pjesën e përparme të raftit,
- të kenë sistem dytësor për mbajtjen e derdhjeve.

Diferencimi

Materialet e rrezikshme të klasave të ndryshme nuk mund të magazinohen së bashku dhe duhet të kenë distancë të mjaftueshme midis tyre për të minimizuar rrezikun e zjarrit, shpërthimit ose grumbullimit të gazrave apo avujve toksikë nga rrjedhjet/derdhjet. Informacione të mëtejshme për ndarjen e substancave specifike gjenden në MSDS përkatëse.

Substancat e ndezshme

Lëngjet e ndezshme dhe të djegshme nuk do të magazinohen pranë daljeve, shkallëve apo korridoreve të emergjencës. Sasitë e ruajtura në dhoma të dedikuara për materiale të ndezshme do të kufizohen sa më shumë që të jetë e mundur. Kimikatet e papajtueshme dhe oksiduesit do të ndahen nga lëngjet e ndezshme dhe nuk do të ruhen kurrë në të njëjtin kabinet. Sasia e këtyre lëngjeve jashtë zonave të posaçme do të jetë minimale dhe vetëm aq sa kërkohet për punën. Pajisjet kundër zjarrit do të jenë gjithmonë të disponueshme pranë zonave të magazinimit.

Etiketimi

Të gjitha kontenierët dhe paketimet që përmbajnë materiale të rrezikshme duhet të jenë të etiketuara në një gjuhë të kuptueshme për përdoruesit. Etiketa duhet të përfshijë:

- Emrin e substancës së rrezikshme
- Simbolin e rrezikut
- Rreziqet fizike dhe shëndetësore
- Udhëzimet për trajtim dhe magazinim
- Pajisjet mbrojtëse
- Masat e ndihmës së pare
- Masat për fikjen e zjarrit
- Masat në rast derdhjeje aksidentale
- Emrin, adresën dhe numrin e emergjencës të prodhuesit

Nëse materiali transferohet nga një enë e etiketuar në një enë pa etiketë, kjo e fundit duhet të etiketohet menjëherë.

Sipas legjislacionit shqiptar, kontenierët për vajin e përdorur duhet të kenë etiketën e furnizuar nga nënkontraktori, ku përfshihet emri dhe adresa e kompanisë së licencuar për riciklim.

Transporti

Furnitorët ose nënkontraktorët që sjellin materiale të rrezikshme në kantier duhet të respektojnë plotësisht ligjet, rregulloret dhe standardet shqiptare për transportin e mallrave të rrezikshme.

Transporti i këtyre materialeve në kantier do të kryhet në përputhje të plotë me kërkesat e MSDS perkatëse. Automjetet do të kontrollohen në hyrje të kantierit dhe duhet të kenë

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

sinjalistikë të dukshme nga të gjitha anët që tregon praninë e materialeve të rrezikshme. Këto shenja hiqen kur automjeti nuk transporton më materiale të tilla.

Materialet e rrezikshme do të transportohen vetëm nga kompani të licencuara dhe drejtues të trajnuar. Automjetet duhet të jenë në gjendje të mirë teknike, të përshtatshme për transport të sigurt dhe të pajisura me mjete për menaxhimin e derdhjeve.

Procedurat për ngarkim dhe shkarkim të sigurt

- Automjetet e shërbimit do të jenë të pajisura me valvula automatike mbylljeje
- Frenat do të aktivizohen
- Rrotat do të bllokohen
- Automjeti do të tokëzohet nëse materiali është i ndezshëm
- Operatori do të monitorojë gjatë gjithë kohës procesin e ngarkim-shkarkimit
- Pas përfundimit, operatori do të kontrollojë për rrjedhje dhe do të ndërmarrë masa korrigjuese nëse është e nevojshme

Pajisjet mbrojtëse personale

Pavarësisht pajisjeve të detyrueshme në kantier (helmetë, këpucë sigurie, jelek reflektues), punonjësit duhet të përdorin edhe pajisjet e mëposhtme sipas kërkesave të MSDS:

- Syze sigurie, syze mbrojtëse ose mbrojtëse e plotë e fytyrës
- Maskë pluhuri, maskë për tretës ose pajisje të tjera për frymëmarrje
- Veshje kimike ose kominoshe të aprovuara
- Doreza gome, nitrili ose vinili
- Çizme gome

Këto pajisje do të vihen në dispozicion dhe përdorimi i tyre do të jetë i detyrueshëm për të gjithë personelin që punon me materiale të rrezikshme. Ato do të shpërndahen në përputhje të plotë me rekomandimet e MSDS. Në rast se kërkohen pajisje të specializuara, mbikëqyrësit do të sigurojnë që punonjësit të jenë të trajnuar dhe të aftë në përdorimin e tyre. Gjithashtu, do të verifikohet përputhshmëria e pajisjeve për çdo punë specifike.

Masat e ndihmës së parë

Masat e ndihmës së parë për personelin e ekspozuar aksidentalisht ndaj materialeve të rrezikshme janë të përshkruara qartë në MSDS përkatëse. Kutitë e ndihmës së parë do të jenë të disponueshme në vendet e punës ku përdoren materiale të rrezikshme.

Stacione për larjen e syve do të instalohen në zonat ku përdoren substanca korrozive. Këto stacione duhet të sigurojnë shpëlarje të vazhdueshme për 15 minuta dhe të vendosen në zona pa pengesa.

Monitorimi dhe inspektimi

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Për menaxhimin e materialeve të rrezikshme do të mbahet një regjistër i të gjitha lëngjeve të rrezikshme të përdorura, i cili do të përditësohet rregullisht dhe raportohet çdo tremujor. Ky regjistër do të përfshijë:

- Burimin e furnizimit
- Llojin e lëngut të rrezikshëm të magazinuar dhe përdorur
- Sasinë e magazinuar dhe përdorur
- Metodën dhe vendndodhjen e magazinimit
- Mënyrën e përdorimit
- Derdhjet ose incidentet e tjera

Ndërgjegjësimi dhe trajnimi për sigurinë

Para se një person të ekspozohet ndaj materialeve të rrezikshme, ai duhet të informohet për të gjitha kërkesat HSE që lidhen me atë material. Trajnimi për punonjësit që punojnë në zona me materiale të rrezikshme realizohet në tre nivele:

Trajnim hyrës HSE për të gjithë punonjësit e rinj, që përfshin njohuri të përgjithshme për materialet e rrezikshme

Trajnim për higjienën dhe sigurinë kimike, që trajton rreziqet dhe masat mbrojtëse

Trajnim specifik për operacionet, që mbulon rreziqet në punë, përdorimin dhe kufizimet e masave mbrojtëse, shenjat paralajmëruese të ekspozimit (p.sh. erëra, irritime) dhe procedurat emergjente

Mbikëqyrësit janë përgjegjës për të siguruar që punonjësit të trajnohen për rreziqet dhe masat mbrojtëse të materialeve të reja të futura në vendin e punës.

Seksioni 1.05 – Plani i Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentimit

Plani i Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentimit (PKES) është hartuar si një instrument menaxhimi specifik për kantierin dhe është pjesë përbërëse e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS). Ai është zhvilluar në përputhje me Kornizën Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore, veçanërisht standardet ESS1, ESS3, ESS4 dhe ESS6, si dhe në përputhje me kërkesat e Kornizës së Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS).

Plani zbatohet për të gjitha aktivitetet ndërtimore dhe ndihmëse të projektit dhe përcakton një kuadër të plotë për parandalimin, minimizimin dhe menaxhimin e erozionit të tokës dhe transportit të sedimenteve gjatë dhe pas ndërtimit.

Objektivi i përgjithshëm

Qëllimi kryesor i ESCP është të ruajë stabilitetin e terrenit, të reduktojë proceset e erozionit, të mbështesë rehabilitimin efektiv të kantierit dhe të parandalojë ndikimet negative në cilësinë e ujërave sipërfaqësore, habitatet ujore dhe përdoruesit në rrjedhën e poshtme.

Kjo arrihet përmes zbatimit të praktikave të mira ndërkombëtare dhe integritit të masave të kontrollit në planet e menaxhimit të kontraktorit.

Aktivitetet me rrezik

Plani identifikon aktivitetet që mund të shkaktojnë erozion dhe sedimentim, si:

- Pastrimi i kantierit
- Punimet e gërmimit
- Nivelimi i terrenit
- Hapja e kanaleve
- Grumbullimi i materialeve

Për këto aktivitete përcaktohen masa parandaluese para, gjatë dhe pas ndërtimit, në përputhje me shkallën dhe rrezikun e punimeve.

Objektivat kryesore

Në përputhje me kërkesat e Bankës Botërore, plani synon:

- Minimizimin e prishjes së tokës përmes planifikimit të mirë të punimeve
- Mbrojtjen e tokës së ekspozuar përmes stabilizimit dhe drenazhimit të kontrolluar
- Parandalimin e transportit të pakontrolluar të sedimenteve në ujëra dhe zona të ndjeshme
- Zbatimin e masave të përkohshme dhe të përhershme të kontrollit të erozionit
- Vendosjen e sistemeve të inspektimit, monitorimit dhe mirëmbajtjes

Vëmendje e veçantë i kushtohet zonave të ndjeshme mjedisore, veçanërisht atyre pranë zonave të mbrojtura, ku aplikohen masa më të forta kontrolli dhe monitorim më i shpeshtë.

Masat Kryesore të Kontrollit

Pastrimi i kantierit dhe menaxhimi i vegjetacionit

Pastrimi i vegjetacionit do të kufizohet vetëm në atë që është e domosdoshme për aktivitetet e ndërtimit. Vegjetacioni ekzistues dhe bankat e farave do të ruhen sa herë që është e mundur për të mbështetur rehabilitimin. Do të ruhen zona mbrojtëse prej të paktën 2–3 m përgjatë trupave ujorë. Sistemet rrënjore dhe vegjetacioni barishtor do të ruhen, kur është e mundur, për të garantuar stabilitetin e tokës. Vegjetacioni i hequr do të depozitohet larg ujërave sipërfaqësore dhe ndalohet rreptësisht futja e specieve jo-vendase.

Menaxhimi i shtresës së sipërme dhe nëntokës (topsoil dhe subsoil)

Shtresa e sipërme e tokës do të hiqet, trajtohet dhe depozitohet me kujdes, e ndarë nga nëntoka, për të ruajtur strukturën, pjellorinë dhe përmbajtjen e farave. Grumbujt e depozitimit do të mbahen në lartësi të kontrolluar, do të mbrohen nga erozioni përmes mbulimit ose rigjenerimit natyror dhe do të vendosen në distanca të sigurta nga trupat ujorë. Masa të tilla si kanalet devijuese, ndarja me gjeotekstil dhe barrierat kundër erozionit do të zbatohen për të parandaluar përzierjen dhe humbjen e materialit. Depozitimi afatgjatë do të shmanget; kur është i pashmangshëm, do të menaxhohet përmes ajrosjes periodike.

Nivelimi dhe punimet e dheut

Aktivitetet e nivelimit do të kontrollohen me kujdes për të shmangur dëmtimin e sistemeve rrënjore të pemëve dhe zonave të ndjeshme, përfshirë ligatinat. Punimet e dheut do të projektohen në mënyrë që të drejtojnë rrjedhjet sipërfaqësore larg receptorëve të ndjeshëm dhe të minimizojnë transportin e sedimenteve. Në zonat e mbrojtura ose të ndjeshme, nivelimi do t'i nënshtrohet kontroleve shtesë, duke përfshirë dokumentimin topografik dhe kërkesa specifike për rehabilitim.

Menaxhimi i tokave të kontaminuara

Kur hasen toka të kontaminuara, do të zbatohet një qasje e shkallëzuar e vlerësimit të rrezikut në përputhje me legjislacionin shqiptar. Në rast identifikimi të rreziqeve, do të hartohen plane rehabilitimi në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Do të përdoren pajisje të përshtatshme mbrojtëse personale (PPE) për të garantuar sigurinë e punëtorëve.

Menaxhimi i materialeve të tepërta

Toka dhe shkëmbi i tepërt do të priorizohen për ripërdorim brenda Projektit. Kur ripërdorimi nuk është i mundur, materialet mund t'u transferohen palëve të treta ose të depozitohen në vende të miratuara, përfshirë guroret e licencuara, në përputhje me kërkesat rregullatore në fuqi.

Masat për kontrollin e sedimenteve

Masa strukturore si gardhe sedimentesh (silt fences), barriera sedimentesh, kanale devijuese dhe ndërprerës të pjerrësisë do të instalohen për të kontrolluar rrjedhjen e sedimenteve. Gardhet e sedimenteve do të përdoren në zona të prirura ndaj erozionit sipërfaqësor ose vijëzor dhe do të projektohen duke marrë parasysh sipërfaqen e kullimit, pjerrësinë dhe kushtet e rrjedhës. Këto masa do të plotësohen me sisteme për shpërndarjen e energjisë së rrjedhës dhe drenazh të kontrolluar.

Menaxhimi i mjeteve dhe pajisjeve

Lëvizja e mjeteve do të kufizohet në zona të përcaktuara për të parandaluar ngjeshjen e tokës dhe dëmtimin e shtresës së sipërme. Masa shtesë do të zbatohen në terrene të buta dhe zona ligatinore, duke përfshirë përdorimin e mbrojtjes së përkohshme të sipërfaqes. Pas rehabilitimit, qasja e mjeteve në zonat e rikthyera do të ndalohej.

Masat e përgjithshme për kontrollin e erozionit dhe rehabilitimin

Aktivitetet e ndërtimit planifikohen në mënyrë të tillë që të minimizohen sipërfaqet e disturbura, ndërsa rehabilitimi, përfshirë nivelimin dhe revegetimin, kryhet sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur. Ujërat sipërfaqësore devijohen rreth zonave të disturbura dhe instalohen struktura për kontrollin e erozionit për të stabilizuar shpatet dhe për të parandaluar transportin e sedimenteve. Ngjeshja e nëntokës lehtësohet përmes skarifikimit përpara vendosjes së shtresës së sipërme të tokës, veçanërisht në zonat bujqësore.

Në kalimet e trupave ujorë, të gjitha materialet e ndërtimit dhe mbetjet hiqen pas përfundimit të punimeve për të rikthyer kushtet natyrore të rrjedhjes. Masa të përhershme për kontrollin e

erozionit zbatohen për të stabilizuar formacionet e rikonfiguruar të terrenit, për të parandaluar shpëlarjen dhe për të mbrojtur sistemet e drenazhimit.

Monitorimi, Inspektimi dhe Menaxhimi Adaptiv

Kontraktori kryen vëzhgime periodike në zonat e prirura ndaj erozionit, përfshirë skajet e rrugëve dhe brigjet e lumenjve, me një frekuencë minimale monitorimi mujore gjatë sezonit të lagësht dhe tremujore gjatë sezonit të thatë. Inspektimi dhe mirëmbajtja e masave për kontrollin e erozionit dhe sedimenteve kryhen rregullisht për të siguruar funksionalitetin dhe efektivitetin e tyre.

Plani i Kontrollit të Erozionit dhe Sedimenteve (ESCP) është një dokument dinamik dhe përditësohet sipas nevojës për të reflektuar ndryshimet në projektim, metodologjitë e ndërtimit ose kushtet në terren. Ky plan, në përputhje të plotë me PMMS, përditësohet sipas rastit dhe i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit nga Inxhinieri Mbikëqyrës (SE), Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU) dhe Banka Botërore.

Seksioni 1.06 – Procedura për Kontrollin e Emetimeve në Ajër dhe Pluhurit

Qëllimi i këtij plani është të minimizojë ndikimet e mundshme të emetimeve në ajër mbi receptorët si rezultat i punimeve të ndërtimit. Plani i Menaxhimit të Emetimeve në Ajër dhe Pluhurit paraqet një përmbledhje të ndikimeve të mundshme mjedisore në cilësinë e ajrit, së bashku me masat parandaluese dhe menaxhuese për t'i shmangur ose reduktuar këto ndikime.

Burimet kryesore të emetimeve dhe ndotjes së ajrit janë emetimet difuze nga aktivitetet e punimeve në terren dhe transporti i materialeve dhe mbetjeve, të cilat mund të përmbajnë grimca të pezulluara ose pluhur. Receptorët potencialë përgjatë gjurmës përfshijnë banorët lokalë, bizneset dhe faunën.

Emetimet në ajër, zhurma dhe vibrimet mund të jenë shqetësuese dhe potencialisht të dëmshme për njerëzit dhe jetën e egër. Aktivitetet pranë zonave të banuara dhe receptorëve të ndjeshëm (p.sh. banesa individuale, objekte blegtorale, etj.) mund të shkaktojnë shqetësime të përkohshme, ndërsa vibrimet mund të dëmtojnë ndërtesat dhe strukturat. Ky plan synon përputhshmërinë me kërkesat kontraktuale dhe legjislaionin shqiptar në fuqi

Kontrolli i emetimeve në ajër dhe pluhurit

Burimet kryesore të emetimeve në ajër përfshijnë gazrat e shkarkimit nga automjetet, pluhurin e ngritur nga lëvizja e mjeteve, gërmimet, si dhe nga transporti dhe shkarkimi i zhavorrit dhe tokës. Disa aktivitete gjatë fazës së mirëmbajtjes mund të gjenerojnë përkohësisht sasi të vogla pluhuri, zhurme dhe ndotjeje të ajrit, ndërsa gjatë fazës së rehabilitimit nivelet e emetimeve mund të jenë më të larta.

Do të zbatohen procedurat e mëposhtme për kontrollin e pluhurit:

Uji do të jetë mjeti i vetëm për shtypjen e pluhurit gjatë periudhave kur gjenerohet pluhur i dukshëm.

Nëse teknikat standarde nuk janë efektive (p.sh. gjatë erërave të forta), aktivitetet mund të modifikohen për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve dhe publikut.

Spërkatje me ujë gjatë sezonit të thatë në zonat e punës dhe në rrugët e pashtuara.

Përdorimi i ujit do të kontrollohet për të shmangur krijimin e pellgjeve, dëmtimin e terrenit nga mjetet, transportimin e baltës në rrugë ose sedimentimin në trupat ujorë.

Pajisjet e ndërtimit do të mirëmbahen në gjendje të mirë pune dhe do të pajisen me silenciatorë funksionalë.

Procedurat e prokurimit dhe mirëmbajtjes

Të gjitha mjetet do të mirëmbahen në mënyrë që emetimet e tyre të mos shkaktojnë shqetësime për punëtorët apo komunitetin lokal.

Pajisjet do të jenë të pajisura me sisteme për reduktimin e emetimeve sipas specifikimeve të prodhuesit.

Mirëmbajtja rutinë do të sigurojë që mjetet të jenë të sigurta dhe me emetime minimale.

Kontraktori do të mbajë një regjistër të të gjitha mjeteve në kantier, përfshirë inspektimet dhe mirëmbajtjen.

Pajisjet që shkaktojnë ndotje të konsiderueshme (p.sh. emetime të dukshme të tepërta) do të hiqen nga përdorimi deri në riparim.

Masat për komunitetin përreth

- Komunitetet që mund të ndikohen nga pluhuri ose zhurma do të informohen për aktivitetet.
- Do të vendosen kufizime të përshtatshme të shpejtësisë në fshatra dhe zona të banuara për të reduktuar pluhurin dhe zhurmën.
- Vegjetacioni i pastruar do të përdoret, kur është e mundur, për kontrollin e pluhurit.
- Pajisjet do të mirëmbahen për të kufizuar emetimet; çdo pajisje me emetime të tepërta do të hiqet nga përdorimi.
- Do të vendosen tabela për kufizimin e shpejtësisë në rrugët e pashtuara të projektit dhe kamionët që transportojnë materiale pluhur-formuese do të mbulohen.
- Shpejtësia e mjeteve do të kufizohet në 30 km/orë në rrugët e pashtuara dhe lëvizja do të kufizohet në korridoret e përcaktuara të qarkullimit.

Parandalimi i ndotjes – Emetimet në ajër

Aktivitetet e projektit mund të ndikojnë potencialisht në cilësinë e ajrit përmes:

- Automjeteve, pajisjeve dhe makinerive;
- Pastrimit të kanaleve dhe strukturave të drenazhimit;
- Depozitimit të materialeve (p.sh. nëntokë dhe agregate të ndryshme);
- Kontrollit të vegjetacionit;
- Transportit të materialeve tokësore dhe agregateve;

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Periudhës së rehabilitimit, gjatë së cilës sipërfaqja e servitutit mbetet e ekspozuar ndaj shtresës së sipërme të tokës deri në rivendosjen e vegjetacionit.

Kërkesat minimale për Kontraktorin për menaxhimin e emetimeve në ajër nga burime pikësore dhe jo-pikësore përfshijnë:

- Automjetet, pajisjet dhe makineritë;
- Ekspozimin e tokës gjatë punimeve;
- Transportin dhe depozitimin e materialeve;
- Ekspozimin e shtresës së sipërme gjatë rehabilitimit.
- Procedura për kufizimin e punës bosh (idling) të mjeteve do të zbatohet sa më shumë që të jetë e mundur:
- Pajisjet me naftë që nuk janë në përdorim aktiv do të fikën;
- Motorët e kamionëve në pritje do të fikën nëse qëndrojnë ndezur më shumë se 5 minuta;
- Të gjitha automjetet e lehta do të fikën kur nuk janë në përdorim.

Pompat dhe gjeneratorët do të vendosen larg zonave të akomodimit dhe sa më larg të jetë e mundur nga banesat për të minimizuar ndikimet te punëtorët dhe komuniteti. Çdo pajisje që shkakton ndotje të konsiderueshme (me emetime të dukshme të tepërta) do të hiqet nga përdorimi dhe do të servisohet. Ajo nuk do të përdoret derisa të jetë riparuar ose zëvendësuar. Mirëmbajtja rutinë do të kryhet nga ekipi përkatës për të siguruar minimizimin e emetimeve.

Parandalimi i ndotjes – Emetimi i pluhurit

Në kushte të thata, kur pluhuri bëhet shqetësim, masat zbutëse do të menaxhohen nga Menaxheri i Kantierit dhe përfshijnë:

Lagjen e grumbujve të materialeve, rrugëve dhe burimeve të tjera të pluhurit, veçanërisht në distanca <200 m nga zonat e banuara;

Mbulimin e materialeve dhe depozitave për të reduktuar shpërndarjen e pluhurit;

Njoftimin paraprak të bashkive për aktivitetet që gjenerojnë shumë pluhur;

Përdorimin e pajisjeve të dedikuara për shtypjen e pluhurit (p.sh. autobote me ujë ose depozita uji të montuara në kamionë).

Inspektorët mjedisorë do të kontrollojnë rregullisht zonat pranë fshatrave ose receptorëve të ndjeshëm gjatë kushteve të thata për të vlerësuar nevojën për masa shtesë. Nevoja për pajisje mbrojtëse respiratore për punëtorët do të vlerësohet nga stafi i Shëndetit dhe Sigurisë (HS) në përputhje me planet dhe procedurat përkatëse.

Seksioni 1.07 – Procedura për Kontrollin e Emetimeve në Ajër dhe Pluhurit

Qëllimi i këtij plani është të minimizojë ndikimet e mundshme të emetimeve në ajër mbi receptorët si rezultat i punimeve të ndërtimit. Plani i Menaxhimit të Emetimeve në Ajër dhe

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Pluhurit paraqet një përmbledhje të ndikimeve të mundshme mjedisore në cilësinë e ajrit, së bashku me masat parandaluese dhe menaxhuese për t’i shmangur ose reduktuar këto ndikime.

Burimet kryesore të emetimeve dhe ndotjes së ajrit janë emetimet difuze nga aktivitetet e punimeve në terren dhe transporti i materialeve dhe mbetjeve, të cilat mund të përmbajnë grimca të pezulluara ose pluhur. Receptorët potencialë përgjatë gjurmës përfshijnë banorët lokalë, bizneset dhe faunën.

Emetimet në ajër, zhurma dhe vibrimet mund të jenë shqetësuese dhe potencialisht të dëmshme për njerëzit dhe jetën e egër. Aktivitetet pranë zonave të banuara dhe receptorëve të ndjeshëm (p.sh. banesa individuale, objekte blegtorale, etj.) mund të shkaktojnë shqetësime të përkohshme, ndërsa vibrimet mund të dëmtojnë ndërtesat dhe strukturat. Ky plan synon përputhshmërinë me kërkesat kontraktuale dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Kontrolli i emetimeve në ajër dhe pluhurit

Burimet kryesore të emetimeve në ajër përfshijnë gazrat e shkarkimit nga automjetet, pluhurin e ngritur nga lëvizja e mjeteve, gërmimet, si dhe nga transporti dhe shkarkimi i zhavorrit dhe tokës. Disa aktivitete gjatë fazës së mirëmbajtjes mund të gjenerojnë përkohësisht sasi të vogla pluhuri, zhurme dhe ndotjeje të ajrit, ndërsa gjatë fazës së rehabilitimit nivelet e emetimeve mund të jenë më të larta.

Do të zbatohen procedurat e mëposhtme për kontrollin e pluhurit:

Uji do të jetë mjeti i vetëm për shtypjen e pluhurit gjatë periudhave kur gjenerohet pluhur i dukshëm.

Nëse teknikat standarde nuk janë efektive (p.sh. gjatë erërave të forta), aktivitetet mund të modifikohen për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve dhe publikut.

Spërkatje me ujë gjatë sezonit të thatë në zonat e punës dhe në rrugët e pashtuara.

Përdorimi i ujit do të kontrollohet për të shmangur krijimin e pellgjeve, dëmtimin e terrenit nga mjetet, transportimin e baltës në rrugë ose sedimentimin në trupat ujorë.

Pajisjet e ndërtimit do të mirëmbahen në gjendje të mirë pune dhe do të pajisen me silenciatorë funksionalë.

Procedurat e prokurimit dhe mirëmbajtjes

Të gjitha mjetet do të mirëmbahen në mënyrë që emetimet e tyre të mos shkaktojnë shqetësime për punëtorët apo komunitetin lokal.

Pajisjet do të jenë të pajisura me sisteme për reduktimin e emetimeve sipas specifikimeve të prodhuesit.

Mirëmbajtja rutinë do të sigurojë që mjetet të jenë të sigurta dhe me emetime minimale.

Kontraktori do të mbajë një regjistër të të gjitha mjeteve në kantier, përfshirë inspektimet dhe mirëmbajtjen.

Pajisjet që shkaktojnë ndotje të konsiderueshme (p.sh. emetime të dukshme të tepërta) do të hiqen nga përdorimi deri në riparim.

Masat për komunitetin përreth

Komunitetet që mund të ndikohen nga pluhuri ose zhurma do të informohen për aktivitetet.

Do të vendosen kufizime të përshtatshme të shpejtësisë në fshatra dhe zona të banuara për të reduktuar pluhurin dhe zhurmën.

Vegjetacioni i pastruar do të përdoret, kur është e mundur, për kontrollin e pluhurit.

Pajisjet do të mirëmbahen për të kufizuar emetimet; çdo pajisje me emetime të tepërta do të hiqet nga përdorimi.

Do të vendosen tabela për kufizimin e shpejtësisë në rrugët e pashtruara të projektit dhe kamionët që transportojnë materiale pluhur-formuese do të mbulohen.

Shpejtësia e mjeteve do të kufizohet në 30 km/orë në rrugët e pashtruara dhe lëvizja do të kufizohet në korridoret e përcaktuara të qarkullimit.

Parandalimi i ndotjes – Emetimet në ajër

Aktivitetet e projektit mund të ndikojnë potencialisht në cilësinë e ajrit përmes:

Automjeteve, pajisjeve dhe makinerive;

Pastrimit të kanaleve dhe strukturave të drenazhimit;

Depozitimit të materialeve (p.sh. nëntokë dhe agregate të ndryshme);

Kontrollit të vegjetacionit;

Transportit të materialeve tokësore dhe agregateve;

Periudhës së rehabilitimit, gjatë së cilës sipërfaqja e servitutit mbetet e ekspozuar ndaj shtresës së sipërme të tokës deri në rivendosjen e vegjetacionit.

Kërkesat minimale për Kontraktorin për menaxhimin e emetimeve në ajër nga burime pikësore dhe jo-pikësore përfshijnë:

Automjetet, pajisjet dhe makineritë;

Ekspozimin e tokës gjatë punimeve;

Transportin dhe depozitimin e materialeve;

Ekspozimin e shtresës së sipërme gjatë rehabilitimit.

Procedura për kufizimin e punës bosh (idling) të mjeteve do të zbatohet sa më shumë që të jetë e mundur:

Pajisjet me naftë që nuk janë në përdorim aktiv do të fikën;

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Motorët e kamionëve në pritje do të fiken nëse qëndrojnë ndezur më shumë se 5 minuta;

Të gjitha automjetet e lehta do të fiken kur nuk janë në përdorim.

Pompat dhe gjeneratorët do të vendosen larg zonave të akomodimit dhe sa më larg të jetë e mundur nga banesat për të minimizuar ndikimet të punëtorët dhe komuniteti. Çdo pajisje që shkakton ndotje të konsiderueshme (me emetime të dukshme të tepërta) do të hiqet nga përdorimi dhe do të servisohet. Ajo nuk do të përdoret derisa të jetë riparuar ose zëvendësuar. Mirëmbajtja rutinë do të kryhet nga ekipi përkatës për të siguruar minimizimin e emetimeve.

Parandalimi i ndotjes – Emetimi i pluhurit

Në kushte të thata, kur pluhuri bëhet shqetësim, masat zbutëse do të menaxhohen nga Menaxheri i Kantierit dhe përfshijnë:

Lagjen e grumbujve të materialeve, rrugëve dhe burimeve të tjera të pluhurit, veçanërisht në distanca <200 m nga zonat e banuara;

Mbulimin e materialeve dhe depozitave për të reduktuar shpërndarjen e pluhurit;

Njoftimin paraprak të bashkive për aktivitetet që gjenerojnë shumë pluhur;

Përdorimin e pajisjeve të dedikuara për shtypjen e pluhurit (p.sh. autobote me ujë ose depozita uji të montuara në kamionë).

Inspektorët mjedisorë do të kontrollojnë rregullisht zonat pranë fshatrave ose receptorëve të ndjeshëm gjatë kushteve të thata për të vlerësuar nevojën për masa shtesë. Nevoja për pajisje mbrojtëse respiratore për punëtorët do të vlerësohet nga stafi i Shëndetit dhe Sigurisë (HS) në përputhje me planet dhe procedurat përkatëse.

Seksioni 1.06 – Procedura për Kontrollin e Emetimeve në Ajër dhe Pluhurit

Qëllimi i këtij plani është të minimizojë ndikimet e mundshme të emetimeve në ajër mbi receptorët si rezultat i punimeve të ndërtimit. Plani i Menaxhimit të Emetimeve në Ajër dhe Pluhurit paraqet një përmbledhje të ndikimeve të mundshme mjedisore në cilësinë e ajrit, së bashku me masat parandaluese dhe menaxhuese për t'i shmangur ose reduktuar këto ndikime.

Burimet kryesore të emetimeve dhe ndotjes së ajrit janë emetimet difuze nga aktivitetet e punimeve në terren dhe transporti i materialeve dhe mbetjeve, të cilat mund të përmbajnë grimca të pezulluara ose pluhur. Receptorët potencialë përgjatë gjurmës përfshijnë banorët lokalë, bizneset dhe faunën.

Emetimet në ajër, zhurma dhe vibrimet mund të jenë shqetësuese dhe potencialisht të dëmshme për njerëzit dhe jetën e egër. Aktivitetet pranë zonave të banuara dhe receptorëve të ndjeshëm (p.sh. banesa individuale, objekte blektorale, etj.) mund të shkaktojnë shqetësime të përkohshme, ndërsa vibrimet mund të dëmtojnë ndërtesat dhe strukturat. Ky plan synon përputhshmërinë me kërkesat kontraktuale dhe legjisllacionin shqiptar në fuqi.

Kontrolli i emetimeve në ajër dhe pluhurit

Burimet kryesore të emetimeve në ajër përfshijnë gazrat e shkarkimit nga automjetet, pluhurin e ngritur nga lëvizja e mjeteve, gërmimet, si dhe nga transporti dhe shkarkimi i zhavorrit dhe tokës. Disa aktivitete gjatë fazës së mirëmbajtjes mund të gjenerojnë përkohësisht sasi të vogla pluhuri, zhurme dhe ndotjeje të ajrit, ndërsa gjatë fazës së rehabilitimit nivelet e emetimeve mund të jenë më të larta.

Do të zbatohen procedurat e mëposhtme për kontrollin e pluhurit:

Uji do të jetë mjeti i vetëm për shtypjen e pluhurit gjatë periudhave kur gjenerohet pluhur i dukshëm.

Nëse teknikat standarde nuk janë efektive (p.sh. gjatë erërave të forta), aktivitetet mund të modifikohen për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve dhe publikut.

Spërkatje me ujë gjatë sezonit të thatë në zonat e punës dhe në rrugët e pashtruara.

Përdorimi i ujit do të kontrollohet për të shmangur krijimin e pellgjeve, dëmtimin e terrenit nga mjetet, transportimin e baltës në rrugë ose sedimentimin në trupat ujorë.

Pajisjet e ndërtimit do të mirëmbahen në gjendje të mirë pune dhe do të pajisen me silenciatorë funksionalë.

Procedurat e prokurimit dhe mirëmbajtjes

Të gjitha mjetet do të mirëmbahen në mënyrë që emetimet e tyre të mos shkaktojnë shqetësime për punëtorët apo komunitetin lokal.

Pajisjet do të jenë të pajisura me sisteme për reduktimin e emetimeve sipas specifikimeve të prodhuesit.

Mirëmbajtja rutinë do të sigurojë që mjetet të jenë të sigurta dhe me emetime minimale.

Kontraktori do të mbajë një regjistër të të gjitha mjeteve në kantier, përfshirë inspektimet dhe mirëmbajtjen.

Pajisjet që shkaktojnë ndotje të konsiderueshme (p.sh. emetime të dukshme të tepërta) do të hiqen nga përdorimi deri në riparim.

Masat për komunitetin përreth

Komunitetet që mund të ndikohen nga pluhuri ose zhurma do të informohen për aktivitetet.

Do të vendosen kufizime të përshtatshme të shpejtësisë në fshatra dhe zona të banuara për të reduktuar pluhurin dhe zhurmën.

Vegjetacioni i pastruar do të përdoret, kur është e mundur, për kontrollin e pluhurit.

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Pajisjet do të mirëmbahen për të kufizuar emetimet; çdo pajisje me emetime të tepërta do të hiqet nga përdorimi.

Do të vendosen tabela për kufizimin e shpejtësisë në rrugët e pashtruara të projektit dhe kamionët që transportojnë materiale pluhur-formuese do të mbulohen.

Shpejtësia e mjeteve do të kufizohet në 30 km/orë në rrugët e pashtruara dhe lëvizja do të kufizohet në korridoret e përcaktuara të qarkullimit.

Parandalimi i ndotjes – Emetimet në ajër

Aktivitetet e projektit mund të ndikojnë potencialisht në cilësinë e ajrit përmes:

Automjeteve, pajisjeve dhe makinerive;

Pastrimit të kanaleve dhe strukturave të drenazhimit;

Depozitimit të materialeve (p.sh. nëntokë dhe agregate të ndryshme);

Kontrollit të vegjetacionit;

Transportit të materialeve tokësore dhe agregateve;

Periudhës së rehabilitimit, gjatë së cilës sipërfaqja e servitutit mbetet e ekspozuar ndaj shtresës së sipërme të tokës deri në rivendosjen e vegjetacionit.

Kërkesat minimale për Kontraktorin për menaxhimin e emetimeve në ajër nga burime pikësore dhe jo-pikësore përfshijnë:

Automjetet, pajisjet dhe makineritë;

Ekspozimin e tokës gjatë punimeve;

Transportin dhe depozitimin e materialeve;

Ekspozimin e shtresës së sipërme gjatë rehabilitimit.

Procedura për kufizimin e punës bosh (idling) të mjeteve do të zbatohet sa më shumë që të jetë e mundur:

Pajisjet me naftë që nuk janë në përdorim aktiv do të fikën;

Motorët e kamionëve në pritje do të fikën nëse qëndrojnë ndezur më shumë se 5 minuta;

Të gjitha automjetet e lehta do të fikën kur nuk janë në përdorim.

Pompat dhe gjeneratorët do të vendosen larg zonave të akomodimit dhe sa më larg të jetë e mundur nga banesat për të minimizuar ndikimet te punëtorët dhe komuniteti. Çdo pajisje që shkakton ndotje të konsiderueshme (me emetime të dukshme të tepërta) do të hiqet nga përdorimi dhe do të servisohet. Ajo nuk do të përdoret derisa të jetë riparuar ose zëvendësuar. Mirëmbajtja rutinë do të kryhet nga ekipi përkatës për të siguruar minimizimin e emetimeve.

Parandalimi i ndotjes – Emetimi i pluhurit

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Në kushte të thata, kur pluhuri bëhet shqetësim, masat zbutëse do të menaxhohen nga Menaxheri i Kantierit dhe përfshijnë:

Lagjen e grumbujve të materialeve, rrugëve dhe burimeve të tjera të pluhurit, veçanërisht në distanca <200 m nga zonat e banuara;

Mbulimin e materialeve dhe depozitave për të reduktuar shpërndarjen e pluhurit;

Njoftimin paraprak të bashkive për aktivitetet që gjenerojnë shumë pluhur;

Përdorimin e pajisjeve të dedikuara për shtypjen e pluhurit (p.sh. autobote me ujë ose depozita uji të montuara në kamionë).

Inspektorët mjedisorë do të kontrollojnë rregullisht zonat pranë fshatrave ose receptorëve të ndjeshëm gjatë kushteve të thata për të vlerësuar nevojën për masa shtesë. Nevoja për pajisje mbrojtëse respiratore për punëtorët do të vlerësohet nga stafi i Shëndetit dhe Sigurisë (HS) në përputhje me planet dhe procedurat përkatëse.

Seksioni 1.08 – Procedura për Kontrollin e Emetimeve në Ajër dhe Pluhurit

Qëllimi i këtij plani është të minimizojë ndikimet e mundshme të emetimeve në ajër mbi receptorët si rezultat i punimeve të ndërtimit. Plani i Menaxhimit të Emetimeve në Ajër dhe Pluhurit paraqet një përmbledhje të ndikimeve të mundshme mjedisore në cilësinë e ajrit, së bashku me masat parandaluese dhe menaxhuese për t'i shmangur ose reduktuar këto ndikime.

Burimet kryesore të emetimeve dhe ndotjes së ajrit janë emetimet difuze nga aktivitetet e punimeve në terren dhe transporti i materialeve dhe mbetjeve, të cilat mund të përmbajnë grimca të pezulluara ose pluhur. Receptorët potencialë përgjatë gjurmës përfshijnë banorët lokalë, bizneset dhe faunën.

Emetimet në ajër, zhurma dhe vibrimet mund të jenë shqetësuese dhe potencialisht të dëmshme për njerëzit dhe jetën e egër. Aktivitetet pranë zonave të banuara dhe receptorëve të ndjeshëm (p.sh. banesa individuale, objekte blegtorale, etj.) mund të shkaktojnë shqetësime të përkohshme, ndërsa vibrimet mund të dëmtojnë ndërtesat dhe strukturat. Ky plan synon përputhshmërinë me kërkesat kontraktuale dhe legjislativën shqiptarë në fuqi.

Kontrolli i emetimeve në ajër dhe pluhurit

Burimet kryesore të emetimeve në ajër përfshijnë gazrat e shkarkimit nga automjetet, pluhurin e ngritur nga lëvizja e mjeteve, gërmimet, si dhe nga transporti dhe shkarkimi i zhavorrit dhe tokës. Disa aktivitete gjatë fazës së mirëmbajtjes mund të gjenerojnë përkohësisht sasi të vogla pluhuri, zhurme dhe ndotjeje të ajrit, ndërsa gjatë fazës së rehabilitimit nivelet e emetimeve mund të jenë më të larta.

Do të zbatohen procedurat e mëposhtme për kontrollin e pluhurit:

Uji do të jetë mjete i vetëm për shtypjen e pluhurit gjatë periudhave kur gjenerohet pluhur i dukshëm.

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Nëse teknikat standarde nuk janë efektive (p.sh. gjatë erërave të forta), aktivitetet mund të modifikohen për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve dhe publikut.

Spërkatje me ujë gjatë sezonit të thatë në zonat e punës dhe në rrugët e pashtruara.

Përdorimi i ujit do të kontrollohet për të shmangur krijimin e pellgjeve, dëmtimin e terrenit nga mjetet, transportimin e baltës në rrugë ose sedimentimin në trupat ujorë.

Pajisjet e ndërtimit do të mirëmbahen në gjendje të mirë pune dhe do të pajisen me silenciatorë funksionalë.

Procedurat e prokurimit dhe mirëmbajtjes

Të gjitha mjetet do të mirëmbahen në mënyrë që emetimet e tyre të mos shkaktojnë shqetësime për punëtorët apo komunitetin lokal.

Pajisjet do të jenë të pajisura me sisteme për reduktimin e emetimeve sipas specifikimeve të prodhuesit.

Mirëmbajtja rutinë do të sigurojë që mjetet të jenë të sigurta dhe me emetime minimale.

Kontraktori do të mbajë një regjistër të të gjitha mjeteve në kantier, përfshirë inspektimet dhe mirëmbajtjen.

Pajisjet që shkaktojnë ndotje të konsiderueshme (p.sh. emetime të dukshme të tepërta) do të hiqen nga përdorimi deri në riparim.

Masat për komunitetin përreth

Komunitetet që mund të ndikohen nga pluhuri ose zhurma do të informohen për aktivitetet.

Do të vendosen kufizime të përshtatshme të shpejtësisë në fshatra dhe zona të banuara për të reduktuar pluhurin dhe zhurmën.

Vegjetacioni i pastruar do të përdoret, kur është e mundur, për kontrollin e pluhurit.

Pajisjet do të mirëmbahen për të kufizuar emetimet; çdo pajisje me emetime të tepërta do të hiqet nga përdorimi.

Do të vendosen tabela për kufizimin e shpejtësisë në rrugët e pashtruara të projektit dhe kamionët që transportojnë materiale pluhur-formuese do të mbulohen.

Shpejtësia e mjeteve do të kufizohet në 30 km/orë në rrugët e pashtruara dhe lëvizja do të kufizohet në korridoret e përcaktuara të qarkullimit.

Parandalimi i ndotjes – Emetimet në ajër

Aktivitetet e projektit mund të ndikojnë potencialisht në cilësinë e ajrit përmes:

Automjeteve, pajisjeve dhe makinerive;

Pastrimit të kanaleve dhe strukturave të drenazhimit;

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Depozitimit të materialeve (p.sh. nëntokë dhe agregate të ndryshme);

Kontrollit të vegjetacionit;

Transportit të materialeve tokësore dhe agregateve;

Periudhës së rehabilitimit, gjatë së cilës sipërfaqja e servitutit mbetet e ekspozuar ndaj shtresës së sipërme të tokës deri në rivendosjen e vegjetacionit.

Kërkesat minimale për Kontraktorin për menaxhimin e emetimeve në ajër nga burime pikësore dhe jo-pikësore përfshijnë:

Automjetet, pajisjet dhe makineritë;

Ekspozimin e tokës gjatë punimeve;

Transportin dhe depozitimin e materialeve;

Ekspozimin e shtresës së sipërme gjatë rehabilitimit.

Procedura për kufizimin e punës bosh (idling) të mjeteve do të zbatohet sa më shumë që të jetë e mundur:

Pajisjet me naftë që nuk janë në përdorim aktiv do të fikën;

Motorët e kamionëve në pritje do të fikën nëse qëndrojnë ndezur më shumë se 5 minuta;

Të gjitha automjetet e lehta do të fikën kur nuk janë në përdorim.

Pompat dhe gjeneratorët do të vendosen larg zonave të akomodimit dhe sa më larg të jetë e mundur nga banesat për të minimizuar ndikimet të punëtorët dhe komuniteti. Çdo pajisje që shkakton ndotje të konsiderueshme (me emetime të dukshme të tepërta) do të hiqet nga përdorimi dhe do të servisohet. Ajo nuk do të përdoret derisa të jetë riparuar ose zëvendësuar. Mirëmbajtja rutinë do të kryhet nga ekipi përkatës për të siguruar minimizimin e emetimeve.

Parandalimi i ndotjes – Emetimi i pluhurit

Në kushte të thata, kur pluhuri bëhet shqetësim, masat zbutëse do të menaxhohen nga Menaxheri i Kantierit dhe përfshijnë:

Lagjen e grumbujve të materialeve, rrugëve dhe burimeve të tjera të pluhurit, veçanërisht në distanca <200 m nga zonat e banuara;

Mbulimin e materialeve dhe depozitave për të reduktuar shpërndarjen e pluhurit;

Njoftimin paraprak të bashkive për aktivitetet që gjenerojnë shumë pluhur;

Përdorimin e pajisjeve të dedikuara për shtypjen e pluhurit (p.sh. autobote me ujë ose depozita uji të montuara në kamionë).

Inspektorët mjedisorë do të kontrollojnë rregullisht zonat pranë fshatrave ose receptorëve të ndjeshëm gjatë kushteve të thata për të vlerësuar nevojën për masa shtesë. Nevoja për pajisje

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

mbrojtëse respiratore për punëtorët do të vlerësohet nga stafi i Shëndetit dhe Sigurisë (HS) në përputhje me planet dhe procedurat përkatëse.

Seksioni 1.09 – Plani i Menaxhimit të Zhurmës dhe Vibrimeve

Qëllimi i këtij plani është të parandalojë, minimizojë dhe menaxhojë ndikimet negative të mundshme nga zhurma dhe vibrimet gjatë aktiviteteve të prishjes, rehabilitimit dhe ndërtimit. Plani zhvillohet në përputhje me PMMS dhe standardet mjedisore dhe sociale të Bankës Botërore (ESS1, ESS3, ESS4 dhe ESS8).

Plani adreson si zhurmën ajrore ashtu edhe vibrimet në tokë, duke marrë parasysh se aktivitetet si prishja, gërmimet, ngulja e pilotave (nëse aplikohet) dhe ngjeshja mund të ndikojnë receptorët përreth, përfshirë banesat, infrastrukturën komunitare dhe asetet e trashëgimisë kulturore si Kulla e Turanit.

Burimet kryesore të zhurmës dhe vibrimeve

Lëvizja e mjeteve dhe kamionëve;

Operimi i makinerive të rënda (eskavatorë, ngarkues, vinça);

Pajisjet për ngjeshje (rula, kompaktorë);

Kompresorë, gjeneratorë dhe çekiçë pneumatikë;

Prishja e urës ekzistuese, përfshirë betonin e armuar;

Punimet në shtrat lumi dhe përgatitja e themeleve.

Zhurma nga transporti është zakonisht e përkohshme, por mund të shkaktojë shqetësime lokale. Ndikimet më të mëdha priten nga makineritë dhe aktivitetet e prishjes.

Objektivat e planit

Minimizimi i shqetësimeve për komunitetin dhe receptorët e ndjeshëm;

Parandalimi i dëmtimeve në ndërtesa dhe objekte kulturore nga vibrimet;

Sigurimi i përputhshmërisë me standardet kombëtare dhe praktikën ndërkombëtare;

Vendosja e procedurave për monitorim dhe reagim.

Receptorët e ndjeshëm

Përfshijnë:

Banesa dhe familje rurale pranë punimeve;

Kampet e punëtorëve;

Ferma blegtorale;

Infrastrukturë publike dhe përdorues të rrugës SH63;

Trashëgimia kulturore (veçanërisht Kulla e Turanit ~300 m);

Habitatet lumore dhe bregore;

Komunitetet përgjatë rrugëve të transportit.

Do të merret në konsideratë një distancë deri në 500 m nga kantieri. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ndërtesave të vjetra, periudhave ekologjike të ndjeshme dhe kushteve gjatë natës.

Monitorimi dhe menaxhimi i zhurmës dhe vibrimeve

Qasja e monitorimit

Monitorimi do të kryhet për të siguruar që nivelet të jenë brenda kufijve të pranueshëm. Vendndodhjet zgjidhen bazuar në afërsinë me receptorët, aktivitetet intensive dhe ankesat e komunitetit.

Monitorimi i zhurmës

Matje periodike me pajisje të kalibruara;

Monitorim gjatë ditës dhe natës;

Vëzhgime nga personeli në terren;

Fokus në aktivitetet intensive.

Monitorimi i vibrimeve

Matje me instrumente specifike (p.sh. PPV – shpejtësia maksimale e grimcave);

Prioritet zonave pranë strukturave të ndjeshme, sidomos Kulla e Turanit;

Vendosje e kufijve të pranueshëm sipas standardeve dhe praktikave më të mira për të parandaluar dëmtime strukturore ose shqetësime.

Masat e Menaxhimit

Përzgjedhja e pajisjeve me nivel të ulët zhurme dhe vibrimi, kur është e mundur;

Mirëmbajtja e rregullt e makinerive për të shmangur zhurmat dhe vibrimet e tepërta;

Kufizimi i aktiviteteve me zhurmë dhe vibrime të larta gjatë orëve të ditës;

Shmangia, kur është e mundur, e operimit të njëkohshëm të disa pajisjeve me ndikim të lartë;

Përdorimi i barrierave fizike ose zonave mbrojtëse, kur është praktikisht e mundur;

Zbatimi i teknikave të kontrolluara të prishjes për reduktimin e vibrimeve;

Planifikimi dhe orientimi i lëvizjes së mjeteve për të minimizuar shqetësimet.

Mekanizmi i Ankesave dhe Reagimit

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Të gjitha ankesat lidhur me zhurmën dhe vibrimet do të regjistrohen dhe menaxhohen përmes Mekanizmit të Trajtimit të Ankesave të Projektit:

Ankesat do t'i drejtohen menjëherë Menaxherit të Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit të Kontraktorit;

Do të ndërmerren menjëherë masa fillestare dhe korigjuese;

Kur është e nevojshme, do të kryhen monitorime dhe hetime shtesë;

Veprimet pasuese do t'i komunikohen ankuesit;

Problemet e vazhdueshme ose të pazgjidhura do të çojnë në rishikimin e metodave të ndërtimit dhe zbatimin e masave shtesë.

Menaxhimi Adaptiv

Plani ndjek një qasje adaptive. Në rast se rezultatet e monitorimit ose ankesat tregojnë tejkalime të kufijve ose ndikime të papranueshme, do të ndërmerren masa korigjuese, përfshirë ndryshimin e metodave të punës, masa shtesë kontrolli ose pezullimin e përkohshëm të aktiviteteve specifike.

Kjo qasje e integruar siguron që ndikimet nga zhurma dhe vibrimet të menaxhohen në mënyrë efektive gjatë gjithë fazës së ndërtimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mirëqenies së komunitetit, integritetit strukturor të objekteve përreth dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Seksioni 1.10 – Plani i Menaxhimit të Burimeve Ujore

Kontraktori do të hartojë një Plan të Menaxhimit të Burimeve Ujore si pjesë e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (K- PMMS).

Objektivi

Qëllimi i këtij plani është të minimizojë ndikimet e mundshme mbi burimet ujore dhe receptorët përkatës si rezultat i punimeve të ndërtimit. Receptorët potencialë përfshijnë ujërat sipërfaqësore (lumenj, përrenj, kanale kulluese, pellgje), ujërat nëntokësore dhe përdoruesit e tyre, si dhe florën dhe faunën përkatëse.

Gjatë zbatimit të projektit, Kontraktori do të identifikojë edhe zona shtesë pune (rrugë transporti, kampe ndërtimi, zona huazimi agregatesh), të cilat mund të paraqesin rrezik për receptorët e ndjeshëm ujore për shkak të afërsisë.

Para fillimit të punimeve, Kontraktori do të dakordësojë me autoritetin e pavarur mjedisor masat specifike zbutëse për këto zona.

Mbrojtja dhe menaxhimi i trupave ujorë

Lumenjtë dhe përrenjtë

Në kalimet e trupave ujorë do të zbatohen masat e mëposhtme:

Rindërtimi i urave do të projektohet sa më pingul me drejtimin e rrjedhës;

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Kur rruga është paralele me një trup ujqor, do të ruhet një distancë minimale prej 5 m me terren natyror të pandisturbur;

Uji nga gropat e punës do të shkarkohet në mënyrë të kontrolluar dhe i filtruar (p.sh. me basene sedimentimi);

Do të zbatohet sistemi “leje për pompim” me miratim nga specialistët mjedisorë;

Materialet e gërmimeve do të depozitohen brenda korridorit të ndërtimit;

Do të vendosen barriera sedimentesh përpara fillimit të punimeve;

Do të zbatohen masa të përkohshme për kontrollin e erozionit dhe sedimenteve;

Kohëzgjatja e punimeve në këto zona do të minimizohet për të reduktuar ndikimet.

Masat për kontrollin e erozionit dhe sedimenteve

Aktivitetet do të planifikohen për të minimizuar sipërfaqet e disturbura;

Punimet do të kufizohen brenda zonës së përcaktuar të rrugës;

Rrjedhjet sipërfaqësore do të devijohen për të reduktuar erozionin;

Do të përdoren masa për shpërndarjen dhe kontrollin e rrjedhjeve (p.sh. barriera sedimentesh);

Do të arrihet stabilizim i kënaqshëm përmes masave gjeoteknike;

Shtresa e sipërme e tokës do të mbrohet për të shmangur erozionin;

Stabilizimi përfundimtar i tokës do të kryhet sa më shpejt të jetë e mundur.

Kontraktori do të kryejë skarifikimin e nëntokës deri në 60 cm në zonat e ngjeshura për të përmirësuar ajrosjen dhe lagështinë, veçanërisht në tokat bujqësore.

Masa të tjera

Pastrimi i zonave të punës nga materiale të huaja dhe mbetje;

Heqja e të gjitha materialeve në kalimet e ujërave për të mos penguar rrjedhën;

Mosvendosja e materialeve në zona ku është rikthyer shtresa e sipërme e tokës.

Masat e përgjithshme për kalimet e trupave ujorë

Ruajtja e zonave tampon prej 10 m me vegjetacion natyror;

Vendosja e masave të kontrollit të sedimenteve në rrjedhën poshtë;

Shmangia e bllokimit ose ndryshimit të rrjedhës së ujit;

Kryerja e nivelimeve për të lejuar kalimin pa penguar rrjedhën;

Rikthimi i gjendjes natyrore sa më shpejt që të jetë e mundur.

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Metoda të ndryshme do të përdoren për të ruajtur rrjedhën e ujit gjatë punimeve. Menaxheri i Kantierit, në bashkëpunim me specialistin mjedisor, do të zgjedhë metodën më të përshtatshme për çdo rast, në varësi të kushteve konkrete.

Larja e mjeteve dhe pajisjeve

Mjetet dhe pajisjet do të lahen në shërbime larjeje përgjatë segmenteve rrugore ku zhvillohen punimet. Në rast se larja kryhet në kampin e kantierit, ajo do të bëhet në një zonë të dedikuar për larjen e mjeteve. Kjo zonë do të jetë e kufizuar dhe e projektuar në mënyrë që ujërat e larjes të kullojnë drejt një sipërfaqeje të niveluar.

Për larjen e mjeteve do të përdoret vetëm ujë (pa detergjentë apo substanca të tjera shtesë). Ndalohet hyrja e mjeteve dhe pajisjeve në trupat ujqorë, përveç rasteve kur kjo është e pashmangshme (p.sh. gjatë punimeve për kalime të hapura në trupat ujqorë).

Seksioni 1.09 – Plani për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Derdhjeve (Spill Prevention and Response Plan – SPRP)

Objektivi dhe qëllimet

Kontraktori ka hartuar një Plan për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Derdhjeve (SPRP), i cili është pjesë integrale e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social. Niveli i reagimit ndaj derdhjeve do të varet nga natyra dhe madhësia e tyre, duke përdorur një qasje të shkallëzuar (tiered approach) me kategorizim të qartë sipas ashpërsisë së incidentit.

Qëllimi i këtij plani është të përcaktojë mënyrën se si Kontraktori do të zbatojë masat për parandalimin e ndotjes në tokë nga burime të ndryshme gjatë aktiviteteve të projektit, si dhe të përshkruajë procedurat e reagimit dhe emergjencës në rast incidentesh.

Seksioni 1.11 Shëndeti dhe siguria në punë dhe menaxhimi i fuqisë punëtore

Ky seksion përcakton kërkesat për menaxhimin e fuqisë punëtore dhe kushteve të punës për nën-projektin e urës së Turanit, në përputhje me Standardin Mjedisor dhe Social 2 (SMS2) të Bankës Botërore, Procedurat e Menaxhimit të Punës (PMP) në nivel programi të përgatitura në kuadër të programit për ndërtimin e urave rezistente, si dhe legjislacionin kombëtar të zbatueshëm të punës. Të gjitha dispozitat e PMP zbatohen plotësisht për këtë nën-projekt dhe janë detyruese për kontraktorin dhe të gjithë nënkontraktorët. Këto kërkesa përbëjnë një pjesë përbërëse të Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Kontraktorit (PMMSK).

Karakteristikat e fuqisë punëtore

Fuqia punëtore e projektit pritet të përbëhet kryesisht nga punëtorë të kontraktuar dhe nënkontraktuar, duke përfshirë punëtorë të kualifikuar dhe të pakualifikuar, staf teknik, operatorë pajisjesh dhe personel mbikëqyrës. Nuk parashikohen punonjës të drejtpërdrejtë apo punonjës nga komuniteti. Punëtorët pritet të jenë kryesisht vendas ose kombëtarë dhe nuk pritet një fluks i konsiderueshëm i fuqisë punëtore.

Rreziqet për shëndetin dhe sigurinë në punë

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Aktivitetet e ndërtimit përfshijnë prishjen e urës ekzistuese, gërmime, operacione ngritjeje, punë në lartësi, punë në hapësira të kufizuara dhe punime në lumë. Këto aktivitete paraqesin rreziqe të shtuara për shëndetin dhe sigurinë në punë, përfshirë rrezikun e rënieve, goditjeve nga objekte, aksidenteve të lidhura me makineritë, mbytjes, si dhe ekspozimit ndaj pluhurit, zhurmës dhe dridhjeve. Edhe pse këto rreziqe janë të natyrshme për llojin e punimeve, ato mund të menaxhohen përmes planifikimit të strukturuar, trajnimit, përdorimit të pajisjeve dhe veshjeve të përshtatshme mbrojtëse, zbatimit të procedurave të shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe mbikëqyrjes.

Masat për shëndetin dhe sigurinë në punë

Në përputhje me SMS2, PMP-në dhe Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë, Kontraktori duhet të:

Të përgatisë dhe zbatojë një plan specifik për shëndetin dhe sigurinë në punë në kantier, si pjesë e PMMSK-së, përpara fillimit të punimeve;

Të zhvillojë trajnime të detyrueshme hyrëse për shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punëtorët përpara hyrjes në kantier, si dhe trajnime rifreskuese sipas nevojës;

Të sigurojë dhe të zbatojë në mënyrë strikte përdorimin e Pajisjeve Personale Mbrojtëse (PPM), përfshirë helmetat, veshjet me dukshmëri të lartë, këpucët e sigurisë, dorezat, syze mbrojtëse dhe sistemet e mbrojtjes nga rrëzimi kur është e nevojshme;

Të zbatojë procedura të sigurta pune dhe metoda pune për aktivitetet me rrezik të lartë, përfshirë prishjet, operacionet e ngritjes, punën në lartësi, hapësirat e kufizuara dhe punimet në lumë;

Të mirëmbajë ambientet e ndihmës së parë, personel të trajnuar për ndihmën e parë dhe procedura të qarta të ndërhyrjes emergjente, përfshirë masat e shpëtimit për punimet në lumë; dhe

Të regjistrojë, hetojë dhe raportojë të gjitha aksidentet, incidentet dhe situata të rrezikshme pa pasoja, si dhe të zbatojë masa korrigjuese për të parandaluar përsëritjen e tyre.

Procedurat e Menaxhimit të Punës

Kontraktori duhet të zbatojë Procedurat e Menaxhimit të Punës në përputhje me SMS2 dhe PMP-në në nivel programi, duke përfshirë:

Kushte dhe terma të qarta të punësimit, kontrata me shkrim dhe përputhje me legjislacionin kombëtar të punës;

Respektimi i të drejtave të punëtorëve, mosdiskriminimi dhe mundësi të barabarta;

Standarde të përshtatshme për akomodimin e punëtorëve, kur është e aplikueshme; dhe

Krijimi dhe funksionimi i një mekanizmi të ankesave të dedikuar për punëtorët, i aksesueshëm për të gjithë punëtorët dhe nënkontraktorët, që lejon ankesa anonime, pa frikë nga hakmarrja dhe me afate të përcaktuara për zgjidhje.

Kodi i Sjelljes

Të gjithë punëtorët e angazhuar në nën-projektin e urës së Turanit duhet të respektojnë një Kod Sjelljeje, i cili duhet të nënshkruhet përpara punësimit, të komunikohet në një gjuhë të kuptueshme për fuqinë punëtore dhe të zbatohet përmes masave disiplinore kontraktuale. Kodi i Sjelljes ndalon në mënyrë të qartë shfrytëzimin dhe abuzimin seksual, ngacmimin seksual, dhunën me bazë gjinore, punën e fëmijëve, punën e detyruar, sjelljen diskriminuese, frikësimin dhe përdorimin e substancave në kantier.

Parandalimi dhe ndërgjegjësimi për shfrytëzimin dhe abuzimin seksual / ngacmimin seksual

Megjithëse nuk janë identifikuar flukse të konsiderueshme të fuqisë punëtore apo kushte me rrezik të lartë, rreziqet për shfrytëzim dhe abuzim seksual / ngacmim seksual do të trajtohen në mënyrë proaktive në përputhje me SMS2 dhe SMS4. Kontraktori duhet të ofrojë trajnime të detyrueshme ndërgjegjësuese, të afishojë informacione mbi sjelljen e pranueshme dhe mekanizmat e raportimit, të sigurojë trajtim konfidencial të ankesave në përputhje me parimet e përqendruara te viktimat, si dhe të zbatojë tolerancë zero për shkeljet e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual / ngacmimit seksual.

Rolet dhe Përgjegjësitë

Kontraktori

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e kërkesave të SMS2 dhe PMP-së në nivel kantieri;

Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (SHSP), Procedurave të Menaxhimit të Punës, Kodit të Sjelljes, masave për shkeljet e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual / ngacmimit seksual dhe mekanizmat të ankesave të punëtorëve;

Sigurimi që nënkontraktorët të jenë në përputhje me detyrimet e SMS2.

Inxhinieri Mbikëqyrës

Mbikëqyrje e përditshme dhe verifikim i përputhshmërisë së kontraktorit me kërkesat e SMS2;

Rishikimi dhe miratimi i metodave të punës që lidhen me SHSP;

Raportim i menjëhershëm i incidenteve serioze ose moszbatimit të ARA PIT.

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) – PIT

Mbikëqyrje e përgjithshme e zbatimit të SMS2;

Rishikimi i raporteve të monitorimit dhe njoftimeve për incidente;

Koordinimi me Bankën Botërore për incidente serioze ose moszbatim të përsëritur;

Autoriteti për të kërkuar masa korrigjuese ose pezullim të punimeve në rast shkeljesh serioze të SMS2.

Monitorimi dhe Raportimi

Përputhshmëria me SMS2 do të monitorohet përmes inspektimeve të rregullta në kantier, rishikimit të regjistrave të SHSP dhe të trajnimeve, si dhe raportimit periodik nga kontraktori. Aksidentet serioze, vdekjet ose incidentet e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual / ngacimit seksual duhet të raportohen menjëherë te ARA PIT dhe te Banka Botërore në përputhje me kërkesat e raportimit të incidenteve të Kornizës Mjedisore dhe Sociale (KMS).

Seksioni 1.12 – Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë së Komunitetit dhe Trafikut

Ky seksion përcakton masat e detyrueshme për menaxhimin e rreziqeve ndaj shëndetit dhe sigurisë së komunitetit që rrjedhin nga ndërtimi i Urës së Turanit, në përputhje me Standardin Mjedisor dhe Social 4 të Bankës Botërore (SMS4), Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social në nivel programi (KMMS), si dhe Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë. Masat lidhur me komunikimin me palët e interesuara dhe menaxhimin e ankesave janë gjithashtu në përputhje me SMS10.

Ura e Turanit është një rrugë lokale kritike e aksesit. Trafiku i ndërtimit, aktivitetet e prishjes dhe përdorimi i makinerive të rënda rrisin rrezikun e aksidenteve, rreziqet për sigurinë e këmbësorëve dhe ndërprerjet e përkohshme të aksesit. Edhe pse ndikimet janë të përkohshme dhe të kthyeshme, ato janë të ndjeshme nga pikëpamja sociale për shkak të varësisë së komuniteteve lokale nga ura për lëvizjen e përditshme, aktivitetet bujqësore dhe aksesin në shërbimet thelbësore.

Grupet e mëposhtme janë identifikuar si veçanërisht të ndjeshëm ndaj ndikimeve të lidhura me ndërtimin:

Banorët lokalë dhe përdoruesit e rrugës;

Përdoruesit e tokave bujqësore dhe lëvizja e bagëtive;

Këmbësorët dhe çiklistët;

Rrugët e aksesit për shërbimet emergjente; dhe

Mjedisi më i gjerë i trashëgimisë kulturore.

Menaxhimi i Trafikut dhe Aksesit

Një Plan për Menaxhimin e Trafikut dhe Aksesit (PMTA) duhet të përgatitet dhe të zbatohet nga kontraktori si pjesë e K- PMMS -së, përpara fillimit të punimeve. PMTA-ja duhet të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar për sigurinë rrugore, rregulloret zbatuese të Kodit Rrugor dhe Manualin e Sinjalistikës Rrugore.

Në përputhje me Raportin e Skrenimit, ura ekzistuese duhet të mbetet funksionale gjatë ndërtimit të urës së re për të siguruar akses të pandërprerë për banorët, përdoruesit bujqësorë dhe shërbimet emergjente.

Kur kufizimet e përkohshme ose mbylljet afatshkurtra janë të pashmangshme, kontraktori duhet:

T’i planifikojë këto aktivitete paraprakisht dhe t’i kufizojë në orët me trafik të ulët;

Të krijojë devijime të sigurta të përkohshme ose qarkullim me një korsi të kontrolluar kur është e nevojshme;

Të koordinojë mbylljet me Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe autoritetet lokale; dhe

Të informojë komunitetet e prekura paraprakisht përmes kanaleve të përshtatshme të komunikimit.

Sinjalistika, Barriera dhe Kontrolli i Shpejtësisë

Për të garantuar sigurinë e trafikut dhe këmbësorëve, PMTA duhet të përfshijë:

Vendosjen e sinjalistikës paralajmëruese dhe drejtuese të qartë, të dukshme dhe të pozicionuar në mënyrë të përshtatshme përpara zonës së punimeve;

Barriera fizike, rrethime dhe ndarëse që izolojnë zonat e ndërtimit nga rrugët publike dhe rrugët e këmbësorëve;

Kufizim shpejtësie jo më shumë se 30 km/h brenda zonave të punimeve, me masa zbatimi;

Vendosjen e punonjësve të trajnuar për menaxhimin e trafikut në hyrje/dalje të kantierit dhe në zonat me rrezik të lartë;

Masa të përkohshme për qetësimin e trafikut kur është e nevojshme; dhe

Ndriçim të mjaftueshëm për dukshmëri gjatë natës, duke shmangur ndotjen e panevojshme nga drita në zonat rezidenciale ose pranë lumit.

Të gjitha sinjalet, dritat dhe pajisjet e sigurisë duhet të instalohen dhe mirëmbahen në mënyrë të sigurt për t’i rezistuar kushteve të erës dhe trafikut, si dhe të vendosen në distanca të mjaftueshme për të siguruar paralajmërim të hershëm për përdoruesit e rrugës.

Akses i Komunitetit dhe Vazhdimësia e Trafikut

Gjatë fazës së ndërtimit, ura ekzistuese mbi lumin Dunavec do të funksionojë si kalimi kryesor i përkohshëm për të siguruar vazhdimësinë e aksesit për automjetet dhe këmbësorët. Kjo masë synon të minimizojë ndërprerjet sociale dhe të ruajë aksesin në shërbime, aktivitete ekonomike dhe rrugët e ndërhyrjes emergjente.

Pas përfundimit të urës së re, qarkullimi i trafikut do të riorganizohet në përputhje me projektin e miratuar, duke përfshirë përdorimin e rrethrotullimit dhe rrugëve të reja të aksesit që lidhin me Rrugën SH63. Do të vendosen sinjalistikë e përhershme e përshtatshme dhe shenja rrugore, si dhe komunitetet do të informohen paraprakisht për ndryshimet në mënyrën e aksesit.

Akses i Komunitetit dhe Vazhdimësia e Trafikut

Aksesi i komunitetit dhe vazhdimësia e trafikut do të ruhen gjatë gjithë periudhës së ndërtimit të Urës së Klosit përmes një skeme të planifikuar me kujdes të menaxhimit të trafikut. Devijimi

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

i përkohshëm i trafikut do të realizohet duke përdorur sistemin e propozuar të tombinove kuti (box culvert), duke siguruar lidhje të pandërprerë përgjatë korridorit SH6.

Do të zbatohen sinjalistikë e qartë rrugore, aktivitete ndërtimore të fazuara dhe kontroll i rrjedhës së trafikut për të minimizuar shqetësimet për përdoruesit e rrugës, banorët dhe ofruesit e shërbimeve. Aksesit në vendbanimet përreth, zonat e banuara dhe rrugët lokale do të mbetet i disponueshëm në çdo kohë, ndërsa do të merren masa për të garantuar kalimin e pandërprerë të automjeteve emergjente.

Në përgjithësi, projekti është projektuar për të siguruar lëvizje të sigurt dhe të besueshme, me ndikime vetëm të përkohshme dhe të menaxhueshme në kushtet e trafikut.

Do të vendosen sinjalistika të përshtatshme rrugore, markime rrugore dhe masa informuese për publikun për të informuar përdoruesit e rrugës mbi organizimet e përkohshme dhe të përhershme të trafikut. Anëtarët e komunitetit do të njoftohen paraprakisht për çdo ndryshim në rrugët e aksesit për të garantuar transparencë dhe për të reduktuar shqetësimet.

Këto masa janë në përputhje me ESS4 (Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit) dhe ESS10 (Angazhimi i Palëve të Interesuara dhe Publikimi i Informacionit), duke siguruar që rreziqet sociale të lidhura me lëvizshmërinë, aksesin dhe sigurinë të menaxhohen në mënyrë efektive gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit.

Përpara fillimit të punimeve, të gjitha tabelat rrugore duhet të përditësohen në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor dhe "Rregullores për Zbatimin e Kodit Rrugor", si dhe Manualit të Sinjalistikës Rrugore.

Pikat kryesore të sigurisë rrugore që do të përfshihen në projekt janë:

Menaxhimi i trafikut gjatë ndërtimit/rikonstruksionit.

Vendosja e sinjaleve paralajmëruese dhe informative.

Përdorimi i personave me flamuj për orientimin e trafikut.

Sigurimi i kalimit të sigurt të automjeteve dhe këmbësorëve gjatë kryerjes së punimeve.

Duke qenë se punimet zhvillohen në një rrugë me intensitet të lartë trafiku, veçanërisht të mjeteve të rënda, kontraktori duhet të vendosë personel për menaxhimin e trafikut në hyrje dhe dalje të kantierit.




Figura 10: Pajisje për menaxhimin e trafikut

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”



Figura 11: Disa nga tabelat dhe elementët e nevojshëm për sigurinë rrugore




Figura 12: Plani i Devijimit të Trafikut dhe Sinjalistika e Përkohshme

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”




Figura 13: Plani i Organizimit të Punimeve

Aksesi në Tokat Bujqësore dhe Shërbimet Lokale

Aktivitetet e ndërtimit do të planifikohen në mënyrë që të sigurojnë akses të vazhdueshëm në parcelat bujqësore, zonat e blegtorisë, pronat rezidenciale dhe shërbimet lokale.

Kur kufizimet e përkohshme të aksesit janë të pashmangshme, Kontraktori do të sigurojë:

- Rrugë alternative të shënuara qartë;
- Njoftim paraprak për përdoruesit e prekur;
- Rikthim të menjëhershëm të aksesit pas përfundimit të punimeve.
- Masat për Reduktimin e Shqetësimeve nga Ndërtimi
- Pluhuri dhe Cilësia e Ajrit
- Masat përfshijnë:
 - Spërkatje të rregullt me ujë;
 - Mbulimin e kamionëve;
 - Pastrim të menjëhershëm të derdhjeve;
 - Ndërprerjen e punimeve gjatë erërave të forta kur pluhuri nuk mund të kontrollohet.
 - Respektimi i këtyre masave do të verifikohet përmes inspektimeve të përditshme vizuale.
- Zhurma dhe Dridhjet

Masat përfshijnë:

- Kufizimin e punimeve me zhurmë gjatë orëve të ditës;
- Mirëmbajtjen e pajisjeve;
- Përdorimin e teknikave të kontrolluara të prishjes;
- Monitorimin e dridhjeve pranë receptorëve të ndjeshëm.

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

- Niveli i zhurmës pranë banesave më të afërta nuk duhet të kalojë 65 dB(A) gjatë ditës, ndërsa dridhjet duhet të mbeten nën 5 mm/s PPV në zonat e ndjeshme.
- Trafiku i Ndërtimit dhe Siguria Rrugore

Masat përfshijnë:

- Përdorimin e rrugëve të miratuara nga ARRSH;
- Angazhimin e personelit të trajnuar për drejtimin e trafikut;
- Ndarjen e trafikut të ndërtimit nga trafiku publik kur është e mundur;
- Zbatimin rigoroz të kufijve të shpejtësisë dhe praktikave të sigurta të drejtimit.
- Objektivi është **zero viktima ose lëndime serioze** të lidhura me trafikun e ndërtimit.

Rolet dhe Përgjegjësitë

Kontraktori

- Hartimi dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Trafikut dhe Aksesit;
- Menaxhimi i përditshëm i sigurisë së trafikut, pluhurit, zhurmës dhe dridhjeve;
- Reagimi i menjëhershëm ndaj shqetësimeve dhe ankesave të komunitetit.
- Inxhinieri Mbikëqyrës
- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Menaxhimit të Trafikut;
- Inspektime të rregullta në terren;
- Raportimi i mosrespektimeve tek ARRSH.

ARRSH PIT

- Mbikëqyrja e përgjithshme e masave të shëndetit dhe sigurisë së komunitetit;
- Koordinimi me autoritetet lokale dhe Bankën Botërore;
- E drejta për të kërkuar masa korrigjuese ose pezullimin e punimeve në rast shkeljesh serioze të ESS4.
- Menaxhimi i Ankesave dhe Komunikimi
- Shqetësimet e komunitetit lidhur me shëndetin, sigurinë, trafikun dhe aksesin do të trajtohen përmes Mekanizmit të Menaxhimit të Ankesave të projektit.

Ky mekanizëm do të jetë:

- I aksesueshëm;
- Falas;
- I komunikuar publikisht përpara fillimit të punimeve;
- I aftë të zgjidhë ankesat brenda afateve të përcaktuar

Seksioni 1.13 – Plani i Menaxhimit të Trafikut

Plani i Menaxhimit të Trafikut (TMP) është përgatitur si një instrument specifik për kantierin, në përputhje me Kornizën Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore, veçanërisht me:

- ESS1 – Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale;

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

- ESS2 – Kushtet e Punës dhe Punonjësit;
- ESS4 – Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit;
- ESS10 – Angazhimi i Palëve të Interesuara dhe Publikimi i Informacionit.

TMP është në përputhje me Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMF) dhe synon të parandalojë, minimizojë dhe menaxhojë rreziqet dhe shqetësimet që lidhen me trafikun gjatë aktiviteteve të ndërtimit.

Objektivi kryesor i TMP është të shmangë ose minimizojë ndërprerjet e trafikut dhe rreziqet e sigurisë që vijnë nga:

- trafiku i mjeteve të ndërtimit;
- mbylljet e përkohshme të rrugëve;
- ndryshimet në skemat e qarkullimit.
- Njëkohësisht sigurohet mbrojtja e komuniteteve lokale, përdoruesve të rrugës dhe fuqisë punëtore.
- Plani zbatohet për të gjitha aktivitetet e ndërtimit dhe transportit, duke përfshirë lëvizjen e materialeve, pajisjeve dhe personelit gjatë gjithë fazës së ndërtimit.

Masat kryesore

Në përputhje me kërkesat e Bankës Botërore, TMP përcakton masat e mëposhtme:

Akses të sigurt dhe të qartë në kantier, duke përfshirë hyrjet dhe daljet e mjeteve të ndërtimit.

Përcaktimin e rrugëve të autorizuara për transportin e materialeve dhe kufizimin e lëvizjeve vetëm në korridoret e miratuara.

Parandalimin dhe minimizimin e vonesave në trafik përmes koordinimit me autoritetet lokale dhe përdorimit të devijimeve të përkohshme kur është e nevojshme.

Vendosjen e masave të përkohshme të kontrollit të trafikut si tabela, barriera, punonjës sinjalizues dhe semaforë.

Uljen e probabilitetit të aksidenteve dhe incidenteve rrugore.

Parandalimin dhe riparimin e dëmtimeve të rrugëve publike të shkaktuara nga aktivitetet e projektit.

TMP është një dokument dinamik dhe përditësohet rregullisht sipas metodologjive të ndërtimit dhe kërkesave të lëvizjes së mjeteve.

Përmbajtja e TMP

Plani përfshin:

- Organizimin e hyrje-daljeve në zonat e punës;
- Identifikimin e zonave të ndjeshme përgjatë rrugëve të aksesit;
- Identifikimin dhe ndërtimin e rrugëve të përkohshme të shërbimit;
- Masa për reduktimin e trafikut dhe bllokimeve;
- Masa për sigurinë e komunitetit dhe punëtorëve;

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

- Trajnimin e punonjësve për sigurinë rrugore;
- Kërkesat për aftësinë profesionale të drejtuesve të mjeteve;
- Procedurat e kontrollit dhe mirëmbajtjes së automjeteve;
- Planifikimin e aktiviteteve për të shmangur ndikimet kumulative në trafik;
- Përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive;
- Ndalimin e qarkullimit jashtë rrugëve të miratuara;
- Kufijtë e shpejtësisë dhe mënyrat e kontrollit të tyre;
- Informimin e komuniteteve dhe përdoruesve të rrugës;
- Procedurat e inspektimit, auditimit dhe raportimit.

Në përputhje me ESS10, TMP përfshin procedura për komunikim dhe konsultim me komunitetet dhe palët e interesuara.

Kontraktori do të bashkëpunojë me institucionet shtetërore dhe autoritetet lokale për të koordinuar masat e menaxhimit të trafikut dhe për të siguruar lejet përkatëse.

Do të zhvillohen konsultime me komunitetet e prekura për të identifikuar shqetësimet lokale dhe për të përcaktuar masat përkatëse të zbutjes, duke përfshirë njoftimin paraprak për çdo ndërprerje të përkohshme të trafikut.

Seksioni 1.14 – Plani i Menaxhimit të Peizazhit

Plani i Menaxhimit të Peizazhit (LMP) për nënprojektin e Urës së Klosit do të përgatitet si një instrument specifik për restaurimin dhe rehabilitimin e zonës, në përputhje me Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMF) të Programit “Building Resilient Bridges (BRB)”.

Objektivi i planit është të sigurojë rikthimin e rregullt të peizazhit dhe mjedisit vizual pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, me vëmendje të veçantë ndaj:

- zonave lumore;
- brigjeve të lumenjve;
- zonave anësore të rrugës.

LMP zbatohet në koordinim të ngushtë me:

- Planin e Kontrollit të Erozionit dhe Sedimenteve;
- Masat e biodiversitetit të përcaktuara në K- PMMS.

Kjo siguron një qasje të integruar për:

- stabilizimin e tokës;
- restaurimin e habitateve;
- integrimin vizual të urës së re në peizazhin përreth.

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Plani përcakton procedurat, masat zbutëse dhe kërkesat e monitorimit gjatë:

- fazës para ndërtimit;
- fazës së ndërtimit;
- fazës së rehabilitimit;
- fazës së hershme të operimit.

Gjatë ndërtimit mund të ketë ndikime të përkohshme vizuale dhe peizazhore për shkak të:

- pastrimit të vegjetacionit;
- gërmimeve;
- shembjes së urës ekzistuese;
- pranisë së makinerive;
- rrugëve të përkohshme të aksesit;
- depozitimit të materialeve;
- gardheve dhe objekteve të kantierit.

Këto ndikime konsiderohen lokale dhe të rikthyeshme.

Për këtë arsye do të hartohet dhe zbatohet një Plan Restaurimi dhe Peizazhimi si pjesë e K-PMMS.

Ky plan do të përcaktojë metodologjinë dhe rendin e rehabilitimit të:

- brigjeve të lumit;
- argjinaturave;
- rrugëve të përkohshme;
- zonave të punës.

Masat e restaurimit do të priorizojnë:

- përdorimin e specieve vendase;
- stabilizimin e tokës;
- rivendosjen e mbulesës bimore;
- reduktimin e erozionit;
- eliminimin e dëmtimeve vizuale.

Seksioni 1.15 – Plani i Angazhimit të Palëve të Interesuara

Në përputhje me Kornizën Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore dhe Standardin ESS10, është përgatitur një Plan i Angazhimit të Palëve të Interesuara (SEP).

SEP përcakton procedurat dhe kuadrin për angazhimin kuptimplotë të palëve të interesuara gjatë:

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

përgatitjes së projektit;

zbatimit;

operimit.

Megjithëse legjislacioni shqiptar kërkon konsultim publik gjatë procesit të lejeve mjedisore, kërkesat e ESS10 janë më të gjera dhe më të detajuara.

Prandaj SEP është hartuar sipas kërkesave të Bankës Botërore dhe ESMF.

Elementet kryesore të SEP

Identifikimi dhe analiza e palëve të interesuara

Përfshin identifikimin e:

- personave të prekur nga projekti;
- palëve të tjera të interesuara;
- grupeve vulnerabël ose të pafavorizuara.

Planifikimi i angazhimit

Përcakton:

- kohën;
- metodat;
- përgjegjësitë për aktivitetet e konsultimit.
- Publikimi i informacionit
- Siguron publikimin në kohë të informacionit të projektit në forma dhe gjuhë të kuptueshme për publikun.
- Konsultimi kuptimplotë

Konsultimet do të zhvillohen:

- në mënyrë të përshtatshme kulturorisht;
- pa manipulim;
- pa diskriminim;
- pa intimidim.

Mendimet e palëve të interesuara do të merren parasysh në vendimmarrjen e projektit.

Mekanizmi i Menaxhimit të Ankesave (GRM)

Do të krijohet një mekanizëm për:

pranimin e ankesave;

vlerësimin e tyre;

zgjdhjen transparente dhe në kohë.

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
Projekti: Ndertimi i Urave të Qëndrueshme P174595
Nënprojekti: “Rindërtimi i Urës së Klosit”

Raportimi dhe kthimi i informacionit

Përfshin publikimin e rezultateve të konsultimeve dhe përgjigjet ndaj komenteve të marra.

Mekanizmi i Menaxhimit të Ankesave është projektuar sipas ESS10 dhe ESMF dhe garanton:
aksesueshmëri;

konfidencialitet kur kërkohet;

trajtim proporcional të ankesave.

Ai do të mbulojë ankesa që lidhen me:

- shëndetin dhe sigurinë e komunitetit;
- çështjet e punësimit;
- shpronësimet dhe marrjen e tokës;
- ndikimet mjedisore.

Plani i Angazhimit të Palëve të Interesuara është pjesë integrale e dokumentacionit mjedisor dhe social të projektit dhe zbatohet në koordinim me dokumente të tjera të ESMF, përfshirë ESIA, PMMS dhe planet e zhvendosjes kur ato janë të nevojshme